

Brian Daniel Joseph (i lindur më 1951) është gjuhëtar amerikan i specializuar në gjuhësinë historike, profesor në Departamentin e Gjuhësisë në Universitetin Shtetëror të Ohajos (USA). Latinishtja ishte gjuha që e tërhoqi drejt gjuhëve ballkanike, fillimisht, duke e lidhur me greqishten. Ndërsa, greqishtja e çoi drejt studimit dhe hulumtimit gjuhësor të shqipes.

BRIAN DANIEL JOSEPH

Studimet albanologjike meritojnë një vend në universitetet amerikane

Bisedoi Mimoza Hasani Pllana (fq. 2)



MIRA MEKSI - NJË RESTAURUESE E IKONAVE GJUHËSORE SHQIPTARE

Nga Oana Glasu

(fq. 4)

Libri "Princi i Dashurisë", i poetit Lefter Çipa

Poetika e poezisë së dashurisë

Behar Gjoka

(fq. 6)

Libri me poezi i titulluar "Princi i Dashurisë", i poetit të mirënjohur të letrave shqipe, Lefter Çipa, padyshim i derdhur në një sinkretikë poetike të beftë, pra të një gërshetimi të vetëdijshëm të libroses dhe orales, jep të plotë përpara lexuesit edhe botën që parapëlqen më së shumti, pra dashurinë si afsh dhe materie, frymë dhe amshim, por edhe kodin se prej nga ku mund të kundrohët dhe shijohët shkrimi poetik i tij...

Funksioni i motiveve të përrallave në veprat e Kutelit

Emine Borici

(fq. 11)

G. G. MARQUEZ: Dashuria në kohërat e kolerës

Zhvirgjërimi i besnikërisë

Gentiana Softolli

(fq. 19)

Dymbëdhjetë letrat e Mjedës dhe pesë letrat e Majerit

Korrespondenca e plotë ndërmjet Ndre Mjedës dhe Gustav Majerit

(fq. 8)

Në numrin 1 të revistës "Arsimi popullor", Tiranë, 1967 u botuan letrat që Ndre Mjeda i dërgoi albanologut të shquar gjerman, Gustav Majer përgjatë viteve 1882 - 1883, përkthyer nga Jup Kastrati. Për to pati shkruar edhe Martin Camaj i cili në revistën "Shejzat" shpjegon disa syresh.

Bernard Quaritch Ltd – Dyqani
shekullor i antikuarëve:

Kemi pasur edhe vepra për Skënderbeun

Bisedoi Andreas Dushi

(fq. 18)



RENATO MINORE

Poezi

Përktheu nga origjinali:
Besnik Mustafaj

(fq. 14)

Takimi me Brodskin në Leningrad

TONE PAVČEK

(fq. 20)



ÇFARË KA MBETUR PA U THËNË: Si Kadareja i shpëtoi censurës, por përvetësoi stilin që ajo i mësoi

Peter Constantine

University of Connecticut

(fq. 5)

Ismail Kadare arriti moshën madhore në vitet e para pas vdekjes së Stalinit më 1953, kur Hoxha po shtonte programin e tij stalinist në Shqipëri. Libri i parë me poezi, *Frymëzime djaloshare*, u botua në vitin 1954, kur ishte tetëmbëdhjetë vjeç dhe menjëherë i dha autoritetin e një zëri të ri të rëndësishëm letrar...

BIBLIOTEKË

Rexhep Ferri

(fq. 12)

Historia e vdekjes

Enver Kushi

(fq. 13)

Përfaqimi i erërave

Ervin Nezha

(fq. 15)

Askush nuk mund ta

ndreqë një ëndërr

Alban Tufa

(fq. 17)

Tepria që mungon

Alfred Çapaliku

(fq. 17)

Qielli nuk është vetëm

për zogjtë

Qazim Shehu

(fq. 16)

Jetoj në një dhomë

kubike

Feride Papeleka

(fq. 16)

Retrospektivë poetike

Maryse Condé

(fq. 22)

Portret Familjar

Charles Baudelaire

(fq. 23)

Arti Romantik

Brian Daniel Joseph (i lindur më 1951) është gjuhëtar amerikan i specializuar në gjuhësinë historike, profesor në Departamentin e Gjuhësisë në Universitetin Shtetëror të Ohajos (USA). Latinishtja ishte gjuha që e tërhoqi drejt gjuhëve ballkanike, fillimisht, duke e lidhur me greqishten. Ndërsa, greqishtja e çoi drejt studimit dhe hulumtimit gjuhësor të shqipes.

BRIAN DANIEL JOSEPH

Studimet albanologjike meritojnë një vend në universitetet amerikane

Bisedoi Mimoza Hasani Pllana



Mimoza Hasani Pllana: *Profesor Brian Daniel Joseph, shumë vite keni ligjëruar lëndët e gjuhësisë në Universitetin Shtetëror të Ohajos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe keni studiuar për gjuhët ballkanike, gjuhë që fliten në një distancë gjeografike shumë të largët nga vendbanimi juaj. Pikërisht për këtë pjesë do dëshiroja të flisnim në fillim. Si u lidhët me Ballkanin? Çfarë ishin interesimet tuaja për gjuhët ballkanike?*

Brian Daniel Joseph: “Tregimi” impër mënyrën sesi u fut në gjuhësi dhe përfundimisht si Ballkani fillon me latinishten time në shkollë të mesme dhe duke e dashur atë. Kur fillova të shkoj në kolegji, vazhdova studimet në latinisht dhe me sugjerimin e motrës sime të madhe, e cila kishte studiuar greqisht kur ishte në kolegji, fillova dhe unë greqisht. Pas një viti greqisht dhe më shumë latinisht, fillova të kuptoj se nuk isha veçanërisht i interesuar për letërsinë që po lexonim, por përkundrazi isha i magjepsur nga vet gjuhët, nga struktura e tyre, nga fjalori i tyre, etj. Kështu që mendova se mund të më pëlqente një orë në gjuhësi bazuar në interesin tim për gjuhët, dhe kjo ishte arsyeja që më nisi në këtë fushë. Por, unë vazhdova interesimin dhe studimin për Greqishten dhe vendosa ta kaloj vitin e tretë në kolegji (1971-72) në një program studimi jashtë vendit dhe u vendosa në Athinë (College Year in Athens, ende është i fortë). Atëherë vazhdoja të studioj Greqishten e Lashtë dhe fillova të mësoj Greqishten e re. Ndërsa, interesimi im për gjuhësi kish lëvizur në drejtim të gjuhësisë historike, studimi i ndryshimit të gjuhës, studimi i të dy formave antike dhe moderne të gjuhës në të njëjtën kohë ishte një përvojë e jashtëzakonshme. Që nga ajo kohë pothuajse gjithçka që kam bërë në gjuhësi ka pasur ca lidhje me greqishten – greqishten si një gjuhë anëtare e familjes indo-evropiane, greqishten si një gjuhë natyrore

njerëzore dhe greqishten në kontekstin e saj gjeografik dhe ndërveprimet saj me gjuhët e saj fqinje në Evropën Juglindore. Është kjo perspektivë e fundit në greqisht që më çoi në gjuhësinë ballkanike dhe studimin dhe hulumtimin gjuhësor të shqipes.

M.: *Gjatë karrierës suaj, keni studiuar për çështje të ndryshme gjuhësore, njëra prej tyre është për Gjuhën, Politikën dhe Shprehjen Njerëzore në Azinë Jugore dhe Ballkan, si pjesë e Evropës Lindore, a janë të krahasueshme dhe si këto hapësira gjeografike në temën tuaj?*

B.D.J.: Trajnimi im në shkollën pasuniversitare në gjuhësinë historike përfshiu disa vite të studimit të sanskritishtes dhe në 40 vitet e mia në Universitetin Shtetëror të Ohajos, kam pasur mundësinë të jap mësim në Sanskritë çdo të dytin vit. Kështu që Azia e Jugut zotëron një pjesë të rëndësishme të interesave të mia jo-ballkanike/jo-helene. Por, atonukjanë interesatë ndara dhe të dallueshme dhe nuk kanë asnjë lidhje me njëra-tjetrën, sepse ka shumë për rolin e gjuhës në formësimin e ndërveprimit shoqëror dhe politik midis njerëzve dhe grupeve të ndryshme të njerëzve. Azia e Jugut padyshim që është më e madhe për nga popullsia dhe sipërfaqja, dhe kanë një shkallë më të madhe të larmisë gjuhësore dhe kulturore, por çështjet me të cilat përballet dikush në të dy rajonet janë mjaft të krahasueshme. Ekziston një konvergencë strukturore dhe leksikore në mes të gjuhëve të Azisë Jugore, aqsa është gjetur në Ballkan, dhe politikën e gjuhës, siç kam sugjeruar, janë të ngjashme në të dy pjesët e botës.

M.: *Sa i përket gjuhës shqipe, keni punuar në një projekt në lidhje me zhvillimin e Mësimave Online për Gramatikë dhe Lexim Shqip. Ky hulumtim ishte mbështetur nga Qendra Indo-Evropiane e Dokumentimit, Universiteti i Teksasit. Cili ishte qëllimi dhe cilat ishin rezultatet e projektit?*

B.D.J.: Qendra e kërkimit të Gjuhësisë (LRC) e Universitetit të Teksasit ka pasur si një nga qëllimet e saj për të zhvilluar një seri mësimesh online në gjuhët antike Indo-Evropiane. Ekzistojnë module në gjuhën Sanskritë, në greqishten e vjetër, në irlandishten e vjetër etj. Shqipja ishte një nga gjuhët e fundit të shtuara në listë, dhe unë isha ftuar të përgatis një sërë mësimesh që do të prezantonin gramatikën dhe historinë e shqipes. Regjistrua një student timin të Ph.D, Angelo Costanzo (i cili ndoqi seminarin ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare). Unë i ftoj të gjitha palët e interesuara ta vizitojnë tutorialin në <https://lrc.la.utexas.edu/eieol/albol>.


M.: *Si e shihni gjuhën shqipe në kontekstin e Gjuhëve Ballkanike, bazuar në studimin që keni bërë me temën “Gjuhësia Ballkanike” (Universiteti i Pavis në Itali)?*

B.D.J.: Përvoja ime në mësimdhënien e një “mini-kursi” mbi gjuhësinë ballkanike në Universitetin e Pavis në vitin 2016 ishte shumë argëtuese. Kam mbajtur një

seri leksionesh gjatë një jave dhe isha me fat që kisha një grup shumë të angazhuar studentësh dhe pedagogësh atje, të cilët ishin të interesuar për Ballkanin. Italia është shtëpia, në jug, e enklavave historike, si greke ashtu edhe shqipe, kështu që ka interes të konsiderueshëm për gjuhët dhe sigurisht që Italia ka qenë një qendër për studimin e Greqisë Klasike për shekuj me radhë. Sa i përket shqipes në kontekstin e saj gjuhësor ballkanik, ka shumë detaje të strukturës gramatikore, fjalëve dhe frazeologjisë që shqiptarët kanë marrë prej Ballkanit, për shkak të një kontakti shumëvjeçar intensiv midis gjuhëve dhe dy gjuhësisë. Kjo konvergencë strukturore dhe leksikore është ajo që e bën Ballkanin kaq interesant nga ana gjuhësore.

M.: *Përvoja juaj e mësimdhënies shënon disa dekada. Përveç Universitetit të Ohajos, keni ligjëruar në rreth 20 universitete të botës, duke përfshirë universitetet më të vlerësuara si: Universiteti i Harvardit (ShBA), Universiteti Karl-Franzens (Austri), Universiteti i Canterbury (Zelandë e Re), Universiteti i Albertas (ShBA) dhe në disa universitete tjera. Si profesor vizitor, keni bërë edhe kurse në gjuhën shqipe, pikërisht në Shkollën Verore Ndërkombëtare të Pavijës së Dytë për Gjuhësi Indo-Evropiane në Pavia të Italisë (2013). Po në universitetet shqiptare, si është bashkëpunimi juaj me universitetet shqiptare?*

B.D.J.: Një korrigjim i vogël: universiteti im është Ohio*State* University; arsyeja që e përmenda këtë është se, besoni apo jo, ekziston një tjetër universitet, vetëm rreth 100 kilometra nga Universiteti Shtetëror i Ohajos me emrin Ohio University! Kështu që unë dua të jem i sigurt se shënimimi i duhur i përkatësisë sime është kuptuar. Por po, unë kam dhënë mësim për 40 vjet në Universitetin Shtetëror të Ohajos dhe kam pasur fatin të kem mundësinë, gjithashtu të jap ose mësim



ose të mbaj leksione individuale në një numër të madh të universiteteve në Shtetet e Bashkuara dhe në botë, siç thatë ju, duke përfshirë leksione në disa vende të Ballkanit. Kam ligjëruar në Tiranë, gjatë një konferencë të mbajtur atje në vitin 2004 (vizita ime e pare në Shqipëri), por lidhjet e mia të forta universitare në botën shqipfolëse janë me Universitetin e Prishtinës, të cilin e kam vizituar disa herë dhe kam ligjëruar leksione (në shqip!) dhe kam bashkëpunuar me gjuhëtarët atje për projekte të ndryshme. Për më tepër, një profesor nga Universiteti i Gjirokastrës ka vizituar Laboratorin tim për Dialektologjinë Greke, që përfaqëson minoritetin grek të jugut të Shqipërisë.

M.: *Profesor Brian, jeni pjesë e shumë revistave gjuhësore dhe kulturore në shtetet më të njohura në botë, a mund të flasim për interesimet e studiuesve aktualë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare që kanë shprehur interesimet e tyre për të botuar në këto revista?*

B.D.J.: Për të gjithë faktin që unë kam punuar, studiuar dhe hulumtuar gjuhën greke për pjesën më të madh të 45 viteve të mia në gjuhësi, unë kam marrë më shumë pyetje në dy dekadat e fundit për shqipësisë për greqishten, në lidhje me studentët që vijnë për të studiuar te unë në Ohio State, kërkesa për ekspertizën time dhe të ngjashme. Kështu që mendoj se ka interesim shumë të madh për shqipësisë objektive hulumtimi gjuhësor. Unë nuk mund të flas për çështje të letërsisë dhe kulturës, pormendimi më i shtetë që gjuhakatërhequr interesim më të madh se letërsia, madje edhe me shkrimtarë të tillë të mëdhenj si Kadare që përfaqëson gjuhën në skenën ndërkombëtare.

M.: *Në listën e punimeve tuaja për gjuhësinë ballkanike, shohim shumë punime lidhur me gjuhën greke, njëra prej tyre i përket greqishtes së folur nga komuniteti grek në pjesën jugore të Shqipërisë (2011). A mendoni se mund të kenë ndikuar gjuha shqipe tek ajo greke?*

B.D.J.: Duke pasur parasysh interesin tim të kahershëm për Greqishten dhe interesin tim më të fundit, por ende afatgjatë, për shqipërisë, ishte pothuajse e pashmangshme që unë të kthehesha në bashkëpunimet ndërmjet këtyre gjuhëve në Shqipëri dhe Jugut. Në vizitën time të parë atje në vitin 2007, gjatë së cilës kalova disa ditë kryesisht në Sarandë, nuk e kisha krejt të qartë për praninë greke në jug, por në vizitat pasuese në vitin 2010 dhe pothuajse çdo vit që kur (para Covid-19, mjerisht), kam ardhur të kaloj më shumë kohë midis pakicave greqishtfolës në qytetet me vendin e vet në "ekologji" gjuhësore lokale, por në të njëjtën kohë, e ndërthurur në bisedë, përdorimi i së secilës ndryshon bazuar në atë se kush flet me kë, mbi atë që është tema e bisedës, cili është konteksti retorik etj. Ndërveprimi midis gjuhëve ka ofruar mundësi interesante për efektet e dygjuhësisë dhe kontaktit ndërmjet folësve të gjuhëve të ndryshme.

M.: *Në disa universitete nëpër botë, studimet e albanologjisë janë përfshirë në departamentet e gjuhëve dhe letërsive sllave, a keni menduar të krijoni një program studimesh të veçantë (siç është edhe gjuha shqipe) për gjuhën dhe letërsinë shqipe në Universitetin Shtetëror të Ohios, SHBA?*

B.D.J.: Në rolin tim si anëtar i departamentit sllav (përveç rolit tim si anëtar i departamentit të gjuhësisë), unë jam shumë mirënjohës që departamenti të Ohio State Slavic nuk është një departament vetëm i gjuhëve sllave, por përkundrazi është një departament i sllavishtes dhe gjuhëve të Evropës Lindore (dhe kulturat, gjithashtu). Pra, është një shtëpi për studime albanologjike në kuadër të departamentit tim. Kam përfituar nga kjo bazë e gjerë dhe i kam dhënë mësim një klase për gjuhësinë shqiptare rreth pesë herë në 15 vitet e fundit. Nëse fushëveprimi i gjerë i departamentit mund të çoj një ditë në një qendër apo program për studime shqiptare është një pyetje më e vështirë për t'u adresuar, pasi krijimi i një lloji të tillë kërkon më shumë sesa interes nga disa studentë ose profesorë

– kërkon një komunitet të konsiderueshëm interesi


dhe në fund të fundit, mbledhja e fondeve. Megjithatë, mbi baza shkencore, studimet Albanologjike meritojnë një vend në universitetet amerikane dhe shpresoj të bëj atë që mundem për të vazhduar të promovoj studimin e gjuhës në Ohio State dhe gjetkë.

M.: *Aktualisht, jeni duke punuar në disa studime në lidhje me strukturat gjuhësore të greqishtes së re, kur dhe si mund të shohim rezultatet e punës tuaj?*

B.D.J.: Gjatë karrierës sime jam përpjekur të prezantoj punën time në sa më shumë konferenca dhe në sa më shumë pika botimesh, si në SH.B.A dhe në të gjithë Evropën, dhe në atë mënyrë unë kam "përhapur fjalën" time në shqip dhe greqisht gjerësisht në bazën ndërkombëtare. Në vitin 2021, pritet një libër masiv mbi gjuhët ballkanike, përfshirë greqishten dhe shqipen, për të cilin kam punuar me një kolegun tim, Victor Friedman, për gati 20 vite më në fund do të botohet, nga University Press, dhe ne mendojmë se kjo do të paraqesë qartë, për herë të parë në anglisht (të gjithë manualët ekzistues për gjuhësinë ballkanike janë në gjuhë të tjera përveç anglishtes) mënyrat më të mira në të cilat shqipja ka bashkëpunuar dhe konvergjuar me gjuhët ballkanike për shumë vite që do të vijin.

M.: *Bazuar në studimet tuaja për gjuhët ballkanike, si e shihni ju gjuhën shqipe në relacionin me gjuhët ballkanike?*

B.D.J.: Përgjigjet e mia në pyetjet tjera duhet të sqarojnë lidhjen midis shqipes dhe gjuhëve të tjera, por çështja kryesore është se ekziston një konvergjençë masive strukturore dhe leksikore midis të gjitha këtyre gjuhëve. Në shumë mënyra, nëse dikush e njeh gramatikën e njëres prej gjuhëve ballkanike, gramatika et të tjerëve duket mjaft e natyrisht dhe e njohur, kështu që në një kuptim të caktuar dikush mund të mësojë për gjuhët ballkanike nëpërgjithësi duke mësuar për shqipen në veçanti. Është një gjuhë magjepsëse dhe hap derën për studimin e Ballkanit si një vatër magjepsëse e kontaktit gjuhësor dhe konvergjençës gjuhësore.



Brian Daniel Joseph (i lindur më 1951) është gjuhëtar amerikan i specializuar në gjuhësinë historike. Që nga viti 1979, B.D. Joseph ka qenë në Universitetin Shtetëror të Ohajos (OSU) pasi që i kreu studimet Ph.D. në Harvard në 1978, një vit e kaloi si bashkëpunëtor i post- doktoratës 'Killam Postdoctoral Fellow' në Universitetin e Albertës. Interesat tij janë mjaft të gjëra, por para së gjithash janë të fokusuar në studimin e ndryshimit të gjuhës, veçanërisht në lidhje me gjuhën greke në të gjitha fazat e saj historike, duke përfshirë parahistorinë e saj dhe mënyrën se si ajo përshtatet në familjen e gjuhës Indo-evropiane, gjithashtu kontakti i saj i fundit i rëndësishëm me gjuhët fqinje në Ballkan. Por, interesimet e B.D. Joseph drejtohen edhe në gjuhë tjera, veçanërisht në atë sanskrite dhe shqipe, si dhe në fusha tjera brenda gjuhësisë, duke përfshirë edhe teorinë morfologjike dhe ngulitjen e gjuhës në strukturat shoqërore. Kohët e fundit, ai ka punuar për çështje të qëndrueshmërisë së gjuhës, duke shikuar se si u bë që gjuha greke të bëhet relativisht e fuqishme në mjedisin e saj diasporik në Shqipëri dhe Jugut, po ashtu edhe atë çfarë mund të përcaktojmë për qëndrueshmërinë gjuhësore - dhe njëkohësisht etnike - në kohët antike në Mesdheun lindor.

Më gjerësisht të dhëna nga përgatitja arsimore paraqesim në vijim: 1978: Universiteti i Harvardit, Kembrixh, Massachusetts; 1978: Ph. D. në Gjuhësi (titulli i disertacionit: Morfologjia dhe Universalet në Ndryshimin Sintaksor: Evidencë nga Greqia Mesjetare dhe Moderne); 1977: Hulumtimi për Disertacion në Greqi; 1976: A.M. në gjuhësi; 1973: Universiteti i Yale, New Haven, Connecticut; 1973: A.B. Cum Laude; Drejtimi: Gjuhësi, Klasikë; 1972: Semestri i plotë akademik në Athinë, Greqi. Ndërsa, interesat e tij hulumtuese përfshijnë ndryshimin e gjuhës, gjuhësinë greke, gjuhësinë ballkanike dhe teorinë morfologjike.

B.D. Joseph numëron një varg nderimesh Akademike, si: më 2006 u nderua me çmimin Ph.D. Honoris Causa, nga Universiteti La Trobe (Bundoora, Australia); më 2011 u nderua me Çmimin e themeluesit (për nxitje të përsosmërisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie), Akademia e mësimdhënies e Shtetit të Ohajos; më 2003 fitoi çmimin Ohio Magazine's Ekselencia në arsim, duke u vlerësuar në mes të 100 mësimdhënësve më të mirë në Arsimin e Lartë; më 2002 me Çmimin 'University Distinguished Service' (çmimi i nderit për shërbime universitare); 2001 me Çmimi 'University Distinguished Scholar' (çmimi i nderit si shkencëtar universitar); në vitin 2000 Çmimi i 'College of Humanities Exemplary Faculty' (çmimi i Fakultetit Shembull të Kolegjit të Shkencave Humane); më 1995 u nderua me Çmimin e Nderit për Mësimdhënie OSU Alumni, etj.


Gjatë karrierës akademike, B.D. Joseph, kontribuoi dhe vazhdon të kontribuojë në disa revista shkencore dhe shoqata gjuhësore e filozofike, duke qenë bashkëpunëtor, anëtar dhe kryetar, si: Bashkëpunëtor, Shoqëria Filozofike Amerikane (2019); Kryetar, Shoqëria Gjuhësore e Amerikës (2019); Nënkyetar/Kryetar i zgjedhur, Shoqëria Gjuhësore e Amerikës (2018-2017); Bashkëpunëtor, Shoqëria Filozofike Amerikane (2010); Doktoraturë Nderi ("Epitimos Didaktora")/ Doktoraturë Nderi, Departamenti i Filologjisë, Universiteti i Patras, Patras, Greqi (2008); Bashkëpunëtor, Shoqata Amerikane për Avancimin e Shkencës (2006; 2007); Bashkëpunëtor, Akademia Amerikane e Arteve dhe Shkencave (2004); Anëtar, Akademia e Përgjegjësisë Ohajo, 1995-deri më tani; anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Akademisë, 1997-2000; B.D. Joseph, u zgjodh edhe anëtar i Shoqatës Amerikane të Filozofisë në vitin 2019, ndërsa ishte Nënkyetar i Shoqatës së linguistëve të Amerikës në vitin 2018 dhe aktualisht është President i organizatës. Më parë ai ishte President i Shoqatës së Amerikës së Veriut për Historinë e Shkencave të Gjuhës dhe aktualisht punon si bashkëredaktor i Revistës së Gjuhësisë Greke (Journal of Greek Linguistics.) Po ashtu, B.D. Joseph, është autor i mbi njëqind punimeve shkencore dhe autor e bashkautor i një varg librash.

B.D. Joseph, është Profesor Nderi Universitar i Gjuhësisë dhe është Profesor Kenneth E. Naylor i Gjuhësisë dhe Gjuhëve Sllave të Jugut.

Shënime të përkthyeses në rumunisht të romanit "Diktatori në kryq"

MIRA MEKSI - NJË RESTAURUESE E IKONAVE GJUHËSORE SHQIPTARE

Nga Oana Glasu



Përmes romanit „Diktatori në kryq” Mira Meksi i rikthen vendit të saj dhe universalitetit një histori që nuk kishte të drejtë të qëndronte e varrosur, përtej çdo forme trillimi, si një mjet i domosdoshëm për ndërtimin e temës së librit.

Në fakt, Mira shkruan si një piktor. Fjalët e saj nuk janë kode kuptimore abstrakte, pa ngjyrë, të thjeshta. Përkundrazi, ata kanë shushurima të qetë, pastel dhe magji. Fjalët janë plastike sesa teorike, përshkruese, jo analitike, të përshtatshme për pikturë, jo diskursive. Para se t'i mendosh frazat, reflektimet, hijet, mirazhet, skenat tashmë po shpërndahen në imagjinatën tënde. Pamjet marrin kontrollin e vëmendjes tënde përpara se të kuptosh se në cilën rrugë dëshiron të vazhdojë leximi yt. Imazhi shkon një hap përpara mendimit dhe kështu që nuk lexon, por shikon një film. Dua të them se hapësira e rafinuar dhe e vizatuar me përpikmëri e fjalëve ka nevojë vetëm për durim, pasi nuk ka asnjë çelës për të lexuar, përveç rikompozimit mendor të një skenari nga personazhe, situata, korniza, peizazhe dhe rekuizita të paraqitura me saktësi fotografike.

Pasi të lexohet, libri do të kuptohet dhe shijohet sepse është një trillim i thjeshtë, klasik, i qartë si një koleksion i ruajtur mirë i pikturave, me një higjienë leksikore e patëmetë dhe e gjitha, në ajrin e pandotur të një bote moderne fillestare. U kënaqa kur zbulova se Mira, nga një instikt i shëndetshëm për stabilitet, shmangu kompozimet komplekse të letërsisë së sofistikuar të shekullit të kaluar, duke na dhënë një libër të përsosur, por përcaktues, si për një letërsi thelbësore, por që lë hapësirë për një labirint, të cilit do t'i referohem më vonë. Do të ishte një gabim i imi të vendosja modele narrative, për sa kohë që, në realitet, këto modele bashkëjetojnë në hapësirën sistematike, anhistorike të kulturës. Miti, përralla, magjepsja, trillimi realist, magjia realiste, si çdo lloj tjetër i shkrimeve post-moderne, sado eksperimentale apo ekstravagante të jenë, bashkëjetojnë në të njëjtën hapësirë letrare, pa konkuruar ose anuluar aktualitetin e njëri-tjetrit. E megjithatë, është shpikja stilistike dhe kompozicionale që prodhon ndryshime, mënyra dhe modele të reja për ta bërë letërsinë. Rasti i librit të Mira Meksi, aq i shkëlqyeshëm sa një vitrinë e Bierdermeier na tregon se kemi të bëjmë me një shkrim të mrekullueshëm të ri „të stilit të vjetër. Hartuar me artin e të

shkruarit, duke vënë në lëvizje mekanizmat e përshkrimit linear dhe evokimit, me disa ndërhyrje psiko-afektive që sqarojnë në ndonjë rrethanë dhe dialogë absolutisht të domosdoshëm të zbatuar në mënyrë konjunkturale.

Për sa i përket temës, romani krijon një histori në dukje - të zakonshme, në realitet - tragjike, kur bëhet fjalë për simbole, mistere të lashta, të vërteta shqetësuese, personazhe magjepsë ose veprime drithëruese. Por, sidomos, kur bëhet fjalë për diktaturën më të egër, si regjim, që ndodhi në Shqipëri dhe rreth Enver Hoxhës, të cilën autorja e paraqet përtej çdo mistifikimi. Nëse për gjithë të keqen e prodhuar nga eksponenti i regjimit komunist, mund të shtrohej pyetja: ku ishte Zoti kur ndodhi e gjithë kjo?, atëherë kur, Enver Hoxha vendosi një botë dhune, terrori, urrejtjeje, frike, dyshimi, degradimi moral dhe emocional, zbrazëtia e brendshme dhe vdekja mendore dhe fizike, tradhëtia, kërcënimi dhe regresi drejt bishës, arrestimi pa faj, tani, ja që, Mira e ekspozon këtë diktator, duke e treguar atë të zhveshur si në një mënyrë lutjeje përpara një Zoti të fshehur, në të cilin nuk beson, por nga i cili pret një shenjë. Dhe nëse jo për të përmirësuar jetën e tij, të paktën për të kuptuar se për çfarë paguan. Vuajtja të kishte një arsye, të cilën, në fakt, atij i kishte munguar përgjithmonë si individ, dhe e keqja e historisë kishte gërmuar në rrënjën e çdo të mire, madje edhe rrethanore.

Heronjtë e Mirës kanë përtej angazhimeve themelore, simptoma të tilla si mospërputhja midis shpirtit dhe trupit, midis një njeriu dhe tjetrit, midis njeriut dhe botës dhe autorja realizon me art të rrallë personazhe të gatshëm për të vërtetën, si një veprim i një guximi të madh. Ndoshta heroizmi qëndron në këtë; të luftosh për të vërteta që askush nuk t'i premtonte, të rrezikosh një drejtësi për të cilën askush nuk të mbështet, të komplotosh pa frikë për të mirën e dikujt të mundur nga makina e historisë, edhe pse kjo është e verbër dhe ndjek rruga okulte që shkel mbi kufomat, sepse gjestet e vogla mund të sqarojnë vetë kuptimin e botës, ashtu si në një pikë vese e gjithë universi mund të pasqyrohet. Por cila fuqi tjetër mund të ndalojë rënien e njeriut në fazën e kafshës, nëse jo kthimin në origjinë, domethënë në besim?!

Pa dashur të ritregoj historinë, do të kujtoj vetëm se tema qendrore rreth së cilës ndërton autorja është kryqi i Labovës, që do të thotë jo vetëm lashtësi në kuptimin e objektit, por vërtetim i krishterimit mijëvjeçar në hapësirën shqiptare, dhe, përkatësisht këtu, Mira bën vend atij labirintit për të cilin përmenda, në antipolin e së cilit është kisha vertikale bizantine. Shkrimtarja është një pyetës i veçant i gjendjes njerëzore, e kodifikuar në art, dhe labirinti është një nga ngjithjet në atë besim fillestar, duke filluar nga kërkimi i Graalit të jetës së përjetshme, të cilin e marrim me vete përmes historisë. Etika e vetme e fortë në historinë e botës është ajo fetare, e bazuara në sisteme teologjike, në idenë e vullnetit hyjnor, por autorja lejon që vullneti i lirë të funksionojë ose të lejon të shikosh atë që nuk e kupton, të kërkosh ç'farë nuk ekziston, të injorosh atë që nuk të është fshehur, duke t'i vendosur të gjitha pjesët e rëndësishme në tryezë.

Romani i Mirës, të paktën nga kjo perspektivë, është një konceptim i mrekullueshëm për botën dhe gjithashtu një mesazh. Do t'i lejoja vetes termin - humanizëm. Një humanizëm i rikuperimit të vetvetes në kushte ekstreme. Nuk është për t'u habitur që në një epokë të kujtesës së trishtuar mbizotëronte e keqja në botë, që të detyronte të jetosh me frikë, poshtërim dhe gënjeshtra, ku ruheshe nga ai apo ajo që dashuroje ose i mbuloje veshët nga britma e vetëdijes; mahnitës është fakti, dhe këtë e dëshmon shumë mirë autorja, se ekziston gjithmonë dikush që nuk jep dorëheqjen lehtë, duke luftuar në një betejë që duket e humbur prej kohësh, dikush që e kupton se për të fituar dinjitetin njerëzor, lufta është më e rëndësishme se fitorja, akoma më shumë kur përballet me dikë të pathyeshëm. Në fund të fundit, në luftë me fatin, të cilën shpesh e ndihmon për të triumfuar, edhe përmes gjesteve që i kundërshton.

Në përgjithësi, shkrimtarët shqiptarë më tërheqin dhe mahnisin me stilin e të shkruarit, por sidomos me gjuhën që ata përdorin dhe, sidomos në këtë drejtim dua të

shpreh konsideratat e mia. Si stil, Mira është një shkrimtare moderne, e tejbushur në zgjedhjen e temave, në të cilat vura re mungesën e tabuve, në shprehje apo përshkrime, shpesh unike. Por mbi të gjitha, është një restauruese e fjalës origjinale shqipe. Ajo është krijuese e një ikone gjuhësore e rrallë që e hasa deri më tani ose në shumë pak shkrimtarë shqiptarë. Si e huaj, duhej të thelloja kuptimet e fjalëve që nuk i kisha hasur kurrë më parë dhe që e kisha të vështirë t'i gjeja përmes fjalorëve dhe jo sepse janë dialektore, por sepse janë origjinale. Të vjetra dhe të papërdorur, dhe merita e Mirës është aq më e madhe sa më shumë që i nxjerr ato në dritë. Dhe sa mirë tingëllojnë, dhe sa ngjyra i jep një teksti, pavarësisht nga tema.

Që nga fillimi i leximit unë e trajtova autoren si një artist të përbërjes letrare, pa injoruar faktin se në fondin e saj mund të gjej ide të thella, intuïta pjellore, një vizion të botës nga më të rafinuarit dhe këtë e bëra për të identifikuar stilin për të krijuar, edhe pse isha gjithashtu e tërhequr nga historia. Mira ka stilin e saj krijues, pa të cilin letërsia aktuale do të kishte ngecur. Nuk do të kishte përshkruar një histori, nuk do të kishte evoluar, dhe me evolucion dua të them përbërjen, arkitekturën narrative. Nuk mund të komplimentohet më një shkrimtare e mirë, por vetëm t'i admirohet receta stilistike. Në librin e Mirës, ndërtimi i përrallës është pjesë e vetë historisë, duke pasur një rrefim autoskopik, pra historinë që e sheh veten në ndërtim dhe merr shkrirjen e saj me sfondin epik. Kështu, ekziston një shpërndarje e vetes narrative në një mënyrë të tillë që secila pjesë të pushtohet nga një tjetër që vijon. Pasi vetja reflektuese ka shteruar përshkrimin e saj, një element i tij, qoftë një person ose një situatë e paqartë, kalon në sekuencën tjetër që ndriçon, duke i kërkuar të bëjë të njëjtën gjë, për të përshkruar vetveten. Çdo sekuencë përmban një prerje me dy hapje, në të cilën dialogët përmes të cilit bëhen personazhet, vijnë nga kujtimet e monologut dhe synojnë të sqarojnë një rrethanë.

Për të parë librin e Mirës në tërësinë e saj, duhet studiuar me kujdes secila sekuencë, nga e para te e fundit, duke rrëshqitur nga njëra në tjetrën, pa ndërprerje, për të vëzhguar shenjë delikate që kalon nga një pikturë në tjetrën, në mënyrë që të të tregojë kuptimin e misterit. Dhe pas kësaj, gjithçka duhet të ribëhet, duke fshirë ngjyrat nga personazhet për të qëndruar me filmin negativ të të gjithë librit. Të gjithë personazhet në libër janë të vetëdijshëm për rolin e tyre, duke mbajtur në mënyrë të barabartë një dinjitet auktorial. Askush nuk të kthen shpinën, nuk bën sikur i përket një bote, për të cilën ti, lexuesi, nuk ke ide, por jeton me ty kënaqësinë e zbulimit të botës së tij. Konsideroj se kjo është prova e një përsosjeje të madhe letrare për të pasur sukses në thyerjen e cipës që ndan botën e librit nga bota e lexuesit.

Trillimi luan një rol të barabartë me ngjarjet historike që ndryshojnë fytyrën e botës. Por, ai bën më shumë se kaq, përkatësisht legjitimon statusin funksional të librit. Dhe, praktikisht në botën e tregimeve nuk ka rastësi, sepse nuk ka kohë, por vetëm kuptim. Sharmi aromatik i erudicionit të autores e bën disi të komplikuar delimitimin midis trillimit dhe realitetit, sepse hasim një ndërthurje gati perfekte, në kufirin e lojës retorike, ku realiteti bazohet në elementet themelues të botës dhe civilizimit.

Të gjithë e dimë që vetëm duke treguar, rrëfyer, mund të mbijetojmë, por të mbijetosh nuk do të thotë të tërheqësh zvarr jetën. Do të thotë gjithashtu të jetosh në një nivel më të lartë dhe e gjithë vepra e Mira Meksi është një histori që justifikon jetën, duke e armatosur atë me kuptim. Romani „Diktatori në kryq” që i solli shkrimtares çmimin e madh të letërsisë është afresku i restauruar gjuhësisht nga Mira, të cilin ajo e vendos në parajsën e letërsisë universale, nga e cila mund të mos jemi dëbuar kurrë, por vetëm ndonjëherë sytë tanë janë mbuluar që të mos mundemi ta shikojmë atë, por, është gjithashtu, arti që gjithmonë na mëson të shohim qiellin...



Një shkrim i botuar në *World Literature Today*

ÇFARË KA MBETUR PA U THËNË: Si Kadareja i shpëtoi censurës, por përvetësoi stilin që ajo i mësoi

Peter Constantine
University of Connecticut

Peter Constantine është profesor i Studimeve të Përkthimit në Universitetin e Connecticut-it. Përkthimet e fundit të Peter Constantine përfshijnë vepra të Augustinit, Rusos, Makiavelit dhe Tolstoit. Për arritjet akademike dhe krijuese është shpërblyer me bursën Guggenheim, me Çmimin e PEN-it për përkthimin e *Gjastë tregime të hershme të Tomas Mani*, dhe me Çmimin Kombëtar të Përkthimit për studimin *Çehovi i pazbuluar*.

Anton Çehovi, në tregimin komik "Kryqi", shkruar më 1883, e vendos skenën e ngjarjeve në një sallon të shoqërisë së lartë të Moskës, ku shumë Moskovitë elegantë mblidhen grumbull rreth një poeti i cili, me sa duket, sapo ka marrë një medalje për veprën e tij. A është një Kryq Stanislav për vlerën e librit më të fundit me poezi? A është Urdhëri i Kryqit të Shën Anës për strofat patriotike në shërbim të Rusisë Perandorake? Tensioni rritet deri sa poeti ngre lart librin dhe të ftuarit shohin kryqin e madh të kuq të Zyrës së Censurës të Carit. Libri më i fundit me poezi i poetit është ndaluar. Syri i censorit perandorak ishte i rreptë dhe disa nga censorët e tij, të tillë si Ivan Goncharov, ishin njerëz të famshëm të letrave për shkak të talentit të tyre unik. Të gjithë autorëve të mëdhenj të kanonit letrar rus të shekullit të nëntëmbëdhjetë - Pushkini, Dostojevski, Gogoli, Çehovi - iu desh të vendosnin penën mbi letër me kujdes sipëran për të shmangur kryqin e kuq të Censorit dhe andrallat që mund të vinin më pas. Secili prej tyre zhvilloi një mënyrë personale vetë-censurimi, një mënyrë për t'i thënë gjërat pa i thënë shkoqur, ndoshta duke kaluar herë pas here vijën e kuqe, por në mënyra që ishin krijuar për t'iu shmangur syrit të censorit.

Nëse shkrimtarët në Rusinë perandorake dridheshin para censorit të Carit, sundimi i Stalinit që filloi një dekadë pas Revolucionit Bolshhevik solli një përmasë të re alarmi dhe terrori tek censura, me përndjekje, burgosje, vite pune të rëndë dhe ekzekutime. Dhe atë që filloi Stalini në Bashkimin Sovjetik, Enver Hoxha, diktatori Stalinit i Shqipërisë e përsosi gjatë viteve 1941-1985, duke zhvilluar strategji më mizore për të censuruar dhe ndëshkuar shkrimtarët shqiptarë që shiheshin të dilnin dilnin nga rreshti. Stalini ishte përballur me një pengesë me të cilën Hoxha nuk u përball. Stalini kontrollonte një të gjashtë të sipërfaqes së tokës së tokës, ndërsa Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë ishte njëzetë e tetë mijë kilometra katrorë, më pak se një e katërta e madhësisë së Nju Jorkut. Kësisoj,

Hoxha e kishte më të lehtë se Stalini për të mbikëqyruar dhe kontrolluar çdo formë të të shprehurit. Autorët shqiptarë po kështu s'mund të ishin kurrë të sigurtë se në cilin drejtim mund të vinte urdhri për t'ua ndaluar veprën. Edhe pse të gjithë librat që botoheshin shqyrtoheshin me kujdes për ndonjë shmangie ideologjike të hapur ose të perceptuar nga kryeredaktorët e shtëpive botuese shtetërore të Shqipërisë (nuk kishte shtyp të pavarur ose privat), librat e botuar ishin gjithashtu subjekt i censurës ose ndalimit arbitrar nga Seksioni Ideologjik i Komiteti Qendror, Ministria e Arsimit, madje edhe Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, e cila s'kishte njohuri për teknikat e stërholluara letrare.

Ismail Kadare arriti moshën madhore në vitet e para pas vdekjes së Stalinit më 1953, kur Hoxha po shtonte programin e tij Stalinit në Shqipëri. Libri i parë me poezi, *Frymëzime djalohe*, u botua në vitin 1954, kur ishte tetëmbëdhjetë vjeç dhe menjëherë i dha autoritetin e një zëri të ri të rëndësishëm letrar. Në dy dekadat e ardhshme Shqipëria do të bëhej vendi i vetëm më i izoluar në botë, kufijtë e saj u vulosën pasi Hoxha prishi lidhjet me Bashkimin Sovjetik dhe Kinën Komuniste që, sipas tij, po bëheshin tepër liberale. Në këto rrethana të censurës së skajshme totalitare, Kadare përsosi një stil vetjak të shkruari që ishte i pakapshëm dhe megjithatë jashtëzakonisht i drejtëpërdrejtë.

Peter Morgan ka përmbledhur saktë aftësinë e jashtëzakonshme të Kadaresë për të ngadhënyer: Kadare krijoi disa nga veprat më të shkëlqyera dhe kundërtotalitare që dolën nga Evropa Lindore socialiste. Vepra iu përzgjodh për botim pasi ai ishte anëtar i njohur i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe i Partisë. E bënë deputet të Kuvendit Popullor dhe mund të udhëtonte jashtë vendit. Ai arriti të shmangte burgun, kampet e punës ose format e tjera të ndëshkimit që u jepeshin atyre që dilnin nga rreshti.

Unë u bëra një nga përkthyesit e Ismail Kadaresë në fund të viteve 1990-të. Diktatura Socialiste e Shqipërisë kishte rënë. Ismail Kadare tani jetonte në Francë dhe i çliruar nga rreziqet e censurës së Enver Hoxhës, dhe filloi një periudhë të re të mahnitshme krijuese. Dy shqetësimet kryesore të veprave në vitet 1990-të ishin diktatura shqiptare, për të cilën tani mund të shkruante më drejtëpërdrejt pa u ndëshkuar, dhe kriza e Kosovës që kishte vazhduar të përshkallëzohej që nga viti 1989 kur Kuvendi i Serbisë vendosi ta pushtojë Kosovën, e cila kishte qenë krahinë autonome e Jugosllavisë e populluar në pjesën më të madhe nga shqiptarë etnikë. Në vitin 1998-të kriza e Kosovës u shndërrua në një luftë totale.

Veprat që Kadare shkroi gjatë viteve të para jashtë vendit - *Piramida*, *Spiritus*, *Shkaba* dhe *Tri këngë zie për Kosovën* - ishin më të drejtëpërdrejtë dhe flisnin më hapur se kryeveprat që i kishin sjellë që në krye të herës famë botërore gjatë viteve të diktaturës. E megjithatë këto vepra të reja kanë ruajtur cilësinë e jashtëzakonshme Kadareane të të thënit shumë dhe me shumë qartësi, por në një mënyrë të pakapshme, të tërthortë dhe alegorike.

Tri këngë zie për Kosovën (anglisht: *Elegji për Kosovën*), të cilën përktheva në vitin 1999, është një nga romanet më të shkurtër të Kadaresë, por pavarësisht shkurtësisë (120 faqe), jetëson një hulumtim të thellë dhe të gjithanshëm letrar të konfliktit që ka pllakosur Kosovën që nga epoka mesjetare kur u aneksua nga Perandoria Bizantine, pastaj nga Perandoria Serbe, dhe më pas nga Otomanët. Ai jep një çelës për të kuptuar më thellë rrënjët e konflikteve etnike në Kosovë sot. Sipas Stendalit, "Politika në roman është si një krismë revolveri gjatë një koncerti, është diçka tejet e ashpër". Megjithëse ky është një roman shumë politik, nuk ka politikë në të, as ashpërsi. Në qendër të romanit është Beteja e Kosovës e vitit 1389, një ngjarje që ndër shekuj ishte shkaku i ngjizjes së shumë legjendave heroike në të gjithë



gadishullin ballkanik. Ishte një betejë e kobshme për të gjithë ata që ishin pjesë e saj: një konfederatë e trupave ballkanike u përball me ushtrinë pushtuese otomane të udhëhequr nga Sulltan Murati I. Po ta shohësh nga një këndvështrim historik, asnjëra palë nuk fitoi. Sulltani otoman u vra, ashtu si edhe Princi Lllazar, komandanti i forcave ballkanike, por beteja shënoi fillimin e pushtimit otoman të Ballkanit që do të zgjaste deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

Legjendat heroike më domethënëse për këtë betejë që janë ruajtur, janë serbe, dhe këto legjenda, në formën e poezive, këngëve dhe baladave, kanë luajtur një rol jetësor në përpjekjet bashkëkohore të Serbisë për ndërtimin e kombit. *Tri këngë zie për Kosovën* hedh poshtë perceptimin se beteja ishte një ngjarje thjesht serbe dhe otomane dhe paraqet imazhin më të larmishëm të një ushtrie që s'ishte vetëm serbe dhe otomane por një bashkim trupash me ushtri të serbëve, shqiptarëve, boshnjakëve, rumunëve, kroatëve dhe hungarezëve - një ushtri ballkanike. Kadareja sfidon përvetësimin serb të betejës dhe ideologjinë nacionaliste që ka përdorur rrëfimet e trilluara të legjendave serbe për të legjitimuar formimin e një rendi të ri politik dhe programin për të pushtuar Kosovën.


Si në shumë këngë epike ballkanike të kësaj treve - si shqiptare ashtu edhe serbe - rrëfimi i romanit fillon me princërit që mblidhen në gosti në prag të luftës. Beteja që pasoi është kaotike dhe vdekjeprurëse, dhe dy rapsodë, protagonistët e romanit, arrijnë të ikin nga masakra dhe enden drejt veriut duke kënduar këngët e tyre epike tradicionale në shtëpitë e kryezotëve dhe në kështjella. Ata janë shokë të pangjashëm - njëri rapsod është serb dhe tjetri shqiptar, secili është sjellë në fushën e betejës për të kënduar epet e vjetra që lavdërojnë luftëtarët e vendeve nga janë dhe për të krijuar këngë të reja që do të përjetësojnë princat e tyre. Megjithëse rapsodët janë shokë dhe miq, baladat që ata vazhdojnë të këndojnë para fisnikërisë evropiane e përjetësojnë armiqësinë e kryehershme.

Njëri pas tjetrit, nën peshën e një heshtje të rëndë, ata kënduan këngët e tyre, të lashta dhe të ftohta si guri, secili në gjuhën e tij: "Mjegull e madhe Fushën e Mëllenjavë e mbuloi, / Ngruhuni serbë, se Kosovën e mori shqiptari", "O seç ra një mjegull e zezë / Çohuni, shqiptarë, se në Kosovë ra shkjuu".

Fisnikët e Evropës Veriore në fillim mbesin pa fjalë, pastaj tërbohen. Trojet e Ballkanit do të sundohen nga Otomanët, dhe megjithatë ende këta popuj të nënshtruar, të cilët tani duhet të jetojnë nën zgjedhën otomane, po e mbajnë gjallë armiqësinë e tyre tradicionale. Përleshjet vazhdojnë në këngët e tyre. Ata s'mund të çlirohen nga shtrëngimet e traditave të tyre luftarake. Kadare i paraqet këto skena por nuk komenton drejtëpërdrejt. Lexuesit nuk i thuhet, por mund të nxjerrë përfundimin se kjo është rrënja e pavdekshme e problemit që mundon Ballkanin. Megjithatë, kur rapsodëve u kërkohet të rrëfejnë legjendat më të lashta të tokave të tyre - me të folur, jo me këngë - këto legjenda hapen dhe marrin përmasa homerike: "Është i njëjtë pluhur diamanti, e njëjta farë... Ca si grimca nga kulmorja e rrëzuar e qiellit të vjetër". Armiqësia e ashpër zhduket.

Nga këndvështrimi i Kadaresë, kjo armiqësi e ashpër është tragjedia e vazhdueshme e Ballkanit. Fryma dhe historia epike e popujve të tyre të çojnë mbrapa në kohë në një epokë homerike të bronzit, por këngët dhe baladat epike mesjetare që kanë dalë para dhe pas betejës së Kosovës kanë përjetësuar armiqësinë e tyre fatale. Evropa Veriore, në epokën e saj të errët të luftës dhe murtagjës mesjetare, ka humbur të gjitha lidhjet me të kaluarën e saj; Ballkani është shtegu i vetëm për tek ajo kohë antike.

Përktheu: GRANIT ZELA



Libri "Princi i Dashurisë", i poetit Lefter Çipa

POETIKA E POEZISË SË DASHURISË

Nga Behar Gjoka

Libri me poezi i titulluar "Princi i Dashurisë", i poetit të mirënjohur të letrave shqipe, Lefter Çipa, padyshim i derdhur në një sinkretikë poetike të beftë, pra të një gërshetimi të vetëdijshëm të libroses dhe orales, jep të plotë përpara lexuesit edhe botën që parapëlqen më së shumti, pra dashurinë si afsh dhe materie, frymë dhe amshim, por edhe kodin se prej nga mund të kundrohët dhe shijohët shkrimi poetik i tij. Njëkohësisht, kjo përmbledhje me poezi, shënon edhe majën e fjalës poetike të poetit, pamëdyshje në të gjithë pentagramin shkrimor të gjertashëm, të endur me finesë dhe art prej tij. Teoritë letrare, klasike dhe moderne, kryesisht duke i lexuar dhe shqyrtuar tekstet poetike, më tepër si të ndara dhe të larguara, nga njëra-tjetra, pra si poezi popullore dhe të kultivuara, në fakt na shkaktojnë edhe një rrëmujë krejt të panevojshme, mbase diç më shumë një ngërç konceptual, paragjykes dhe veprues në jetën tonë, sikur letërsia e kultivuar, pra ajo autoriale, është e një niveli më të ngritur artistik, krahasuar me letraren e oralitetit. Harrimi, në këtë rast, i fakteve të thjeshta se letrarja e kultivuar ka lindur prej bërthamës së oralitetit dhe se për asnjë rrethanë nuk i ka shkëputur penjtë dhe marrëdhëniet me të, të vë në mendim dhe po kaq në dyshimin e trajtimeve të nxituara përmbi këtë ekzistencë të dhëniemarrjes së letërsisë orale dhe të shkruar, madje edhe si një akt i marrëdhënies së ndërsjellë. Në këtë rast, ka gjasa të shumta dhe tepër domethënëse se jemi në një paragjykim të pastër, të shpaluar si i tillë gjatë shekullit të kaluar, por që megjithatë po e zgjatë ndikimin e vetë edhe gjatë moteve të shekullit të njëzet e një, e po kaq madje njëherit paraqet edhe braktisjen e pa shpallur të leximit të tekstit, si e vetmja shenjë estetike. Poezia e pranishme në faqet e përmbledhjes Princi i Dashurisë, padyshim në një vjershërim dhe shpalim të thekur të mëtimeve dhe kërkimeve letrare, në imazhet dhe substancën e prekshe, në leksikun dhe shprehësinë e formatuar, materializon realisht një situatë të trefishtë, si thënie dhe domethënie, si realitet imagjinar, të krijuesit dhe të vetë shkrimit poetik:

A – Të poetit të shquar dhe mjaft të fuqishëm të poezisë popullore, si teknikë dhe frymë, si ngjizje dhe tharm shkrimor, si dëshmi dhe shenjëzim letrar dhe poetik, që megjithatë ka përthithur në palcën e vetë, si prani dhe materie, ngjyresë dhe frymim, energjinë e poetikës së dashurisë të Jeronim De Radës, Z. Serembes, N. Frashërit, A. Z. Çajupit, A. Asllanit, L. Poradecit, Fan S. Nolit, P. Markos etj. , si dhe të jo pak mjeshtrave të shkrimit të poezisë së përbotshme. Kjo ndjesi bëhet mjaft e prekshe në sendërtimin e motivit të dashurisë, motivit më të pëlqyer dhe të lëvruar kaq gjerësisht në poezinë e L. Çipës. Pra, moria e poezive të këtij libri, ku është përmbledhur dhe shpalosur, përgjithësisht dhe veçmas, poetika e shkrimit të poezisë së sinkretikës poetike, pra e ligjëritimit të fjalës poetike, si një sharm dhe vel që të ndërmond dhe fanit, si të gjallë dhe të plotë ngjyrat, magjinë e natyrës së dashurisë, e në jo pak raste edhe atë të natyrës së bregdetit të detit Jon, çka dëshmon qartësisht se kemi të bëjmë me një poet popullor, fundekrye të kultivuar dhe thinosh përnga fjala dhe ritmika, që megjithatë ndjehet mirë pikërisht në udhëkalimin e të dy tipologjive shkrimore të poezisë, si orale dhe librore, njëkohshëm.

B – Të poezisë së mirëfilltë edhe si të kultivuar, çfarë edhe sendërtohet fare qartësisht, sidomos kjo bëhet më e dukshme në strukturimin poetik me cikle të veçantë, posaçërisht me katër cikle, të plota dhe të pasura në lloje dhe tipologji shprehjeje, si dhe po

ashtu edhe e lëvrimit të poemës së vendosur në fund të librit, që në fakt edhe ka ulur siparin e përmbledhjes së poetit, nëpërmjet një befasie poetike, si frymë dhe shenjë, teknikë dhe shprehësi. Shkrimi i poezisë së kultivuar prej autorit, me po kaq lehtësi sa edhe e para, përpos të tjerash, zbulohet dhe shenjtërohet edhe nga shfrytëzimi dhe shkrimi, në vjershërimin e poetit, i të gjithë metrikës së shqipes, klasike dhe të riformuluara, po kaq edhe i strofimit të larmishëm të poezisë, si dhe në mënyrë të veçantë, ku faktohet dhe preket në përzgjedhjen e prekshe leksikore, mbase me një lodrim të thekur të fjalës, mu sikur të ishte vetë pëllumbesha e dashurisë, e cila rastisë që të përfothet edhe nga vala e detit, si dikur perëndesha e bukurisë, Afërdita e lashtësisë, ngjizur aq bukur në ato vargje dhe situata poetike të përveçme dhe tejet të thukta.

C – Të poetit lirik, padyshim një zë orgjinal dhe i fuqishëm i lirikës shqipe bashkëkohore, madje si një përfaqësues i thekur i lirikës së pastër (purolirikës), ku poetika e tij krejt natyrshëm huamerr, njëherit dhe madje me të njëjtën gjatësi vale, në ligjërimin e poezisë gojor, po kaq edhe në poetikën e kultivuar, të shkrimit të poezisë shqipe, duke u kthyer kështu në një fakt letrar të dyfishësisë letrare, i cili ka përthithur në materien e vetë gjithë përvojën e mëhershme, porse po kaq edhe ka formatuar fytyrën e vetë, pra të poetit buzëhollë, që nuk shkëput lidhjen me burimin e artit popullor. Mbi këto të dy binarë, pra lirika gojore dhe përvoja e shkrimit të saj në gjuhën shqipe, të prekshe dhe shenjuese të letrares, madje edhe si një gjurmë e pashmangshme për secilin krijues të fjalës shqipe, L. Çipa end dhe thur kaq bukur poetikën autoriale, të fjalës letrare, tejet të hapur si kuptim, e po kaq të ngjeshur si figurshmëri, si dhe tepër tronditëse si ndjesi dhe e larme si shprehje, duke sendërgjuar kështu një poezi sa prekëse, aq të papërsëdytshme në magjikën e shprehjeve letrare të gjuhës shqipe.


Dashuria si shkas i fjalës poetike apo zjarrëllimë shpirtërore, mbase ca më tepër si vatra kryesore e sendërgjimit të shkrimit poetik, si frymë dhe topos, si humus dhe prani ekzistenciale e qenies, si dhe e ngjizur me një brishtësi ndjenje dhe tharm artistik, ndonëse për hir të së vërtetës në faqet e këtij libri, kjo ndjenje e bukur, shpaloset në disa mënyra:

- Si portretizim i jashtëzakonshëm i vashës, që ia ka djegur dhe përvëlur zemrën poetit, një penelimi i hollë dhe domethënës i bukurisë dhe rrezatimit, që shpërndan ajo përçark, e madje si një çast i bukur i lëvrimit të një tipi poezie të dashurisë, të veçantë dhe lozonjare, ku edhe përndritet më tepër pasoja e kësaj ndjenje fisnike dhe zburimore të shpirtërave njerëzorë, e kësaj ndjenje që e shpalos fytyrën e vashës në ca vegime gati të paimagjinueshme, teksa shkruan:

Si qiri je ndezur,
Si fleta më dridhesh,
Dhe prapë duke qeshur,
Nga flaka më ngrihesh. ,

të cilat e zbulojnë kaq shkurt dhe fuqishëm poetikisht, vetë përjetimin e objektit të bukurisë, pra vashën bukuroshe, epiqendrën e poetit për ta kënduar kaq bukur dhe me lakonizëm dashurinë, mbase qiellin tokësor të shpirtit njerëzor, e veçmas të unit poetik.

- Si një përjetim krejt i maktshëm i vetë ndjenjës së dashurisë, e ku merr pjesë edhe vetë natyra, me të gjithë gjallërinë dhe lodërtinë e vetë, e cila po kaq shërben edhe si një dëshmitar i këndshëm, i pranishëm së dashurisë, si ndjenje e brishtë, kur shprehet:



Maleve s'u flihet,
Se borë më s'kanë
erërat se ç'zihen,
yjet në det ranë...
Pse s'u bëre diell,
Dilje mbi Himarë.

ku ndjenja e dashurisë, këtu dhe tjetërkund në poezinë e vëllimit poetik Princi i Dashurisë, bashkëlidhet krejt natyrshëm, përveçse si dritë dhe rrezatim i erotikës së thellë dhe shpesh havardare, edhe me dashurinë e pakufishme për vendlindjen, Himarën bukuroshe dhe kryeneçe, e cila përfaqëson dhe simbolizon gjithë zonën e Bregut, pra edhe Pilurin.

- Si rimarrje, qëllimore dhe estetike, e konceptit të hershëm të dashurisë, ku loja dhe ankthi janë pranvendosur, madje edhe kaq të pranishëm në poetikën e shqipes:

Ah, moj mike e djallëzuar,
Si s'të ranë lavdërimet.
Ti je besë e pabesuar,
Ndaj dhe i shkelmon besimet. ,

tanimë si një marrëdhënie e prekshe tekstesh dhe situimesh të shumta letrare, mbase më tepër e frymës së poetikës së Naim Frashërit, Zef Serembes, Ali Asllanit dhe Lasgush Poradecit etj.

- Si një paralelizëm i gjetur dhe i hollë, madje edhe i gërshetuar, bukurisht dhe poetikisht me natyrën e bukur, aty përçark vendlindjes, teksa shkruan:

Ç'ka kjo erë e prillit,
Që të shpërndan flokët,
Në vakt të bilbilit,
Do lulëzojnë mollët.

e cila na zbulon me kaq finesë dhe ritmikë të thekur poetike, pranëvënien e dy bukurive, dy shenjave dhe frymëve të shenjta, të fanitjes së dashurisë dhe bukurisë së natyrës, të cilat në fakt gjelljnë, si kurdoherë në marrëdhënie të ndërsjella.

- Si një vlerësim i beftë dhe fare marrok dhe po kaq edhe tejet i ngritur i unit poetik, mbase shumë më tepër të shpupuritur nga ngazëllima dhe përvëlma e dashurisë, sidomos kur nënvizon:

S'di ku vanë sytë,
Ç'mjegull na i zuri,
Fustani është grisë,
Nga era që vuri,
Naze, moj nazuqe,
Nazuqja fodulle.

ku në fakt përbashkohen dhe ndërthuren edhe ca më shumë shenjat e pranishme letrare të shkrimit të poezisë nga ana e poetit, pamëdyshje të poezisë që rrokë shpirtin dhe këndon dhembshurisht për të.

- Si një akt, i përveçëm dhe i lartuar i pranishëm së dashurisë, kësaj ndjenje të bukur dhe tronditëse, të lashtë sa vetë bota, prushuese dhe rrezëllitëse, kur shprehet:

Mike, kur ke mik në jetë,
Ç'e do kuranin, ungjilin
Ti je perëndia vetë,
Kur ke mikun, ç'e do yllin?
O mjaltoja e mjaltit,
O bora përsipër malit!!

ku shpaloset fare qartësisht shenjtërimi i marrëdhënies së dashurisë, e cila shpërndan rrathë lumturie, tashmë e materializuar si një marrëdhënie në çift, pra të mikut dhe mikes, si një numër krejt i prekshëm, pra këtu na vjen dyshi si një numër me shumë vlera, që të shpie natyrshëm gjer tek poetika europiane, që ka shtegtuara nëpër kaq e kaq shekuj të shkrimit të poezisë dhe të letërsisë në përgjithësi.

- Si një thirrje tipike e poezisë popullore, e gatshme dhe e përpunuara mjeshtërisht nga poeti, teksa shpaloset:

Ti, m'u bëfsh nuse e vjehrrës,
Nuse Bregu e Rivierës,
Nuse e valëve t' shumta,
Të marrtë me vetë shkuma,
Në shkumë t'u laftë buza. ,

ku uratat e derdhura si me magji, si dhe me një lehtësi të paparë mrekullie, madje në këto vargje të shpalosura në formën e një mallkimi të përmbytur, pra si një uratë e fshehtë dhe e përmbytur, e rrisin edhe ca më tepër gradacionin shprehës të kësaj situatë tepër të thukët letrare.

- Si një fanitje ëndërore dhe disi e paimagjinueshme, lodëruese dhe përkëdhelëse, që të ndërmend bukuroshen e poetikës popullore, kur lëshon klithmën, kozmike dhe tokësore:

M'u shfaqe si yll pas nate,
Që mat qiellin me çape. ,

që skicon në këtë rast, veçmas të tjerash bukurinë e paimagjinueshme të vashës si perri, me fanitje kozmike, e cila duket se buron prej ëndrrash djaloshare, që e spërkasin poezinë më një tis mrekullimi dhe drite, zmadhimi dhe shpalimi të njëmendtë ndjesor.

- Si një dëshmi, e thekur dhe krejt e rrokshme, mbase nga më burimoret e bukurisë së vashës dhe të vendlindjes, pra si një bashkëshkrim i dy dashurive të mëdha, ku zjarri përvëlak i dashurisë është edhe më i fuqishëm, teksa ligjëron, kaq bukurisht:

Moj e bukura bregdetare,
Trëndafil i çelur taze,
Lulja përmbi portokalle,
E veshur në manushaqe.
Ngaqë s'ke naze të dua,
Kam ndërmend të të marr grua,

e cila të shpërfaq, më tepër se sa gjithëkund në poezinë e këtij libri, një prani të një dashurie tokësore dhe të përjetuar, me kaq shumë makth dhe adhurim, porse të mbështjellë me një tis bukurie të paimagjinueshme, çka na zbulohet në realizmin e portretit të saj, ose më mirë të fantijes ëndërore të poetit për bukurinë e vashës.

- Si një çast, i përveçëm dhe lodërtar, tashmë edhe duke u transformuar heroin lirik, unin identifikues, të zgjimit të vagullimtë dhe krejt të madhërishtë të vashërisë (vajzërisë), kur shpërthen:

Ik, moj erë, i thashë,
Qenke e pabesë,
ik se unë jam vajzë,
E paputhur jeshë.

që na paraqet sidomos ankthin dhe zjarrëllimën e dashurisë së parë, mbase të puthjes së parë, të përjetuar mbase nën etheet e një marrëzie të ëmbël dhe tejet tronditëse.

- Si një hiperbolizimi krejt i pagjasshëm, i thirrjes dhe dëshirës, marrëzisë dhe mallit prushues, kur këndon, më tepër me ulurima përzhitëse të ndjenjës së dashurisë:

Hajde mike, hajde,
T'i vëmë zjarrin botës,
Dhe pastaj mbi male,
Të rrimë sipër borës.

ku preket dhe ndjehet një situatë sipore e mallit dhe përmallimit, etjes dhe dëshirës së dëshiruar, mbase e një zjarri përvëlak, që nuk reshtet dhe mbarohet asnjëherë në valën e përvëlimës së dashurisë.

- Si një klithmë e pazakontë, ku bota shuhet dhe tretet, shuhet dhe rilindet, madje ku njerëzia përshkundet dhe lodron nën etheet e dashurisë, ka gjasa të përkundjes nën ledhet e saj, siç ngjet në vargjet:

Ty, moj bukuri magjike
Sikur fronin të ta dija,
Do t'u thosha perëndive,
Perëndia është dashuria.

ku krahas përçqasjes së hyjnore që e bart Perëndia, po kaq hyjnore dhe e dëshiruar, gjithnjë simbas konceptit që shprehin vargjet e poetit, mbase edhe diçka më tepër është dashuria, kjo ndjenjë që zbulon dhe larton shpirtërat njerëzorë.

Këto forma, thelbësore dhe shenjuese, poetike të një erotike të hapur dhe të tejdukshme, padyshim edhe të tjera në poezinë e autorit, aq më tepër që janë derdhur bujarisht dhe me një koncizitet të brishtë, sendërtojnë dhe shpalojnë poezinë e lirikës erotike, si një ndjesi e bukur dhe që na zbulon njerëzoren në një dritë gati të paimagjinueshme, po kaq uni poetik, na shpalon një poet lirik të mirëfilltë, si frymë dhe shenjë, si gjurmë dhe shprehësi. Prania e këngës, po kaq e rrokshme në shkrimin poetik, kur nënvizon:

Sikur tërë bota të prishet,
Rrafsh me detin të vithiset,
Mua pa këngë s'më rrihet
Dhe brenda dheut ku flihet.

të cilat lajmëtojnë se kemi, kaq pranë dhe në një ligjërim të thekur letrar, një poet të lirikës së pastër shqipe, porse që në shtegtimin e vetë, shkrimi poetik, prania e dëshmisë letrare, më tepër e vendos në cakun ku pikëtakohet gojorja me librorën, madje më shumë, tashmë anësohet nga kjo e fundit, çka merr krahë dhe fluturim të parrokshëm, veçmas të tjerash në vargjet e poemës:

Aty të më lahet shpirti
Dhe të marrë penën të shkruaj.
Degë më degë bilbili,
nga gjum' i rëndë do më zgjuaj.

ku duket kaq qartësisht poeti mjeshtër i shkrimit autorial, si ndjenjë dhe mendim, si varg dhe fjalë e qëlluar, si kumt që përçon dëshirën e pa këputur për jetën e lumtur, të mbushur dingas me dashuri.

Materia tekstore, si varg dhe fjalësi letrare, si vjershërim dhe ngjyresë artistike, e vëllimit poetik Princi i dashurisë, vetvetiu të sugjeron leximin dhe rileximin, së paku në dy rrafshje:

- Një tekst poetik, i thekur dhe i përveçëm, që

përgjithëisht bart dhe përçon përvojën shkrimore të oralitetit, pamëdyshje pa lënë asgjamangut nga shenjat dhe vlerat e tij.

- Si një tekst poetik, tashmë autorial, pra i një rrugine të kërkimit dhe shkrimit të poezisë, nga burimësia e shpirtit dhe vetëdija e thekur, e prandaj me ç'duket vijon që ajo të mbetet perëndesha e fjalës, me rrezatime dhe ngjyresa, gati të paimagjinueshme.

Prej leximit të të dy rrafshëve, të endura kaq mjeshtërisht nga poeti, madje edhe në një formësim letrar të dyzuar dhe të dyfishuar, njëherit brenda dhe jashtë shkrimit të poezisë shqipe, të kësaj ndërkohje, por edhe si e vetmja tejçyrë e këndimit/këngëtimit të poezisë, pra thjesht dhe vetëm si një lexim neutral, por edhe një situatë, pothujase e pagjasshme, shpesh herë e këngëtimit të vargjeve, me vete dhe përshpërëma leqendisëse. Atëhermë, leximi i poezisë, pra si një këndim i këngëtuar, ngjet jo fort shpesh, porse vetëm në rastet kur pikëtakohet poezia dhe poeti. E kemi shijuar, me dëshirë dhe pandërprerje, nëpër kaq e kaq shekuj, poezinë e Homerit, por vetë poeti, gjithësi mbetet sërish në vegimin e mjegulltë të verbërisë. Jemi mahnitur, me të drejtë me Esenin, poezinë dhe artin e tij, por i pashlyer nga memoria e qenies, do të jetë ai si një pishtar i fjalës poetike, sidomos për guximin e treguar, për të mos ia falur përfundimisht lirën poetike revolucionit proletar. Sepse, me ç'duket, poezia fluturon mbi të gjitha lëvizjet dhe pëmbysjet, horizontet dhe hapësirat e rrokshme dhe të parrokshme. Poezia, megjithatë poezia, gjithnjë e më shumë shtegton për më tutje. Libri Princi i Dashurisë, plazmon në një pamje të veçantë dhe të përndritur, njëherit dhe në një bashkëlidhje të thekshme, poezinë dhe poetin, ka gjasa më shumë pasojën dhe krijuesin, të cilët bashkudhëtojnë dashamirisht dhe shpërndajnë rrezatime ndjesinash dhe gjurmë arti poetik. Kurora poetike e përmbledhjes, që thyen dhe formaton kodet e ligjërimin të poezisë shqipe, si një shkrim i përbashkimit të përvojave të ndryshme, gojore dhe librore, madje i ngjizjes së një poetikë të sinkretikës letrare, e jo vetëm i kundrimin absurd si krejt të përndara, pra poezinë gojore dhe librore, për shumë kohë dhe hapësira. Kjo kurorë poetike, e përveçme dhe lozonjare, ka vënë në qendër dashurinë, ndjenjën e lashtë sa vetë bota, si dhe paraqitjen e saj në të gjitha këndet e mundshme ekzistenciale. Energjia, e fjalës poetike, e fjalës së varg dhe figurë, si ndjenjë dhe shenjë artit, shpaloset si një klithmë e përtejme, veçmas në vargun O Shokë, vdeksha nga kënga, i cili lajmëron shkëputjen e poezisë nga vatra krijuese dhe gaditjen e saj për një shtegtim të largët, nginjur tashmë në mister dhe univers të bukurisë së fjalës poetike. Bashkëshkrimi, oral dhe libror, popullor dhe autorial, i sendërgjuar qëllimisht kështu, pra me vetëdije dhe aspiratë shkrimore, madje i konceptuar edhe si një teksturë e beftë, jep shpresa se poetika e shqipes po e vijon mbijetesën e vetë, gjuhësore dhe letrare, pa u shkëputur nga ligjërimi gjithkohor dhe gjithhapësinor i lavrimit të saj, me rrezëllima dhe fantije arti.



Dymbëdhjetë letrat e Mjedës dhe pesë letrat e Majerit

KORRESPONDENCA E PLOTË NDËRMJET NDRE MJEDËS DHE GUSTAV MAJERIT

Në numrin 1 të revistës "Arsimi popullor", Tiranë, 1967 u botuan letrat që Ndre Mjeda i dërgoi albanologut të shquar gjerman, Gustav Majer përgjatë viteve 1882 – 1883, përkthyer nga Jup Kastrati. Për to pati shkruar edhe Martin Camaj i cili në revistën "Shejzat" shpjegon disa syresh.

Paraprakisht, duke folur për përgjigjet e Majerit, ai thotë: Mjerisht nuk i kemi letrat e Meyer-it: kushdi ku kanë mbarue gjatë udhëtimeve të shumta të Mjedjes jashtë dhe mbrenda Shqipërisë.

Kur u botua Vepra Letrare e Ndre Mjedës ("Naim Frashëri", 1988), në vëllim II botohen për të parën herë edhe përgjigjet e albanologut të cilat, sipas një shënimi sqarues, ruhen pranë AQH të Shqipërisë, F. 65, D. 105.

Shumë i çmueshmi zoti Profesor,

Dëshiroj të kem gramatikën tuaj shqipe; e kam kërkuar ndër disa librari, por pa dobi. Marr pra, lirinë t'i lutem zotërisë suaj që të keni mirësinë të më tregoni emrin e botuesit; e, në qoftë se janë mbaruar kësobëllat pranë botuesit, do t'ju lutesha të më dëfteni, se si mund ta gjej ndryshe.

Kam lexuar dhe studiuar me kënaqësi të vërtetë "Fjalorin etimologjik", i denjë për emrin e madh që keni fituar, me të drejtë, me veprat tuaja gjuhësore; dhe kam parë me habi aftësinë e madhe në deduksionet etimologjike, si edhe dijen e gjerë që keni treguar në të. Në ndonjë gjë, më duket se zotëria juaj keni pasur tepër besim të Rosi, me të cilin simbas meje, nuk ia vlen të merresh.

Pëveç kësaj, ortografia e shkrimtarëve shkodranë, e pra e librave të botuar nga Propaganda, nuk i paraqet me besnikëri tingujt e gjuhës sonë. Prandaj, në fjalorin tuaj i janë veshur së folmes shkodrane tingujt, që në të vërtetë nuk gjenden.

Shumë ndryshime të tjera kisha për t'ju parashtruar, sikur të kisha fatin t'ju shijha për së afërmi. Është krejt e vërtetë se unë jam i zënë me studime të tjera dhe shqipes nuk mund t'i kushtohem, veçse në kohë të lirë.

Së fundi marr guximin t'ju fal një kësobëll të një libri tim të vogël, botuar ndonjë vit më parë. Meqenëse është caktuar për përfitim shpirtëror të popullit, nuk kam mundur ta shkruaj me një gjuhë të pastër dhe me një ortografi të përpiktë, pse është hartuar me qëllim të paracaktuar.

Zotëria juaj le të ketë mirësinë ta pranojë si një shenjë të nderimit tim më të thellë që kam për ju.

Mbetem me nderim të thellë.

NDRE MJEDJA
Krakovi
(Rruga "Kopernik", 26)
Shumë i çmueshmi zoti profesor,

Kam mbetur me të vërtetë i habitur nga sjellja juaj shumë e njerëzishme, me të cilën më falët një gramatikë tuajën, dhuratë për mua shumë e nderuar, pse më ka ardhur nga një njeri i tillë i lartë si zotëria juaj. Brenda pak faqesh ju keni parashtruar, me një gjykim tepër të hollë dhe me dorë prej mjeshtri, më tepër se çka gjendet ndër libra të tjerë me vëllim më të madh. Shpresoj se me kohë do të shtyheni ta zbukuroni me një stoli edhe më të bukur gjuhën tonë, duke hartuar një gramatikë më të gjerë, simbas parimeve të shkencës moderne.

Marr guximin t'ju dërgoj disa libra të vegjël shqip, që nuk gjenden të shënuar në listën që keni vënë në fund të fjalorit tuaj; janë pak të përdorur, por për t'i pasur të rinj, do të më duhej që të shkruaja në Shkodër, e kështu, puna do të shkonte disi gjatë. Shpresoj se do të ma falni këtë panjehëzi. Brenda pak ditësh do të më vijë një libër imi asketik, botuar këtë vit nga Propaganda dhe unë do të kryej një detyrë, duke jua dërguar një kësobëll.

Duke përsëritur falënderimet e mia më të ndjeshme, mbetem me nderim të thellë.

NDRE MJEDJA
Krakovi, 2 maj 1892



Shumë i çmueshmi zoti Profesor,

Zotëria juaj jeni treguar kaq i njerëzishëm, saqë nuk di si të sillem. Ju falënderoj për sa di e për sa mundem për dy fashikujt e vlefshëm, njëri më i bukur se tjetri. Ju e keni kthyer me famë shkencore studimin e gjuhës shqipe dhe e keni vënë në rrugë në një mënyrë të atillë, që do të mundet, ndoshta të përparojë edhe më tepër, siç ngjet ndër gjërat njerëzore, por të ndërrojë rrugë, jo kurrë.

Veç kësaj më ka gëzuar se s'ka më shpresa që ju keni për të përpiluar një gramatikë më të gjerë, sipas parimeve të gjuhësisë krahasimtare, e cila do të jetë hijeshia më e lartë për atdheun tim.

Kam shkruar në Shkodër që të më dërgojnë disa libra të tjerë prej andej. Është një përkthim i Kuvendit të Arbrit, bërë nga Imzot Radoja, botuar në Romë, më 1872; ndarë nga ai i vjetri dhe botuar së

pari më 1868, prekur prej zotërisë suaj në Fjalorin tuaj. Nga i njëjti autor është një katekizëm i shkruar mjaft mirë. Këta libra dhe një histori e shenjtë e botuar në Shkodër më 1882 janë ndoshta më të mirët për të folurën shkodrane. Porsa të më vijnë do të nxitohem t'ia dërgoj shpejt zotërisë suaj.

Do të më lejoni një vërejtje të vogël: Siç jua thosha edhe një herë tjetër, ortografia shkodrane nuk i shpreh mirë tingujt e gjuhës dhe përdor shenja që e çojnë lehtësisht në gabime atë që nuk i ka dëgjuar nga gjuha si shqiptohen fjalë të tilla. Kështu në shkodranisht – nd – nuk është asimiluar në – nn- siç ndodh në ndonjë dialekt të Italisë, duke thënë "quanno" në vend të "quando" – (=kur), por në një tingull të posaçëm, në të cilin ndihen që të dy tingujt bashkëtingëllorë të sipërthënë. Një tingull i tillë nxirret duke mbështetur gjuhën mbi dhëmbët e sipërm, ndërsa shqiptohet bashkëtingëllorja n. Misionarët e huaj, e për pakujdesi edhe disa shkrimtarë shqiptarë, shkruajnë shpesh vetëm një n. Përsa i takon vërejtjes suaj në "Studime shqiptare", II, 67. – Një gjë e ngjashme ndodh edhe me mb-, edhe me –ng- tingull që duhet të dëgjohet që të kuptohet plotësisht, sepse unë nuk di si ta tregoj në shkrim.

Më duket se do të kishite qenë mjaft e dobishme sikur zotëria juaj në vend të g'u g'uni, g'uh etj., të kishite riprodhuar trajtën shkodrane gju-ni, gjak-u u-j – zëvendëson tingullin –l.

Por po shoh se kam pasur tepër guxim dhe kam vërtetuar fjalën e urtë që thotë: "Do të mësojë veja pulën"

Ju lutem pra, të më falni; ndërsa mbetem me nderime të thella.


NDRE MJEDJA
Krakovi, 2 maj 1892



Shumë i çmueshmi Zotëri,

Do të isha thellësisht i detyruar ndaj zotërisë suaj sikur të donit të më bënit nderin të më tregonit se ku mund të gjendet një kësobëll e librit "Net pellazgjike" e Reinholdit dhe nga ai i Ksilanderit dhe me çfarë çmimi.

Pres me padurim nga Shkodra librat që ju premtova. Më kanë



shkruar se do të m'i dërgojnë shpejt. Në qoftë se do të më takojë të gjej të tjerë, nuk do të mungoj t'jua dërgoj.

NDRE MJEDJA
Krakovi, 24 qershor 1892



Shumë i çmueshmi Zotëri,

Kam marrë letrën tuaj shumë të njerëzishme dhe dje më mbërritën gjithashtu fashikujt e dy të përkohshmeve shqipe. Nuk mund ta shpreh sa duhet me fjalë kënaqësinë që provova: Unë ndiej për zotërinë tuaj mirënjohje të pakufi. Ju keni tek unë një mik, i paaftë ndoshta për ta shpërblyer bujarinë tuaj, por që për dashuri dhe besnikëri nuk ua lëshon vendin të tjerëve.

Kam shkruar në Lajpcig për dy librat e Reinholdit dhe të Ksilanderit dhe shpresoj se do të jenë ende. Është dëshira ime që për sa kohë gjendem ndër këto anë për studime teologjike, të mbledh sa më shumë që të mundem libra të botuar në Gjermani për gjuhën shqipe. Është e vërtetë, unë kam pak mjete sepse si fetar, nuk kam asgjë timen dhe jam nën juridiksionin e të tjerëve, megjithatë pak nga pak shpresoj të mbledh ndonjë gjë. Zotëria juaj do të më bënte një nder shumë të madh, sikur të më dërgonte katalogë antikuaresh ku mund të ketë libra mbi gjuhën shqipe. Është e kotë të them se këtu në Krakovi nuk ka kurrë nga këta, as në bibliotekën e Universitetit ku pak kohë më parë kërkova veprën e Hahnit. Por këtu nuk gjenden as të përkohshmet shkencore, ku keni shkruar zotëria juaj aq artikuj të bukur. Nga ana tjetër, unë kam nevojë t'i mbaj pak gjatë pranë meje këto punime të këtij lloji, pse dua t'ju kushtoj vetëm atë pak kohë që mund t'ua heq studimeve të mia të një gjinie tjetër. Po shtoj se tani nuk jam ende mjaft i fortë në gjermanisht dhe më duhet kohë. Në pushimet e sivjetshme, shpresoj të bëj diçka më tepër.

Në qoftë se zotëria juaj në gramatikën e re krahasimtare të gjuhës shqipe (të cilën dëshiroj ta shoh sa ma shpejt) do të merrte për nënshtresë gegërishten, duke vënë gjithashtu, edhe trajtat e dialekteve të tjera. Do të bëhej – besoj unë – themeluesi i letërsisë shqipe. Për arsye se në Shkodër kemi nën drejtimin tonë shkolla që për kushtet e vendit sot janë mjaft të ngritura, ku mësohet edhe gjuha shqipe, por pa nivel, prej nga dalin të rinj që tani janë mësues në disa qytete të Shqipërisë, unë besoj se prej këtu, brenda tre a katër vjetësh do të dërgohem atje; dhe dëshira ime do të ishte të themeloja atje, me pëlqimin e prorëve, një shkollë të përsosur në gjuhën shqipe; punimi juaj i përkthyer në italisht dhe në shqip do të ishte teksti më i përkryer.

Jua shkrova këto zotërisë suaj në mënyrën më konfidenciale, si mikut tim shumë të dashur dhe do të dëshiroja që të mbeteshin në mes nesh, sepse jo nga të gjithë do të mund të kuptoheshin drejt.

Po ju dërgoj një të përkohshme të vogël shqipe që botohet në Shkodër: fillori në mars të 1891. Nga viti i parë mungojnë dy numra, tetori dhe nëntori të cilët nuk i gjej dot, por do t'i sjell nga Shkodra. Dora-dorës, sa herë që të botohen të tjerë brenda këtij viti, do të kem kujdes t'ja dërgoj zotërisë suaj. Ju lutem, vetëm të mos e vëreni ortografinë e cila është plot me gabime.

Pranoni, zoti profesor, përluljet e mia më të thella dhe gjithë nderimet.

NDRE MJEDJA
Krakovi, 2 korrik 1892



Shumë i shkëlqyeshëm zoti Profesor,

Lus t'i pëlqeni këto pak libra që po marr guximin t'ia dërgoj zotërisë suaj. Historia e shenjtë nuk më ka ardhur ende, por shpresoj se do ta keni brenda pak kohe; gjithashtu shpresoj se do të kem mundësi të kem edhe libra të tjerë që tani janë duke u shtypur në Shkodër. Kam kërkuar atje një katalog librash që janë botuar prej tyre dhe do t'jua dërgoj. Për disa libra më shkruajnë se janë mbaruar së shituri dhe nuk gjenden kësobëllat; por sapo të më bjerë rasti të shkoj atje, do t'i gjej, sigurisht dhe do t'jua dërgoj.

Kam shkruar në Palermo te Botuesi Amenti për të parë një kësobëll të "Rapsodive shqiptare" të Zef Skiroit, por nuk kam marrë përgjigje. A mund ta dijë zotëria juaj ku do të mund të gjeja një kopje? Në qoftë se nuk gjendet në shitje në ndonjë vend, do t'i lutesha zotërisë suaj të kishite mirësinë të ma jepte hua për ndonjë muaj kësobëllën tuaj se po digjem nga dëshira për t'i lexuar ato vjersha.

Nuk e di nëse ju keni vërejtur një gjë. Në librin e Bogdanit disa ekzemplarë kanë kapakë të ndryshëm. Prej jush vëllimi i dytë është dhënë kështu: "L'infallibile verità..." (E vërteta e pagabueshme), shpjeguar në dy gjuhë të mjaftueshme, në italisht dhe sllavisht. Në kësobëllën time, fleta e kapakut është një fletë e ngjitur dhe më e bardhë se të tjerat; titulli është: L'infallibile verità... (E vërteta e pagabueshme. E dëftueme në jetën e Jezu Krishtit dhe e zhvillueme në ungjillin e tij të shenjtë përmes veprës etj.. Pjesa e dytë). Nuk ka ndonjë shënim tjetër se është në këto dy gjuhë. Në kësobëllën e E. Teza (siç e preknin zotëria juaj) duket i ndërur kapaku i vëllimit të parë, i cili në librin tim është sikurse në ekzemplarin e zotërisë suaj, por gjithashtu i ngjitur mbrapa. A do të mund të dihej se cili prej dy titujve do të ketë qenë i pari? Bogdani flet për këtë libër dhe për lavdet e bëra atij në një letër latinisht, botuar në Padova pesë vjet më vonë dhe drejtuar kardinal Barbarigos. Unë, këtu, natyrisht nuk mund ta gjej këtë letër. Po zotëria juaj mund ta gjeni lehtë o në Vjenë, o në Padova.

Së fundi, pranoni, zoti profesor, shprehjen e nderimit tim më të lartë.

NDRE MJEDJA
Krakovi, 31 gusht 1892



I ndrituri zoti Profesor,

Po ju dërgoj dy libra shqip të cilët më mbërritën pikërisht sot; librin e Marcozit “Muaji i Majit” nuk e kam as unë, por për dashurinë që ushqej ndaj jush, mund ta kërkoj me ëndje. Kur të shkoj në Shkodër, do ta gjej atje. Atëherë do të mund të gjej edhe libra të tjerë, për të cilët tani më thonë se janë mbaruar. Unë mund t’ju siguroj se kam bërë ç’është e mundur për t’ia gjetur zotërisë suaj, por nuk kam mundur të kem asgjë; me anë të të tjerëve gjithmonë mund të gjejë njeriu atë që dëshiron. Mirë thotë ajo fjala e urtë: “Kush do, shkon; e kush nuk do, dërgon”. Tani janë duke u botuar në Shkodër dy libra të vegjël shqip. Shpresoj se do t’i kem brenda pak kohe dhe do t’ja dërgoj zotërisë suaj.

Kujtoja se këtë vit do të shkoja në Gorizia e do të jetoja kështu më afër jush. Gjatë udhëtimit do të kisha marrë leje t’ju bëja një vizitë. Por punët ndryshuan dhe unë mbeta kështu pa e çuar në vend një dëshirë të madhe timen për të njohur për së afërmi një prej njerëzve më të dashur që kam.

Pres me padurim gramatikën tuej të ardhshme. Në qoftë se ju mund të më thoni pak a shumë se kur mund ta shohim, do të më jepni një kënaqësi të madhe, për arsye se, siç jua kam thënë edhe herë të tjera, unë kam një besim të pakufi të shkrimet tuaja. Kam kërkuar në pesë librari në Lipar, te Herder i Vjenës dhe gjetiu për fashikullin e parë të librit tuaj “Studime shqiptare”, por më kot. Durim!

A ka pasur rast zotëria juaj të lexojë ato që po vazhdon të botojë në “Civiltà Cattolica” (revistën “Qytetërimi katolik”) P. De Cara për ngjashmëritë e etruskëve e të pellazgëve me hetitët? Do të më pëlqente shumë të dëgjoj gjykimin tuaj për këtë punim.

Në Bukuresht, siç mund ta dini, shoqëria “Drita” ka themeluar këtë vit një shkollë pedagogjike për të përgatitur mësues të cilët do të shpërndahen më pas kudo që ka shqiptarë në Gadishullin Ballkanik. Tani janë duke përgatitur tekstet e nevojshme mësimore dhe kryetari (N. Naço, patriot, gazetar. Kryetari i shoqërisë “Drita” të Bukureshtit në vitin 1886) më ka premtuar se do të marr pjesë edhe unë. Disa kolegë të mi të këtushëm duan të dinë nëse zotëria juaj e keni botuar Fjalorin e gjuhës greke. Unë para se të mbaroj dua t’ju lutem për një gjë tjetër, d.m.th. të mbledh, në rast se e shihni të arsyeshme, në një vëllim (po e zëmë në një fashikull të katërt të librit tuaj “Studime shqiptare”) të gjitha ato që keni shkruar për gjuhën shqipe dhe ndër të përkohshmet e ndryshme dhe në raste të ndryshme. Nuk është e lehtë t’i gesh kudo këto të përkohshme ose libra; po të botoheshin në një vëllim të vetëm, do të ishin me shumë dobi për atë që do të dëshironte të kishte njohuri të drejta për gjuhën shqipe.

Në fund pëlqeni, zoti profesor, shprehjen e nderimit dhe të vlerësimit tim më të thellë.

NDRE MJEDJA
Krakovi, 5 nëntor 1892



Shumë i shkëlqyeshmi zoti Profesor

Ju falem nderit një mijë herë për dy recensionet që patët mirësinë të m’i dërgonit, si edhe për letrën tuaj shumë të njerëzishme të datës një të këtij muaji. Në qoftë se dëshirat e mia rreth gramatikës shqipe nuk do të kënaqen kaq shpejt, për shkak se jeni i rënduar me punime të tjera, gjithnjë më mban shpresa se do të shoh së shpejti fashikujt e rinj për përemrin e për foljen. Zotëria juaj më pyet nëse e kam punimin tuaj: “Elementet latine në shqipe”. Fatkeqësisht nuk e kam, ndonëse kam tepër nevojë për të. Fashikullin e dytë dhe të tretë të “Studimeve shqiptare” i pata këtë vit nga sjellja juaj e njerëzishme. Ju falënderoj, gjithashtu, me gjithë zemër për kërkimet që keni bërë në lidhje me fashikullin e parë të studimeve të lartpërmendura. Duhet të kemi durim. Në veprën tuaj “Përrallat shqiptare” a është edhe teksti shqip?

Më falni zotëri, por nevoja më detyron të bëhem pakëz i pasjellshëm ndaj zotërisë suaj. Do t’ju lutesha nëse mund të më tregoni ku mund të gjendeshin të gjitha ato shkrimet tuaja që janë shënuar në fund të “Fjalorit tuaj etimologjik”. Unë me përjashtim të gramatikës, të cilin zotëria juaj pati mirësinë të ma dhurojë, nuk kam të paktën një vepër nga ato e do të ishte një gjë shumë e pëlqyeshme për mua, po të mundja t’i gjeja të botuara veçmas.

Përsa i përket veprës së Skiroit, në rast se zotëria juaj do të ma huante për një ose dy muaj, do të më jepte një kënaqësi shumë të madhe; dhe ndër të kremtet e ardhshme kisha për të pasur diçka më tepër kohë për ta lexuar.

Një tjetër pyetje të pavend: Jeronim de Rada a është ende gjallë?

Me këtë letër timen po ju dërgoj dy numra të së përkohshmes “Elçia” (organ që dilte në Shkodër në këtë periudhë).

Mungon shtatori të cilin nuk ma kanë dërguar, por do të më vijë më vonë. Numri i dhjetorit nuk më ka ardhur ende. Përveç këtyre do të shihni një libër tjetër të vogël të A. Jungut. Marcozi është duke botuar në Shkodër një libër të vogël, një kësobëll të së cilit do të ma dërgojë dhe unë do t’ja dërgoj zotërisë suaj. Lutem, kini mirësinë t’i pranoni këto gjëra të vockëla si një dëshmi nderimi dhe dashurie që ushqej për ju.

Pranoni së fundi nderimet më të përvuajtura.

NDRE MJEDJA
Krakovi, 5 dhjetor 1892



Shumë i shkëlqyeshmi zoti Profesor,
Prej dy ditësh kisha përgatitur një letër për t’i uruar zotërisë

suaj një Mot të Ri plot gëzime, ashtu si po bëj me këtë, duke lutur Zotin që t’ju japë jetë të gjatë e plot shëndet, në mënyrë që ju të mund të vazhdoni t’i shtoni dafinat që po fitoni në karrierën tuaj kaq të çmueshme për shkencën dhe kaq zulmëmadhe për atdheun tim të shkretë, Shqipërinë. Por më vonë më ra ndër mend të përipiqem për hartimin e katër vargjeve shqip për nder tuaj. Dhurata është e varfër se për më tepër u bë me ngut, por shpresoj se ju për njerëzi s’do ta vini re. Siç e shihni, poezia është në të folmen e Shkodrës.

Kam marrë, pa vonesë, “Rapsoditë” e Skiroit dhe dy artikujt tuaj. Ju falemnderit shumë. Sapo t’i mbaroj së lexuari “Rapsoditë”, do të kem kujdes t’ju kthej përsëri. Duke ju çuar urimet e mia më të përzemërta, nënshkruar më gjithë nderim,

NDRE MJEDJA
Krakovi, 28 dhjetor 1892



Shumë i shkëlqyeshmi zoti Profesor,

Ju jeni treguar shumë i mirë, duke i pëlqyer ato vargje të miat të varfra, që bëra për zotërinë tuaj. Do të dëshiroja të kisha fuqi edhe më të madhe për t’u bërë të njohur bashkëatdhetarëve të mi meritat tuaja të mëdha për ne. Derisa atë kem jetë, nuk do të pushoj kurrë së shpalluri botërisht këtë. Vetëm për një gjë ju lutem: të vazhdoni siç e keni në mend, punimet tuaja për gjuhën tonë. Në qoftë se ju besoni se ky hartim imi do të dalë me faqe të bardhë për këtë letërsi shqipe të palëvruar sa duhet, atëherë do ta botoj së bashku me poezi të tjera, mbasi të mbaroj studimet e mia, po të më lejojnë Eprorët. Botimi nga ana e zotërisë suaj si provë poezie shqipe do të ishte për mua një nder i madh, edhe sikur nuk do t’ju ishte kështuar ju. Gjithnjë, po ta dija se do të bëja një punë me dobi, duke ju dhënë rastin të botoj ndonjë sprovë poezie shqipe, përveç atyre vjershave të mia të dobëta që gjenden në “Shahiri Elierz” (organ që dilte në këtë periudhë në Shkodër shqip “Këngëtar i ndershëm”), të cilat jua dërgova vitin e shkuar, do të mund t’ju çoja edhe ndonjë tjetër të pabotuar; kuptohet po qe se ju do t’i gjykonit të denja. Por unë dyshoj shumë, sepse janë punime të kohës së rinisë e të krijuara në raste mjaft vetjake. Në “Shahiri” poezitë e mia origjinale janë: “Vaji i bylbylit”, faqe 1-9, “Jetimi”, faqe 12-14. Ky botim është gjymtuar dhe jashtë Shkodrës sigurisht që nuk njihet... Puristët do të bënin zhurmë po t’i shihnin (këto vargje – J. K.), mbasi kanë shumë fjalë turke. Por unë i kam bërë për popullin, i cili kështu flet. Dhe në fillim më ishte e nevojshme të veprojn në këtë mënyrë për të bërë që të lexoheshin më lehtësisht. E më pas artikulli juaj: “Shqiptarët” në organin “Arbri i Rii” më mbron për mrekulli. Këto poezi do të mundja t’i përshekruaja me ortografinë tuaj. Duke dëftuar kështu me përsosmëri shqiptimin e shkodranishtes e cila nuk mund të jepet me ortografinë e Shkodrës. Në qoftë se ju do të dëshironit ndonjë poezi të pabotuar, unë duke lypur leje prej Eprorëve, do t’jua dërgoja me kënaqësi. Poezia “Vaji i bylbylit” është bërë shumë popullore në Shkodër. A. Leonardo de Martino ka bërë një përkthim në vargje italisht; por nuk janë botuar.

Ju falënderoj pa masë për përkrahimin që më bënit të veprës suaj “Fjalori etimologjik”. Unë jam kujdesur teksa doli në dritë; edhe jam shumë i kënaqur. Veçse do të shpërdoroj në mirësinë tuaj, duke ju lutur që, ndonjëherë, kur t’ju vijë përdorësh të gjeni fashikullin e parë të “Studimeve shqiptare” tuaja, të kujtohemi edhe për mua. Shumë me rëndësi janë për mua dy artikujt tuaj që i keni futur në librin tuaj “Sprova dhe studime”. Por nga ky shpresoj se do të ketë mbetur ende ndonjë kësobëll e do të mundem ta shtie në dorë drejtpërsëdrejti.

Nga Shkodra nuk më ka mbërritur asgjë deri tani e më vjen



keq që nuk mund t’ju jap asgjë të re.

Atë që keni bërë ju me një sjellje të njerëzishme shumë fisnike, do ta bëj unë për një dosmosdoshmëri të vërtetë, e, më lejoni që po jua them, edhe për njëfarë lakmie (ambicie); ju lutem, pra, të vazhdoni dashamirësinë tuaj edhe këtë vit, siç e keni bërë deri tani, pa e merituar unë një gjë të tillë.

Pranoni, së fundi, shprehjen e nderimit tim më të thellë.

Juaji
NDRE MJEDJA
Krakovi, 15 kallënduer 1893



Shumë i shkëlqyeshmi Zoti Profesor,

Pardje më kanë dhënë hua disa libra shqip, botuar në Bukuresht. Ca nga të cilët, ndoshta, u kanë rrëshqitur hulumtimeve tuaja, të tjerë janë shtypur tani vonë. Nxitohem pra, t’jua bëj të njohur zotërisë suaj. Librat janë këta që po rendis më poshtë:

Benusi Gaspër, Abetare e gjuhësisë shqipe, Bukuresht, 1890;

Qëndrimi i shoqërisë së Shqiptarëve “Drita”, po aty, 1892;

Sami H. Frashëri, Dheshkronjë, Bukuresht, 1886.

Naim H. Frashëri, Dituritë për mësonjëtorët të para, Bukuresht, 1888. (Nxjerrë nga e përkohshmja “Drita” e “Dituria”);

Naim H. Frashëri, Istori e përgjithëshme, Bukuresht, 1886. (Nxjerrë nga e përkohshmja “Drita” e “Dituria”).

Naim H. Frashëri, Luletë e verësë (vjersha), po aty, 1890.

Ier. Risto Lazi Tetova, Abetare shqipe, po aty, 1887.

Ier. Risto Lazi Tetova, Leçitja shqipe, po aty, 1887.

Jani Vreto, Numertareja, Bukuresht, 1886.

Rregulla e nisun e para-bërë mësonjëtorë në gjuhën shqipe n’Bukuresht dhe kanonet

saja (Rregulla mbi udhëzimin, organizimin dhe mbarëshkrimin e institutit të parë kultural shqiptaro-rumun në Bukuresht), 1892. (Është në gjuhën shqipe, rumune dhe frënge).

Numrave 4, 5 u kam shtuar unë shënimin, nxjerrë nga “Drita”, mbasi duke i krahasuar me të përkohshmen, më duket se janë të tilla. A e njihni një relacion, jo i bërë në Klubin alpin austro-gjerman (Bei den Albanesen)? Është botuar në Wurzburg. Woerl. Unë nuk e di ende përmbajtjen e tij. Dje u kam shkruar dhe e kam kërkuar. Një bashkëvëlla imi polak është duke mbaruar së shtypuri një vëllim të saktë për Shqipërinë. Merret për summa capita (krejtësisht), me historinë, veçanërisht me atë kishtarë të Shqipërisë, me zakonet dhe me mundin e misionarëve atje. Janë gjëra të njohura për ju, megjithatë do të kujdesem sa më parë t’ju dërgoj një kësobëll.

Nga Shkodra nuk kam marrë asgjë. E përkohshmja “Elçia” vazhdon të botohet, por ka disa muaj që nuk ma kanë dërguar.

Pranoni, zoti Profesor, shprehjen e nderimit tim më të lartë.

NDRE MJEDJA



Shumë i shkëlqyeshmi zoti Profesor,

Po ju dërgoj një kësobëll të një libri polak për Shqipërinë i cili tani sa doli në dritë dhe i lutem zotërisë suaj që ta pranoni si shenjë të nderimit dhe dashurisë që ushqej për ju. Po qe se nuk do t’ju hyjnë në punë ato që tregohen aty, mund t’ju jetë i dobishëm për ato pak ilustrime që gjenden në të; e do të vlejë nëse jo për tjetër, të paktën për të pasuruar bibliotekën tuaj shqiptare.

Unë gjithnjë vazhdoj ta shtoj, ndonëse me ngadalë koleksionin tim të vogël të librave. Deri tani i kam grumbulluar të gjitha gramatikat e shqipes, me përjashtim të asaj të De Radës dhe të Likut, por çmimi tepër i lartë më pengon.

Shpeshherë mendoj të ankohej për punët tuaja, që ju pengojnë të merreni me shqipen; por jo, nuk dua të jem egoist dhe të ngushtoj lavdinë tuaj vetëm në një lëndë të vetme.

Këto ditë po lexoja përsëri veprën tuaj “Studime shqiptare”, III dhe në lidhje me paragrafin 106 po shënoj se në Shqipërinë e Veriut (e jo vetëm në Shkodër), ll- ja qiellzore nuk njihet, por vetëm l-ja alveolare dhe ll-a grykore: ll-ja (qiellzore – J. K.) përdoret vetëm nga toskët. Kam kërkuar në bibliotekën e universitetit dhe gjetiu: “Bezzenberger Beiträge” etj., të këtij viti për ta parë etimologjinë e Bugges, por nuk gjendet. A është gjë me rëndësi? Ju lutem gjithashtu, të keni mirësinë të më tregoni nëse ka ndonjë studim të veçantë për ilirishten e lashtë, dhe nëse me të vërtetë zotëria juaj beson se trajta e moçme e shqipes mund të ketë qenë ilirishtja e lashtë, që me sa duket, drejt saj prirëni në artikullin tuaj “Shqiptarët”. Një studim i tillë do të ishte, sigurisht, shumë i dobishëm; dhe asnjë tjetër nuk është në gjendje ta bëjë më mirë se zotëria juaj.

Së fundi, ju kërkoj të falur që i kam mbajtur kaq gjatë “Rapsoditë” e Skiroit. Në qoftë se ju nuk keni ndonjë kundërshtim, do t’i mbaja edhe gjatë pushimeve të Pashkëve, e menjëherë pas tyre do t’jua dërgoja.

Pranoni zoti Profesor, shprehjen e nderimit tim më të thellë.

Shënim:

Në veprën tuaj “Studime shqiptare”, II, fq. 5, në mes fjalësh shqipe të Arnold von Harfit, është edhe: “mirë ndesh të rasha”. E njëjta fjalë gjendet edhe në gramatikën e Da Leces. (1716), faqe 225, II.

NDRE MJEDJA
Krakovi, 16 mars 1893



Vijon nga faqja 9

Letrat që Gustav Majer i dërgon Ndre Mjedës
Grac, 4 mars 1896
I nderuari zotëri,

Për letrën që mora sot nga ju, ju falënderoj përzemërsisht. Më gëzon fakti që përsëri po gjendet dikush që interesohet për shqipen, që deri tani është trajtuar si "djali i njerëzës". Dhe mua më ka ardhur shumë keq që në përmbledhjen e punës sime ne nuk kemi në dispozicion një material të sigurt për shkoderanishten dhe pothuajse asgjë për dialektet e malësisë. Meqenëse tani po merrem me një punë që s'ka të bëjë me shqipen, do të kem mundësi vetëm nga vera të merrem përsëri me të, prandaj në këtë çast nuk mund të tërheq vëmendjen tuaj për gjithë ato pika (çështje) për të cilat më vonë do të kem nevojën për këshillat dhe informimet tuaja. Unë mund të them vetëm këtë, që gjithçka që po mblidhni në shkoderanishte, veçanërisht në dialektin e dialekteve dhe të Mirditës, do të jetë me interes dhe me vlerë të madhe për shkencën, në qoftë se ju këto të dhëna do t'i jepni të qarta dhe sidomos shqiptimin e tyre. Për mua, që kam pyetur para disa vjetësh disa individë nga shqiptarët e Veriut, kanë mbetur shumë çështje të errëta. P. sh. Tingulli i gegërishtes së Veriut, që zëvendëson qiellëzoren toskane (që unë e shkruaj k), shqiptohet kudo njësoj? (p.sh. Te kaf-a (qafa), Kadiu. Apo ndryshe si serb. c apo si serb. Cech. C ose cz? Apo të dyja. Dhe në ç'rast njëra ose tjetra? Ky është një faktor me rëndësi për të përcaktuar kufirin e dialekteve. Leksikografët italianë dhe propaganda shkruajnë këtu ital. Cia etj., që po ashtu Mjedja në fjalën gia (si flitet kjo atje lart, në gjarpër si d' (=dj) ose direkt dz=it, gi – me vokalet të errëta? Ky është një problem, por nuk kam dyshim se do t'ju drejtohem me shumë pyetje të tilla, që janë me interes për mua. Vazhdoni të grumbulloni mblendhje leksikore, parazizma gramatikore, fraza për frazeologji dhe sintaksë dhe mbi të gjitha tekstet tuaja nga gojëdhënat, përrallat, humori, këngët. S'kemi asnjë njohuri për sa i përket pasurisë së fiseve malësore të këtyre vendeve; se atë çka njohim nga përrallat (dhe ato janë kudo një pasqyrë më besnike e gjuhës së gjallë të popullit se sa këngët që vlerësohen nga antikiteti për ritmin) janë të gjitha legjenda toske dhe nga Gregja: nga Hahn, Vithor, Dozon, Reinhold... Pedersen; edhe unë kam mblendhur atje disa përralla që nuk i kam botuar akoma. Prandaj mblidhni, se me siguri do të bëj vlerësimin nga shkenca. Ne njohim shkoderanishten vetëm nga disa shkrime të mërziqshme që nuk mund të pretendosh prej tyre për sa i përket tingullit, ai është një material në përgjithësi si të thuash në vija të trasha.

Në qoftë se ju doni t'i botoni vetë ato çka ju gjeni dhe mblidhni, unë jam gjithmonë gati t'ju ndihmoj me ato njohuritë e mia të dobëta në këtë gjuhë; dhe në rast se ju nuk keni ndër mend, kam dëshirë me rastin e parë në ndonjë punim shkencor akademik të njoftoj për mblendhjet tuaja dhe të bëj vlerësimin shkencor, sigurisht duke shfrytëzuar rrethanat që ju jeni mblendhësi dhe gjetësi i tyre.

Edhe një herë ju falënderoj për letrën tuaj dhe shpreh gëzimin tim për bashkëpunimin tuaj dhe përfundoj me sigurinë e respektit tim të madh.

Juaji
GUSTAV MAJER



Grac, 15 maj 1896
I nderuari zotëri,

Me dërgimin e fjalorit etimologjik me shtesat e shumta tuajat më befasuat dhe më gëzuat tepër. Tani munda vetëm ta shfletoj njëherë, por e pata të qartë që këtu është mblendhur një material i pasur në dialektin shkoderan nga ju dhe se shpesh keni vërtetuar dhe saktësuar të dhënat e mia. Po të keni mirësinë të më lejoni ta disponoj, me rastin e parë do ta shfrytëzoj. Meqenëse një botim i dytë i fjalorit tim nuk pritët tani shpejt, mendoj ta përdor këtë material (që gjithnjë e më tepër po shtohet) në disa punime shkencore akademike dhe vetëkuptohet për ato çka do të nxjerr nga punimet tuaja, do të përmend emrin tuaj. Çfarë mendimi keni

për fjalorin e vogël të Jungut që ma dërgoi mua? Kam përshtypjen se është më i sigurt sesa studimet më të vjetra të Rosit. Por vetëm ju mund të gjykoni nëse e jep dialektin shkoderan ekzakt.

Javët e ardhshme nuk mund të filloj punën me të dhe duhet t'ju lutem që të më lejoni ta mbaj fjalorin për një kohë më të gjatë, sepse jam aq i zënë me leximin e bocave të gramatikës sime greke (botimi i tretë), sa kam muaj të tërë që nuk mund të merrem me ndonjë punë tjetër. Por mendoj se libri duhet të jetë përfunduar në fund të janarit ose në fillim të korrikut, pastaj do të jem përsëri i lirë për gjëra të tjera dhe unë do të merrem përsëri me shqipen. Me një fjalë do ta mbaj librin aq kohë, derisa ju mund të shprehni dëshirën që t'ju rikthej. Edhe për mblendhjen e teksteve tuaja gëzohem shumë.

Për sa më shkruani ju në lidhje me shqiptimin e dyfishtë të dhënë nga unë k' dhe g' është me interes dhe me rëndësi. Kam besuar gjithmonë se përcaktimi i Miklesçit t' dhe d' i afrohet më tepër shqiptimit, por për arsye etimologjike jam mbajtur pas k' dhe g'. Edhe unë e kam menduar se shqiptimi i qartë i k=kj dhe g'=gj përdoret vetëm në ato fjalë ku shqiptohet kl, gl (gjë që ruhet ende në gjuhën greke) dhe vërejtjet tuaja ma vërtetojnë mjaft mirë. Në qoftë se mendoni se në format nd-kn-n, -d, ml, mm-, m- b dhe t mund të shihen kufijtë e dialekteve, s'do të jetë pa rëndësi, bile do të paraqiste një interes të veçantë çështja se sa shtrihen në jug nn, mm. Gjuha toske e shndërroi në mesjetë nd në nn; nëndialektet italiane vazhdojnë të bëjnë të njëjtën gjë sot dhe unë jam i bindur se ky është ndikimi i popujve japigë dhe mesapë që kanë gjetur toskët atje. Këta janë pa dyshim, një familje me ilirët, d.m.th. edhe me shqiptarët e sotëm dhe do të mundemi, nëpërmjet përkufizimit të çdo tingulli që hasim, të kemi një pikëmbështetje se nga ç'vend i Ilirisë kanë ardhur mesapët italianë.

Librin e Shnaiderit, që ju përmendni, s'e kam gjetur ende. A mund të më thoni titullin dhe vendin e botimit? A i keni katër fletoret e studimeve të mia albanologjike nga shkrimet akademike të Vjenës? Nga fletoret II, III dhe IV mund t'ju vë në dispozicion një ekzemplar; nga I kam vetëm dorëshkrimin tim. A i njihni tekstet albanologjike me gjithë glosarin, të mblendhura në fshatrat e Shqipërisë së Jugut e të botuara nga H. Pedersen, një danez i ri i talentuar? Në qoftë se jo, mund t'ju vë në dispozicion një të tillë, meqenëse kam dy.

Me falënderime të përzemërta dhe me shpresë se pas pushimeve tuaja të verës do të dëgjoj mbi rezultatet.

GUSTAV MAJER



Grac, 30 qershor 1896
I nderuari zotëri,

Letrës suaj të dashur do t'i isha përgjigjur më shpejt për të shprehur falënderimet e mia, por vazhdoj të rënkoj akoma nën peshën e korrekturave. Meqë librin e Shnaiderit, titullin e të cilit patët mirësinë të ma njoftoni, dhe sipas mendimit tuaj nuk ka vërejtje për të, nuk u nguta ta blej, do ta porosis te "Redaksia e raporteve vjetore për filologji romane (latine)" ku unë shkruaj raporte të shkurtra për fenomene shqiptare të reja.

Fatkeqësisht mund t'ju dërgoj vetëm fletoren IV të studimeve të mia shqiptare; besoja se do të kisha edhe disa kopje nga II dhe III, por gjatë kërkimeve të mia konstatova se veç dorëshkrimit tim, nuk kam gjë tjetër. Ju lutem ta pranoni fletoren si dedikim nga unë. Veç kësaj po ju dërgoj një libër të ri për shqipen, që ju lutem ta ruani. Është botuar në një përmbledhje manualesh shumë të nderuar, që janë përhapur shumë, siç do ta shikoni ju në shfletimin e tij, sepse leximi i tij nuk mund t'i kërkohet askujt. Zotëria njeh nga punimet e mia vetëm një artikull të vogël popullor nga "Nouvo Antologia", nga e cila ai ka kopjuar një pjesë të madhe. Shtypja e fletores V të studimeve të mia shqip, duke përmbajtur tekste nga gegërishtja me një glosar, ka filluar dhe nga kjo ju do të merrni një kopje sapo të jetë e shtypur.

Pedersenin do ta dërgoj më vonë; tani ia kam huajtur një dëgjuesit tim që interesohet për shqipen; ai do të ma kthejë atë mbas 14 ditësh, pasi të kthehet në atdheun e tij. Ky dijetar i ri dannez, të cilin unë personalisht nuk e njoh, ka mbetur i vetmi

njeri në Perëndim që merret seriozisht pas meje me shqipen dhe ka botuar në ato tekste edhe disa punime të vogla, por të mira, gramatikore për këtë problem. Këto punime janë të shpërndara në revista të ndryshme. Por edhe ai më ka shkruar kohët e fundit se nuk do të merret më shumë me shqipen dhe se do t'i drejtojë punimet e tij ndaj keltishtes. Është për t'u gëzuar dhe për t'u çmuar nga shkenca që njerëz të tillë si ju, të cilët kanë kushtet më të mira për një qëndrim më të gjatë në vend për koleksionimin dhe studimet e tyre, me gjithë punimet e profesionit të tyre, nuk ngurrojnë të punojnë për një njohje më të thellë të një gjuhe me të vërtetë shumë interesante në shumë drejtime.

Fjalorin e Jungut do të ma lini, po të jetë e mundur, gjatë dimrit në dispozicion, sepse tani që po merrem me punën e mërziqshme dhe po aq të lodhshme të korrekturave, nuk e mblend dot veten për punë tjetër.

Edhe një herë ju falënderoj.

Me respekt
GUSTAV MAJER



28 nëntor 1896
Shumë i nderuar zotëri,

Tani që më duhet t'i heq krejtësisht shpresat t'ju përshëndesja këtu në Grac, ku do të më jepej mundësia t'ju qaja "dhimbjet (hallet) e mia shqiptare" dhe duke e marrë me mend se ju ndodheni tani në Shkodër, lejohem t'ju drejtoj letrën atje. Unë po i vihëm punës të përgatis për në shtyp tekstet që ju patët mirësinë të m'i vini në dispozicion për shtyp e në një artikull akademik. Në fillim kam marrë proverbat parasysh dhe konstatova se shumë prej qindëseshes së dytë të proverbeve, ku nuk është vënë përkthimi, nuk i kuptova. Ju me siguri do të keni një kopje të tyre, kështu që mjafton t'ju njoftoj vetëm numrin përkatës të proverbit ku nuk kam kuptuar krejtësisht kuptimin ose kur ndonjë ose në ndonjë tjetër rast ka fjalë, që janë të errëta ose ndonjë e kam përkthyer, siç më duket mua mirë, por që në përkthimin tim nuk del kuptimi tamam.

Janë nr. 101, 107, 111, 113, 118, 124, 125, 126, 128, 130, 137, 139, 140, 142, 144, 145 (gisc-gist?), 149 (kuptimi?), 158 (po ashtu), 154, 155, 156 (streje), 158, 161, 163, 165, 166, 167, 168, 170, 172, 173 (nusa), 182, 184, 186 (kryet), 187, 190, 191, 192, 194.

Me këta numra do t'ju isha shumë mirënjohës, sikur ju në një kohë të lirë, të bënit një përkthim gjermanisht dhe te rastet më të vështira edhe një sugjerim të shpjegimit përkatës. Për mua do të ishte shumë më mirë sikur ju të përkthenit dhe ato të tjerat, por nuk guxoj t'ju zë kohën e lirë dhe t'ju vë në mundim; unë besoj që i kam përkthyer mirë dhe se e kam kapur thelbin, por do të isha i qetë sikur ato të kontrolloheshin nga ju që njihni shumë më mirë dialektin shkoderan.

Këngët, për aq sa u kam hedhur një sy, i kuptoj shumë më mirë, por edhe për këto në rastet e vështira do t'ju lutem për këshillën tuaj. Besoj se kësaj fletoreje nuk do t'i shtoj glosar, pasi kam parasysh gjithë shpjegimet plotësuese për fjalorin tim që keni shënuar ju në kopjen që ju kam dhënë dhe fjalët e reja që do të botohen tani në tekstet dhe se fundi, ato më të nevojshmet nga fjalorët më të rinj do t'i bashkërendis në një punë shkencore të dytë. Që të dyja punimet do të kenë një titull të përbashkët. Beitrage Zur Kenntnis zur nordalbanischen mundarten I. Tekst. II Fjalor. Natyrisht po të jeni dhe ju dakord. (Kumtesë për të njohur gjuhën e folur të Shqipërisë Veriore).

Siç e shihni, jam si të thuash, një bezdi për ju, por duke pasur konsideratë për ju, nuk dua të botoj me ndonjë gabim ose me ndonjë keqkuptim. Prandaj më lejoni t'ju bezdis disa herë.

Në qoftë se ju gjatë dimrit do të bëni edhe disa shënime të tjera nga shkoderanishtja dhe materiali nuk është dërguar akoma për në shtyp, mund t'i shtoj edhe ato; por besoj se me materialin që më keni dhënë ju, do të plotësoj një fletore.

Edhe një herë ju falënderoj me respekt të thellë.

Juaji
GUSTAV MAJER



Grac, 27 dhjetor 1896
Shumë i nderuari zotëri,

Letra ime e fundit dhe ajo juaja e parafundit u këmbyen gjithashtu. Më erdhi shumë keq që nuk patët mundësi të qëndronit në Grac dhe më vjen akoma më keq që po ju bezdis në një kohë kur ju pas pushimeve ishit shumë të zënë me punë zyrtare. Por sidoqoftë ju falënderoj përzemërsisht që më plotësuat kërkesën e cila më dha mundësi të përgatis për shtyp përmbledhjen me proverba që arrin numrin zyrtar 206. Nusa e lexova gabimisht për misa. Nuk diskutohet që dëshira juaj për të mos u përmendur emrat e plotë të luftëtarëve do të plotësohet.

Këtij materiali të mblendhur do t'i shtoj një hyrje për ato proverba shqiptare, që tashmë janë të njohura për mua si dhe për disa paralelizma nga gjuhët e tjera.

Pastaj do t'ju vijë radha këngëve, ku dua të shtoj diçka nga burime të tjera. Këtë fletore do ta mbyllë një glosar i fjalëve të reja ose me kuptimet e reja të fjalëve. Shpresoj se këtë material brenda një kohe jo shumë të gjatë, po gjatë dimrit, do t'ia dërgoj Akademisë.


Në qoftë se do të kem nevojë për sqarime për disa këngë dhe kjo mund të ndodhë, do t'i drejtohem përsëri mirësisë suaj.

Më lejoni t'ju dërgoj me rastin e Vitit të Ri urimet e mia më të përzemërta dhe të shoresoj se gjatë vitit 1897 mund t'ja arrij qëllimit t'ju njoh personalisht.

Ju shkruani herë puna, herë puna ka dhe kà (ai ka) dhe diçka të tillë të përafërt. A është këtu forma e gjatë (yeai-), e drejta? Unë mendoja se shenja -. (dhe ka ndryshuar shenjen tuaj të zgjatjes.

Me falënderimet e mia edhe një herë

Juaji
GUSTAV MAJER



Funksioni i motiveve të përrallave në veprat e Mitrush Kutelit

Nga Emine Borici

Mitrush Kuteli solli risi në kulturën e letërsisë shqiptare përmes rishfaqjes së kulturës popullore: përrallave. Përrallat janë gjetje kuteliane sikurse edhe rimarjet e motiveve biblike. Të shkruarit në gjenezë të motiveve janë një gjetje e spikatur e Kutelit jo thjesht të kontribuojë “në ringjallje të kulturës popullore” të asaj krijimtarie popullore prej së cilës ka fillesat, por vazhdon te ritet, te shoqëria shqiptare, ku përmes të jashtëzakonshmes “na ishte njëherë...” paralelizon dhe groteskon, periudhën e tranzicionit të shekullit XX.

Kuteli është ndër lapidarët e letërsisë shqipe për përdorimin e invarianteve të përrallave, ku ky lloj i prozës së letërsisë, bën të mundur sinkronizimin dhe ndërthuren e motivacione të trillimit ku imagjinata nuk njeh limite. Si e tillë, Kuteli ka pasuruar krijimtarinë e tij duke u mbështetur fort në këtë variant. Në këtë menyrë ai shijëson te lexuesi normalitetin e një rrëfjeje përralle “me autorë”.

Siç e thotë edhe prof. Blerina Suta “Pamje të modernitetit në letërsinë shqipe” “Rrëfimet Kuteliane shfrytëzojnë të gjitha mundësitë e ofruara nga një formë “orale” të shkruarit, për të shprehur simbolikisht hyrjen e shoqërisë dhe të njeriut shqiptar në një epokë të re”. Kështu, Kuteli na fut në botën e përrallave, “sfidon” tregimet të mbështetura në një ngjarje reale apo historike, e na çon te gjeneza, për një rifillim dhe mbi të gjitha për një rinisje për të rifituar dhe ripërtërirë fuqitë e moralit. Ai përmes imagjinatës, elementeve të trillimit, hiperbolës dhe strukturës narrative të përrallave na rinjeh me fuqinë e moralit të parë. Ato janë krijim popullor që në kohët më të lashta, pa u zbuluar gjuha e shkruar. Pikërisht Kuteli përmes rimarrjes së këtyre modeleve qoftë në strukturë narrative, qoftë në motive, na drejton te një synim i caktuar, tek natyra e ngjarjeve dhe trillimeve të hiperbolizuara, shpesh edhe të personifikuara përfundimi i të cilave janë gjithmonë pozitive, ku virtyti dhe e mira triumfon, sado e vështirë apo e pamundur të jetë situata apo

ngjarja. Këtë mënyrë shkrimi e ka “ritreguar” Kuteli përmes rrëfjave të tij ku ndryshe nga përralla që është e destinuar të ketë një fund të lumtur Kuteli qendron në konturet e një uniciteti vetjak ku protagonistët vdesin.

Konkretisht, te “Rinë Katerinëza” gjithçka duket si një përrallë e thjeshtë. Në fund të tregimit Kuteli shënon “Punuar pas një rrëfjeje të dëgjuar në vogëli në Pogradec”. Ky shënim është një orientim shumë i dobishëm për lexuesin. Së pari të orienton që është një rrëfje (fjalë që vjen nga fjala rrëfim, diçka e treguar, tregim, rrëfim në trajtën e një përralle.) vendi Pogradec të jep një sinjal vendi konvencionalisht, ku e dëgjua merr trajtën e një vendi të përfytyruar ku tregohet kjo përrallë, ku ka marrë jetë kjo përrallë, “ku ka ndodhur kjo përrallë”. Në disa rrëfjeja, jo veç vendi, por edhe koha konvencionalisht merr jetë përmes shënimit që vë në fund Kuteli “Punuar pas një përralle të dëgjuar në Pogradec më 1928 edhe 1943”.

Nëse mbështetemi te rrëfjet e Kutelit, narrativa e tyre me sy të lirë na jep pikërisht këtë ide: një përrallë, por nëse i analizojmë mund t'i quajmë “përrallë me autorë”. Këto rrëfime, sikurse edhe përralla fillon me fjalë fikse “Njëherë e njëherë, Na ish një vashëzë e mbetur e varfër-pa memë, pa tatë, “Na paska qenë njëherë një i pasur”, “Na ish njëherë një i mirë me mall e gjë shumë e na bënte dasmë e të birt”. sikurse përralla, edhe rrëfimet e Kute-

lit përfundojnë me dhënien e një morali, konkretisht: “Dalëngadalë filloi ta dashurojë përsëri këtë jetë kaq të hidhur e kaq të ëmbël! Dhe u martua përsëri e nisi radhë të re!” etj.

Kuteli na jep gjithashtu edhe koordinatat kohë e hapësirë të papërcaktuar. Koha mjegullohet, dhe përveç natës dhe ditës, si periudhë datore apo historike nuk figuron. Gjithashtu, Kuteli i thyen edhe kufijtë e hapësirës. Ai me detaje na rrëfen historinë e dashurisë së Rinë Katerinës me një të vdekur, sesi me një të vdekur ajo lindi një fëmijë dhe e gjithë skena përrallore tregohet me detaje sikur po ndodh me të vërtetë. Shpesh tregimet e tij pasurohen me vargje tipike si i ka bërë populli Kuteli e përsërit disa herë të njëjtën këngë apo fjalë të thënë:

“Mos qaj moj bijëzë,
Rinë-Katerinëzë,
Se të prishen syzetë,
Se të treten faqetë.”



EMINE BORIÇI

Megjithatë, përtej fantastikes, Kuteli dëshmon realitetin e mentalitetit shqiptar në atë kohë, është realist në mesazhe që do të trasmetojë, në atë qëllim pse e ka përdor invariantin e narracionit përrallesk. Ai vë përballë shqiptarit të kësaj kohe origjinën e tij, shtresëzimet palimpsestike të subkoshencës dhe të asaj që fle në nëndergjegje, për të cilën askush më nuk kujtohet. Mjeti më i mirë për Kutelin është pikërisht zgjimi i vetëdijes përmes përrallës.

Kuteli zbret në subkoshencën zanafillore për ta vënë përballë me realitetin e fillimshkullit të XX-të. “E madhe është gjemë e mëkatit” është vepra elaton i motivit biblik të Kutelit. Struktura e saj treshe si triniteri i krishterë, doktrina, motive, figura e mëkatarit dhe i pendimtarit i Tat Tanushit është ndër motivet më të forta dhe pikat më të rëndësishme ku vërtitet lajtmotivi biblikë dhe madje mund të themi edhe bindjet kuteliane. E themi këtë të fundit, sepse Tat Tanushi, shpreh jo vetëm bindje të Kutelit, por shpesh edhe sipas kritikienëve të letërsisë edhe Kutelin e mveshur në figurën e këtij personazhi jo si njeri, individ, por si ide, si pikëpamje, si autor real biografik të veprës dhe real që mendon, ideon dhe e ndjen atë. Ai u bë model i mëkatit të fyerjes hyjnore i imoralit dhe i paspranimit të kaderit, të fatit që shkruan Zoti. Mesazhi i marrjes së Kalijes nga Zoti ishte i qartë. Ai nuk mund të adhurojë edhe krijuesin edhe krijesën. Ai po shkelte tek e ndaluara tek “molla e Ademit”. Por, ai ndaj hyut me vdekjen e Kalijes mëkatet që e ndiqnin hap pas hapi vërtetonin motivin fetarë se njeriu është mëkatar, i cili vazhdimisht mishi dhe gjaku i tij tërhiqet ndaj mëkatit, sikurse shpirti i tij i lidhur sado pak me Zotin tërhiqet ndaj pendimit dhe hyjnore. Dënimi me përjetësi me mosvdekje është një sfidë dhe njëkohësisht një mesazh fetar. Njeriu nuk është i krijuar sipas fesë që të jetë i pavdekshëm, por dhënia e pavdeksisë Tat Tanushit është një farë përgjigje pse Zoti e mori Kalijen. Një mënyrë të thëni që vdekja është më shumë shpëtim sesa fatkeqësi dhe se fatkeqësia më e rëndë është të mos vdesësh. Tat Tanushi e kërkonte vdekjen dhe po mendohej të vdiste e kjo ishte torturë për të. Por thelbësore është se ai u bë më shumë sesa një personazh simbolikë me motivacione fetare, u bë një ide, një etalon kutelian. Në fund të veprës ai shkrihet në sy të gjithëve, shkrin të keqen, mëkatin dhe lehtësohet me pastërtinë e larjes së pendimit ndaj të keqes.

Kuteli është mjeshtër i motiveve popullore, marrjes së mesazheve popullore dhe fetare. Si i tillë ai është bërë referencë për mjaft hulumtues të kritikës dhe studiues të letërsisë, si ndër nismëtarët e letërsisë moderne, përmes simboleve dhe deri diku dritëhije të subkoshencës njerëzore të përthyer në tiparet qenësore të personazheve.



E s e

HISTORIA E VDEKJES

Nga Rexhep Ferri

1.

Jeta nuk qenka përrallë që na tregohet si përrallë.
Kudo që shkojmë, kudo që ndalemi – quhet vazhdim.
Qielli qiell.
Njeriu natyrë dhe vazhdim.
Me kohën dhe kundër kohës.
Për ta ditur ku jemi.
Çka të sakrifikoj më shumë?
Jeta na mungon kur jemi vetëm.
Asgjë më e pabesueshme.
Vonë, tepër vonë na duhet të ndalemi para pasqyrës ta humbim kotësinë.
Mos ta bëjmë edhe ndonjë gabim me dëshirë të pakuptueshme.
Kanë ardhur kohëra të këqija.
Më në fund edhe njeriu i tregoi dobësitë e veta.
Shpejt e tregoi veten për bashkëjetesë me djallin famëkeq, me pazarin diplomatik i bleu veshët e gomarit.
Unë me fantazinë time ku do të ndalem?
Ku do të shkoj?
Çka do të kërkoj?
Në çdo cep të botës mesazh i humbur.

2.

Tani po e kuptoj pse e urrej këtë mallkim.
Historia e vdekjes po afrohet.
Në anën tjetër kjo shëtitje shkon si mashtrim.
Në rrugën që nuk po dihet se kujt po i shërben u nisa të shoh si po jetohet.
Jeta nuk qenka vetëm ëndërr.
U përpoqa ta kuptoj.
Për njeriun a ka ende kohë dhe mundësi.
Në anën tjetër të historisë diçka tjetër rri e fshehur.
Nuk arrita as të mendoj pse?
Çka duhet të bëj?
Syri i majtë vetëm para pasqyrës e sheh syrin e djathtë.
Historia që ka histori edhe gjatë luftës ka qenë e veshur me natë.
Pritni ta mendoj?!
Jetën që është vetëm një ëndërr e mori era.
Autoriteti e pyeti frikën:
Çka të sakrifikoj më shumë?
A do të bëhet mirë, nuk është e besueshme.
Koha humbje e errët.
Shumë e errët...
Vetëm dreqi famëkeq për të është magji.
Të jesh vetvetja nuk është gjithmonë mundësi.
Mendoj se mundësia është kohë e dëshpëruar.
Për ta parë botën e vogël, lojën e personazheve me brirë, që çdo ditë e vazhdojnë lojën.
Si do ta humbim lojën, prapë nuk e di!
Më vjen keq që nuk jemi më vetvetja.
Lufta është e mbyllur.
E qartë: Si nata pa hënë.

Duhet të themi: Nuk e di se ku do të ndalemi.
Pa qiell dhe pa kuptim koha do të tregojë se çka do të ndodhë.

3.

Për peshun e fundit, në qiellin me ngjyra të kuqe, jeta vizatohet si shkretëtirë.
Ishte natë.
Ishte terr.
Duhet të mësohem me terrin.
Me tema tabu.
S'kam frikë nga frika.
A po na njohin?
S'po na njohin!
Mendjen po e ndryshojnë.
Ku të blejmë kripë e gaz.
O me ne o me djallin famëkeq.
U krijua historia dhe vdekja e historisë është sinjal për t'i hapur sytë.

4.

Na pëlqen shkretëtira.
Sidomos natën.
Me ndihmë për ta kuptuar kohën.
Flas nga mashtrimet që na ndodhin çdo ditë.
Jeta qenka me kthesa të forta.
Kohë e pazbuluar.
Arkeologji.
Aty ku flasin gurët e varreve truri nuk duhet të mendojë shumë.
Unë po ndalem.
Ende jam duke mësuar pse bëhet lufta.
Kush e fiton s'ka rëndësi.
Pse shqetësoheni?
Nga rreziku edhe fitorja është rrezik.
E kemi problem ta kuptojmë.
Humbim të pabindur pse e kërkojmë përsëritjen.
Pas humbjes ringjallja flet më mirë.
Të gjithë e dimë si fitohet lufta e humbur.
Për të fituar shpesh shkojmë edhe kundër dëshirës.
Çmenduria qenka besim.
Kënaqësi hyjnore.
Njëherë më ra rruga këndeje dhe andej.
Të pashë.
Nuk më shqetëson se çka flitet.
Djalli famëkeq mirë e ka...

5.

Për njeriun hero apo famëkeq.
Uaaa!... Uaaa!...
Besimi qenka iluzion, që shkon dhe vjen me respekt.
Si ta them?!
Si ta harroj?!

Me këto mend që i kam.
Në këtë jetë e lexova edhe njëherë vetveten.
Nuk më duhet të mendoj shumë.
Njohja e vetvetes është fat dhe art.
Popullit një hap i duhet për t'u bërë kope.
Si rrëfim, nuk e di se kush e tha:
- S'ke çka pret tjetër! Në gjak e kemi të keqen. Për ta kuptuar, fajtor është dikush tjetër...
Filozofia e njeriut shkon edhe më larg.
Vret edhe fiton.
Vdekja nuk i merr të gjitha mëkatet.
Lexohet për t'u bekuar.

6.

Kur e humbim një pjesë të trupit, koha e ndryshimeve hyn në biografi.
Pasi e hoqëm qafet besimin.
Jeta është edhe e kundërta e saj.
Pse jemi kaq të pabesueshëm dhe të pakuptueshëm nuk po shqetësohem.
Në kohën e maskave dhe heqjen e maskave gabova që zbrita nga Hëna.
Atje ende besohet!
Nuk është e qartë dhe nuk e di pse.
Ju falemnderit që nuk po më besoni.
Besimi është për ta ruajtur qetësinë.
Ky dialog me detin për herë të dytë e dogji bibliotekën e Aleksandrisë.

7.

Tani njeriu fillon të mendojë pse është mbreti mbret dhe fillon të eksperimentojë.
Banaliteti ekziston.
Për ta lënë këtë jetë, jeta është e dhimbshme.
Dua të më falni.
Kam qajtur.
Qajë kur nuk më shohin njerëzit.
Kujt t'ia shpreh ngushëllimin?
Edhe ngushëllimi mbetet histori.
Me të pathënat e "Darkës së fshehtë", njerëzit e dëshpëruar vdesin të dëshpëruar.
Me sëmudjen e pandemisë Covid-19 s'kemi pse e ruajmë distancën.
Gjurmët e atyre që nuk janë kurrkund.
Nuk janë as për maskë e as për distancë.
S'kemi kujt t'ia shesim distancën e as maskat.
Ato vijnë e shkojnë për paraqitje artificiale.
Këto shëtitje që po na ofrohen si mashtrim, shumëkush kot i ka pritur për t'u ndezur..., për ta sfiduar mënyrën e të menduarit.
Gjërat që kërkojmë nuk janë asgjë.
Jeta nuk është vetëm një ëndërr.
Për një parashikim mendja është botë.
Si është ky përjetim i shpërndarë?
Ku t'ia gjejmë kryqin e zi?
Klasa punëtore nuk ka nevojë të mendojë.
Pa duar e sy dikush del e flet në stilin e vet.

8.

Prapë po mësohem të eci.
Me ndihmën e zotit jam çuar në këmbë:
- Sot.
- Dje.
Nuk e di se kush jam.
Për jetë di diçka dhe pak.
Me vlera morale një vajzë që vizatonte yllin e natës; që e përmirësonte humbjen e ditës.
Për shumë kujtime.
Për jetën e çmendur më mirë se askush tjetër me rrupallën e postmodernizmit po e jetoj famën e rrejshme të kohës së rrejshme, të mashtrimeve të Qorrfermanit.

9.

Vdiq mbreti!...
Rroftë mbreti!...
Në kohën kur harrojmë ta njohim veten.
Kjo rrethanë nuk është vetëm problem i kohës së tashme.
Dramat dhe qind për qind tragjeditë i kemi të shumë historive e të shumë shekujve.
Në këtë tokë a ka ende njerëz që i donë njerëzit?!
Këtë pyetje tani po e kuptoj më mirë.
Nga tragjedia në tragjedi, qind për qind tragjedi...
Nuk jam i zoti ta kuptoj si e pse.
Prapë po mësohem të eci.

10.

Jetën duhet ta mendojmë brenda një harku të caktuar.
Me gishtin tregues.
Me një këngë në pyllin e vetmuar.
Katër stinët e jetës e kanë moshën e vet.
Jeta lufton me dëshpërimin.
Jetën, që është gjëja më e vërtetë, duhet ta mendojmë brenda një harku të caktuar.



PËRQAFIMI ERËRAVE

Tregim nga Enver Kushi

Pasi pashë edhe një herë me vëmendje biletën, u ula në karrigen, që lëshoi një kërkëllim të lehtë. Zotëria që kisha para, ktheu kokën dhe buzëqeshi me mirësjellje. M'u duk fytyrë e njohur. Ndoshta e kam parë në Bibliotekën Kombëtare ose në Parkun e Madh të Tiranës. *Ndoshta në Parkun e Madh*, mendova, në rrugën që futesh nga Filologjiku, ku pasi lë në krahun e djathtë godinën e bukur të Fakultetit të Gjeologji-Minierave, syri të shesh në çdo stinë gjelbërim të veçantë dhe të përhershëm. Andej kaloj shpesh, veçanërisht muzgjeve, kur bie shi i lehtë. Ndalem në mesin e asaj rruge dhe vështroj kurorat e gjata të qiparisëve dhe qiellin e pakët e të mugët, që lëshon pika të rralla shiu, në prill apo në vjeshtë të dytë. Rri gjatë ashtu, duke parë qiparisët, që kur nuk fryn erë duken si murgj të heshitur, zhytur në botën e tyre mistike...

Zotëria para meje ktheu prapë kokën dhe buzëqeshi me të njëjtën mirësjellje. *Fytyrë e njohur*, thashë me vete duke parë orën dhe ftesën, në të cilën poshtë emrit tim, ishte shkruar numri i radhës dhe i karriges. Isha ulur në vendin tim, pra në radhën tetë dhe karrigen tetë, ndërsa zotëria para meje në radhën shtatë, karrigen tetë. Karrigia në krahun e djathtë të tij, pra ajo me numrin nëntë, ishte bosh. Bosh ishte edhe ajo në të djathtë të krahut tim. Pasi u ngrita në këmbë për të hequr xhupin dhe i hodha një vështrim të shpejtë sallës, zotëria para meje, ktheu kokën dhe pyeti: "Të lutem, mund të më thuash sa është ora?" I thashë se donte tri minuta për të shkruar shtatë. "Faleminderit!", tha me të njëjtin zë të butë dhe me mirësjellje. Pastaj pashë që hoqi nga dora orën e tij, u ngrit në këmbë, e afroi pranë veshit dhe ndërsa ulej tha si nëpër dhembë fjalët: "Ora ime është vazhdimisht dy pa pesë... Dy pa pesë... Dy pa pesë..."

Shkrepa disa herë aparatit e vogël fotografik dhe kur u ula, zotëria m'u lut t'i thoj edhe një herë se sa ishte ora... "Ora ime ka kohë që ka mbetur", tha duke më kërkuar falje që po pyeste aq shpesh. Si ora e një të vdekuri...shtoi.

Nuk dëgjova se ç'tha më tej ai, sepse dritat e sallës u sfumuan ngadalë dhe spektatorët nisën të duartrokisnin. Shkrepa edhe një herë aparatit fotografik si të isha duke fiksuar duartrokjet dhe jo skenën. Dritat e sallës u rindëzën, nuk e di përse e ndërsa vazhdonin duartrokjet, pashë qartë pjesën e pasme tullace të zotërisë që kisha para. U ngrita menjëherë në këmbë dhe drejtova aparatit fotografik pranë pjesës së pasme të kokës tullace të zotërisë, që ishte ulur në radhën shtatë, karrigen tetë. Shkrepa menjëherë aparatit fotografik. E shkrepa sërish disa më pranë dhe më pas bëra edhe disa shkrepe të tjera, në distancë më të largët.

Tashmë kishte filluar shfaqja dhe pas meje dëgjova zërin nervoz të një zonje: "Boll zotëri! Boll me këto ulje-ngritje! Keni ardhur në Opera apo..."

U ula i lehtësuar, ndërkohë që duartrokjet ishin ndërpreur dhe spektatorët po ndiqnin operan. Zotëria para meje ishte mbështetur në karrige, ndërsa unë u afrova për të parë më mirë pjesën e pasme të kokës së tij tullace. U ngrita prapë në këmbë dhe e fotografova për të disatën herë atë. Dëgjova edhe një herë zërin nervoz të zonjës dhe sharjen e saj të rëndë.

- Më falni, zonjë! Më falni...! Po fotografoj.

- Nuk e kuptoj se përse ngriheni kaq shpesh në këmbë... Nuk e kuptoj... Injorant! - shfryu ajo, ndërsa zotëria para meje qetësisht ndiqte operan.

Vendosa syzet optike, të cilat i përdor shumë rrallë dhe u afrova më shumë për të parë pjesën e pasme të kokës tullace të zotërisë. *Si ka mundësi, si ka mundësi*, thashë me vete, kur dall-ova qartë disa vizatime të çuditshme atje, pra në pjesën e pasme të kokës tullace të zotërisë. Ca vija paralele... Ishin katër të tilla: dy të gjata dhe poshtë tyre, dy të tjera më të shkurtra. Në mes të tyre dalloheshin ca si germa të stampuara, ndërsa në vijën e fundit dhe poshtë saj, disa shenja të tjera, që m'u dukën si alfabet i vjetër, ndoshta i një gjuhe tashmë të zhdukur... *Do ta fotografoj edhe një herë. Le të më shajë zonja e ulur pas meje!* Salla ndiqte me vëmend-

je një kuartet dhe kur përfunduan, spektatorët u ngritën në këmbë duke i duartrokjur gjatë. U ngrita edhe unë. Afrova aparatit pranë tullës dhe shkrepa disa herë, i bindur se gjithçka e kisha fiksuar në celuloid. U ula i qetë, tashmë pa dëgjuar nga pas zërin nervoz të zonjës, e cila e përqendruar, ndiqte një pjesë nga kompozitori i madh, Griku. Kur orkestra përfundoi së ekzekutuari Griku, zonja pas meje u ngrit në këmbë duke thirrur me zë të lartë: "Bravo! Bravo!" U ngrita edhe unë dhe shkrepa sërish aparatit fotografik në drejtim të skenës dhe më pas, i bindur që zonja nuk do të më shante, fotografova shumë afër pjesën e pasme të kokës tullace të zotërisë. U ula i qetë dhe pashë orën. *Duhet të dal, mendova. Duhet të dilja patjetër dhe ta lija pa e parë koncertin me këngëtarë lirikë dhe pjesët nga kompozitorë të njohur botërorë... Le të më shante zonja e kolme ulur pas meje!* Ndoshta edhe zotëria para meje, kur të kthente kokën për të më pyetur se sa ishte ora, do të habitet nga mungesa apo largimi im i papritur, pa e përshëndetur.

Zbrita me nxitim shkallët e Teatrit të Operas dhe Baletit, dola para pesëmbëdhjetëkatëshit, në Rrugën e Dibrës dhe u gëzoja kur pashë që ishte hapur dyqani i vogël, ku do të stampoja fotografitë.

"Më duhen të stampuara sonte patjetër, nëse është e mundur", i thashë me një frymë zonjës, e cila më kërkoi filmin. I zgjata aparatit fotografik, ndërsa ajo më tha se pas njëzet minutash ose pak më shumë, fotot do t'i kisha gati.

Jashtë frynte erë e fortë. E papritur ajo erë, që vinte nga Dajti dhe rrëzonte gjethet e para të vjeshtës... *Do t'i telefonoj gjuhëtarit Thoma R.*, mendova duke parë orën. Ai duhet t'i shikonte fotot e stampuara dhe ndoshta zbrëthente enigmën e shenjave që ishin si të skalitura në pjesën e pasme të kokës tullace të zotërisë. Thoma R. është miku im dhe njohës i disa gjuhëve të vdekura dhe të gjalla. *Ndoshta është vonë, mendova, ndërsa pashë orën. Më mirë ta takoj nesër paradite gjuhëtarin e njohur. Më mirë nesër*, thashë me zë duke hyrë në dyqanin e vogël. Pasi falënderova zonjën, dola jashtë. Vazhdonte të frynte e njëjta erë e fortë. Këmbët më çuan në rrugicën që del tek ish-kinema "17 Nëntori", ku jo shumë larg saj, në një shtëpi të vjetër tiranase, banon gjuhëtarin Thoma R.

Pasi gjuhëtarin Thoma R., hyri në lokalin ku e prisja, i mbështjellë me një shall të gjatë, sapo u ul, më pyeti se ç'ishte ajo urgjencë në atë orë të natës. Ja, për këto, i thashë duke i vënë para fotografitë. Ai vuri syzet dhe i pa me vëmendje, pastaj më pyeti se ku e kisha gjetur atë pergamenë. I thashë se vërtet dukeshin si pergamenë, por ishin diçka tjetër. I tregova se në orën shtatë... Në sallën e Teatrit të Operas dhe Baletit...

Gjuhëtarin ndoqi me vëmendje rrefimin tim gati surreal (kësh-tu u shpreh ai), pastaj i mori sërish një nga një fotot, duke i parë tashmë me një lupë të vogël.

- Perëndi! - tha nëpër dhembë. - Vërtet këto që po shoh kanë qenë në pjesën e pasme të një koke njeriu? E pabesueshme! E pabesueshme! Një rast i rrallë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rrafsh europian, - tha gjuhëtarin Thoma R., duke hedhur në një letër A4 gjithçka që shihet në fotot që kisha bërë në sallën e Teatrit të Operas dhe Baletit. - Ç'është ky alfabet? Ja U-ja. E shih këtu U? Ka vite që më mundon origjina e saj.

Të them të drejtën ajo që më tregoi gjuhëtarin nuk më dukej si U, por ai ngulte këmbë që ishte U. Një U shumë, shumë e vjetër, e përdorur te fenikisht.

- Po kjo shenjë... Ç'është kjo shenjë?

Ai e riprodhoi mbi letrën e bardhë shenjën që pa në foto

- Varr? - e pyeta unë.

- Të lutem, mos bëj pyetje... Të lutem! - tha ai pasi hodhi në letër edhe disa shenja të tjera.

Njëra nga shenjat ngjasonte me një kokë zogu, një tjetër kishte formë vezake me një vijë të hollë poshtë saj...

- Më në fund! - tha ai i lehtësuar, duke parë edhe një herë shenjat apo gerrat e kopjuara nga fotot e mia. E la lupën mënjanë, hoqi syzet dhe më pyeti sërish për zotërinë, nëse e njihja nga afër

se nga ishte me origjinë dhe çfarë moshe kishte.

- Ndoshta ishte mbi gjashtëdhjetë vjeç, - i thashë. - E shihja për herë të parë... Ose ndoshta mund ta kem parë në Bibliotekën Kombëtare ose edhe në Parkun e Madh. Më bëri përshtypje që pyeste shpesh për orën... Dukej se ora i kishte mbetur. Mbjaj mend që e quajti si orë të vdekuri atë që mbante në dorë.

Gjuhëtarin vuri sërish syzet dhe me lupën në dorë, nisi të rishih-te ato që kishte hedhur në letrën A4. Kërkoi të pinte një kafe, të cilën kamarieri i përgjumur ia solli menjëherë dhe gjuhëtarin e piu pa sheqer. Ai ishte zhytur në një botë simbolesh dhe germash, zbrëthimi i të cilave dukej se po e mundonte.

- Kam harruar celularin në shtëpi, - tha befasi. - Mund të flas me një kolegun tim të vjetër?

Pasi përfundoi bisedën me kolegun e tij të vjetër, pa e patur mendjen, mori në dorë filxhanin bosh dhe e rrufti, sikur të ishte plot me lëngun e zi të kafesë.

- Tani afohu dhe dëgjomë me vëmendje, - nisi të fliste gjuhëtarin me një zë, sikur ishte i mbështjellë ose i qefinosur me pëlhurën e bardhë të shekujve.

Veprovë siç më tha ai dhe prisja jo pa ankth fjalët e tij.

- Ai quhet Enin. Ka lindur në vitin 938 para Krishtit dhe ka vdekur... Vdekur... Viti i vdekjes nuk është i qartë. E shih këtu shenjën e vogël, rrethuar me dy të tjera anash? Nuk i dalloj dot mirë.

- Si ka vdekur? E pashë me sytë e mi para tri orëve...

- Ka vdekur pranë një lumi të shenjtë me emrin... Dalloj edhe këtu vetëm disa germa fare të vogla. Ah, po! Lumi Akero. Më pas varri i tij është zhvendosur pranë një lumi tjetër, gjithashtu i shenjtë, Thiam. Ai rrjedh nga një familje e njohur princore. O Perëndi! Ja ku është simboli i Diellit... Këtu i Tokës. Kjo shenjë tregon se ai ka mbyllur sytë, pra, ka vdekur dhe varri i tij, bashkë me Tokën, vijën rrotull Diellit... *U' sitë mbilla!* Ja ku i ke këto fjalë... Ja...

Ato që po më thoshte gjuhëtarin i vjetër më dukeshin pjellë e fantazisë së tij ose si të shihet ëndrra në diell.

- Kjo shenja këtu tregon se populli i tij zhvendoset herë pas here. E shih këtu këtu? Është deti dhe anija, pra një nga zhvendosjet përtej detit. Po kjo?! Shihe me vëmendje këtë. Është zhvendosja nëpërmjet Tokës... Braktisja e saj dhe largimi me dhunë. Është një largim tragjik. Janë mijëra të shpërngulur... Ja viti... E dallon?

Unë pohoja me kokë, pa kuptuar shumë gjëra nga ato që gjuhëtarin Thoma R., i deshifronte dhe m'i thoshte me entuziazëm, si të kishte zbuluar një planet të ri.

Ai kërkoi prapë kafe, të cilën e piu pa sheqer. Dukej i përhumbur. Tërisisht i përhumbur. Vendoste dhe hiqte syzet. Pastaj mer-te në dorë lupën dhe shihte një nga një fotografitë.

- Diçka mungon... Duket që mungon. Ç'të them? Ndoshta nuk ke arritur ta fotografosh të plotë pjesën e pasme të kokës tullace të zotërisë, - tha me zërin që m'u duk sikur vinte përtej humnerave të kohës. - Janë ndoshta dy ose tri shenja apo simbole... Si ta shpjegoj? Ndoshta kanë të bëjnë me të ardhmen... Ndoshta mund të jenë fjalë profetike për të ardhmen e të zhvendosurve, - shtoi ai me të njëjtin zë. - Ja, shihe këtë shenjë këtu. Poshtë saj, kjo vijë dhe kjo germa ngjitur, ta shpjegoja më parë kuptimin e tyre. Pikërisht këtu mungojnë ato që të thashë më parë...

E falënderova gjuhëtarin Thoma R., dhe duke u ndarë, i premtova se do të bëja ç'ishte e mundur për ta gjetur zotërinë, megjithëse nuk kisha asnjë adresë të tij.

Ora kishte kaluar njëmbëdhjetë e natës, kur ngjita edhe një herë shkallët e Teatrit të Operas dhe Baletit. Përtej xhamave pashë kalendarin javor të shfaqjeve. Koncerti i asaj nate nuk peje më.

Sheshi "Skënderbej". Tutje fillimi i Rrugës së Kavajës. Rruga e Durrësit dhe ajo që të drejton për te Stacionin e Trenit. Ora po i afrohej mesnatës, pikërisht atëherë kur erërat e ditës së shkruar përqafohen me ato të ditës së nesërme... E ndjeva këtë përqaftim teksa dola në rrugën "Myslym Shyri" dhe në trotare binin gjethet e vjeshtës. Ndihej ai çast i papërsëritshëm, që e kisha përjetuar në një stan në fshatrat e Konispolit, gushtin e kaluar, kur njëri nga barinjte e vjetër, më kishte folur për përqaftimin e erërave në prag të mesit të natës... Edhe në Tiranë po përqafoheshin erërat, ndërsa unë ecja duke shpresuar se ndoshta në ato çaste, befasi do të më dilte para zotëria, ora e të cilit kishte mbetur dy pa pesë dhe që pjesa e pasme e kokës së tij tullace, fshihte një enigmë tjetër.

Erdhi e nesërmja me qiell gri dhe shi të qetë. Dola herët nga shtëpia dhe isha nga të parët që u ula në një tavolinë të sallës shkencore. Prita gjatë atje, por zotëria nuk erdhi... Më pas pyeta disa orëndreqës në rrugën "Hasan Tahsini" dhe në atë të Durrësit, nëse... Dhe kur ua përshkruaja portretin e tij, ata ngrinin supet duke më përcjellë me fjalët se nuk e njihnin personin në fjalë si klient të tyre, ndonëse unë ngulja këmbë se ai mbante orë të prishur, që i kishte mbetur dy pa pesë. Hipa në urbanin e linjës "Kombinat-Kinostudio" dhe të Unazës. Edhe në Laprakë, edhe në periferi të lagjes "Ali Demi", por e kotë... Padsite, në Sallën e Koncerteve të Operas dhe Baletit ishte premiera e Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore. Edhe andej dola i dëshpëruar dhe ndonëse në Tiranë shiu ishte bërë më i dendur, nuk lashë vend pa e kërkuar zotërinë. Në fund, këmbët më çuan në Rrugën e Elbasanit. Pashë orën kur hyra në rrugën e Parkut të Tiranës dhe ndjeva aromën e pyllit dhe shiun që binte i qetë mbi kurorat e pishave.

Ora po i afrohej mesnatës, kur ndalova në mes të rrugës me qiparisë në të dyja anët e saj. Vazhdonte i njëjti shi i qetë, ndërsa qiparisat dukej sikur prisnin erërat që të përqafoheshin, duke tundur majat e tyre. Ndoshta atëherë do të më shfaqej zotëria, të cilin nuk kisha lënë vend pa e kërkuar, që nga qendra e deri në lagjet dhe rrugicat e periferisë së Tiranës. Gjuhëtarin i njohur Thoma R., priste foton e fundit dhe të plotë të pjesës së pasme të kokës tullace të zotërisë, për të zbrëthyer apo shpjeguar enigmën e fundit, që fshihej te simbolet dhe shenjat e tjera. Kur erërat mbërritën dhe u përqaftuan dhe majat e qiparisave nisën të lëviznin sa para-mbrapa, unë pashë nga larg siluetën e një njeriu, që kapërceu rrugën dhe u zhdruk në pyll. Këmbët nuk më bënë të vrapoja pas asaj siluete. Edhe zëri sikur më kishte ikur... Qëndrova i ngrirë në mes të rrugës, duke dëgjuar erërat që përqafoheshin dhe një zë të largët: "*U' sitë mbilla... U' sitë mbilla... U' sitë mbilla...*"

Tiranë, java e parë e majit 2020. Viti i koronavirusit



RENATO MINORE

Poezi

Përktheu nga origjinali: Besnik Mustafaj

Sidomos poet, por edhe prozator dhe kritik letrar bashkëkohor italian. "O caro pensiero" (O mendim i dashur), nga është shkëputur kjo tufë me poezi, ka fituar çmimin "Viareggio", që është një nga çmimet më rëndësishme letrare në Itali. Librat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë.

S'ka shi që vlen
sa ai shi. Kujtimi nuk ka
më vlerën e atij kujtimi
Jemi mrekullisht të zbrazur
nga shiu dhe nga kujtimet
jeta është për të mbajtur mend
shiun dhe kujtimet
pa agullim
veç atij çehreprishurit të fëmijës
që kërkon ar mbi dhe.
Po kush e mendonte atë agullim
se do të mbyllej kështu
pa lavdi madje dhe pa atë
që s'i mohohet askujt
siç është mëkati i ëmbël
i rrugës së kazermave
dhe ne na mbetet vetëm
zhgualli i asaj që na shtret
si përvoja dhe e vërteta?

Mësuesja

Mësuesja De Stefanis
kalonte bash për nën
ballkonin tim
më fëmijët e kopshtit të saj.
Unë isha i përzëni nga festa
një prej të bijave pak e mangët në mendje

dikur i foli për mua
por ajo prapë vazhdoi me vite
me çetën e përparësebardhëve
ju morën pak këmbët ndoshta
mua kurrë nuk më përshëndeti
në fillim nuk dinte kush isha
më pas nuk donte t'më njihete.

Syri i qelqtë

Enriko më duket se kishte
një sy të bukur prej qelqi
që shndriste
gjithmonë tek na mbante në qark
dhe gjithmonë pa na parë
unë s'e mësova kurrë pyesja veten
dhe pse shumë pëshpëritej
në kishte qenë shënjestër
e një shigjete qorre
në sajimet teatrore
për të goditur mollën mbi kokë
apo një plumb kuturu
nga ata që në lagjen tonë
më thoshte nëna
vazhdonin të ishin makthi
i pareshtur
si atëherë kur im atë
mbeti pa nënë
dhe pa një fishkëllimë sirene
për ta paralajmëruar.



Vdekja e Askarit

Pastaj Enriko më tha
se Askari dha shpirt në Monza
rënë përmbys në kthesë
dhe gjithçka në televizion
krisma dhe flaka.

Por vërtet kishte ndodhur
kjo vdekje në direkt
për të cilën s'kish dijeni askush
apo ai vetë e kish marrë me mend
tmerrin e gjakut në sy
trupin që ftohet
mbi livadhin e gushtit
për të më treguar mua sërish
se dinte shumë më tepër
se unë dhe se kishte parë
atë që unë s'e kapja dot?

Shfaqja

E them ish aq e vështirë
përsëritja në tribunë
e këngëzës së falënderimit
"Ati ynë ne më të vegjlit
Jemi më pranë në zemrën tënde".
Më mungonte përqendrimi
më mbushte ankth dyshimi i tmerrshëm
se nuk isha aq i zoti
të ecja drejt deri në mes
me qirin imagjinarë në duar.
Më ngeci zëri. Dikush qeshi.
Eprori i lartë jezuit
më dhuroi buzëqeshje
ndoshta dhe më përkëdheli
por faljen e tij nuk e ndjeva.



Triptik atëror

1)

Mbaj mend breshërinë tënde
të rrokjeve
për të mbuluar fjalën
që po shpërbëhej
në tinguj të nakatosur
në emrin e përdhosur
si shkarravina
e zërit.

Mbaj mend që u tërbova
prej pështjellimit tënd
m'u duk se po rritesha
mbi ligështimin.

Është lodhje t'i them vetes se nuk je
me atë belbëzimin kërcitës
të fytit tënd
tek sajoni e s'mundesh
shufrën në galop
në galop.

2)

Kjo dihatja jote e mundimshme
mbi fletën e argjendit të liqenit dhe rrëkesë
që kullonte djersë prej vërteti
mrekulli e një teknologjie thelbësore
në allçinë e fletës së butë dhe mbi
kartonin e rrudhosur të kodrinës
me ëngjëj të herahershëm
shkëndi të stukuara në mushtin muzgor
të metamofrozës së tyre
ishite mrekulli në një heshtje
të shumë gjërave të prajshme.

3)

Ti je vetëm ky mendim që është dhe
vetëm shëmbëlltyrë e ëndrrës, sillej rrotull
një sheshi nën kullën e sahatit
dhe unë që s'i shihja mirë numrat
si miop do të shihja gjithnjë e më pak.

Në këtë hiç vazhdoi të na ishte.

Kur u çel kutia
pashë pluhur stofin me vija
që mbaje i bukur kur u betove
me dorë gjashtëdhjet vjet më vonë
për dashurinë që ish prapë përallore.

Ti je vetëm ai që arrij të mendoj
nëse ende besoj te pështjellimi
që më përfshin nuk e di
nëse gabimisht në nevojtojen
e shërbëtores me yllkat
dhe plot luzma të praruara të kotësisë
së kryengritjes që u fal.

ASKUSH NUK MUND TA NDREQË NJË ËNDËRR

Tregim nga Ervin Nezha

Një burrë i quajtur Aziz pa një ëndërr, sikur pas një zënke vrau gruan. Për ta fshehur krimin, e mbështolli kufomën me një kapotë meshini dhe, për të mos e pikasur fqinjët, priti mbrëmjen për ta varrosur. Pastaj e hodhi në bagazhin e makinës dhe e groposi në një pyll të vogël, disa kilometra larg shtëpisë. Ishte i bindur se askush nuk e kishte parë, kur u kthye në shtëpi.

Për të fshirë ndonjë gjurmë sado të vogël, hodhi rrobat në makinën larëse, ndërsa vetë shkoi të bëjë dush.

Teksa uji i ngrohtë i rrihte shpatullat, kishte ndjesinë e hidhët se diçka e kishte bërë keq, në veprimet e tij. U përpoq të kthjellohej, por ishte e pamundur. Ndjesia e ligë se diçka kishte bërë keq, nuk i shqitej nga mendja. Po qëndronte i shtrirë mbi shtrat, kur iu kujtua kapota e meshinit, me të cilën kishte mbledhur trupin e gruas. Në xhepin e saj të brendshëm kishte harruar pasaportën. Ishte i sigurt për këtë, mbasi aty e mbante gjithmonë. Nëse trupi i gruas zbulohet nga policia, atëherë kjo provë do ta rrëronte përfundimisht në hetuesi. Kështu që i hipi makinës dhe u nis për te vendi ku kishte groposur gruan. Me një lopatë të vogël e zbuloi trupin shpejt. Kishte të drejtë. Pasaportën e gjeti në xhep. I hodhi një vështrim kufomës para se ta mbulonte sërish dhe vuri re se, nga vendi ku e kishte goditur me një shufër hekuri, akoma rridhte gjak. Këtu burri u zgjua nga gjumi me frymëmarrje të rënduar. Pranë pa gruan që po flinte e patrazuar. Azizi ishte besëtytë. Në kokë filluan t'i vërtiten mendime të mbrapshta. Një pyetje iu ngul gozhdë: Nëse ëndrra paralajmëronte diçka, cila ishte arsyeja që mund ta çonte atë drejt këtij makabriteti?

Këtë pyetje e peshoi gjatë në mendje. U mundua ta shihte në shumë këndvështrime problemin. Dhe u bind se një gjë të tillë mund ta bënte vetëm nëse ato fjalë që qarkullonin prej muajsh, se ajo na paska lidhje me një tregtar lulesh të quajtur Ahmet, qenkëshin të vërteta. Tani historia e tyre po i kthjellohej në mendje si një film i parë në televizor. Mori kuptim prania e atyre buqetave me lule të freskëta që gjente në shtëpi sa herë kthehej nga puna, të cilat e shoqja nuk i kishte mohuar kurrë se i kishte blerë te dyqani i Ahmetit.

"Maskarenjtë, ma kanë hedhur bukur," pëshpëriti me zë të ulët dhe sytë i shkuan te shufra e hekurit, e cila shërbente për të ulur grilën e dritares.

U ngrit më këmbë dhe u nis drejt saj. U mendua një copë herë dhe e kuptoi që ishte i nervozuar. Pasojat e këtij veprimi mund të ishin fatale. Shto këtu, që edhe historia e gruas me tregtarin vetëm përflitej, por nuk qe provuar. Atëherë u vesh pa bërë zhurmë dhe për ta shmangur këtë vrasje të paralajmëruar, mendoi të largohej përgjithmonë nga shtëpia. Vendosi të nisej drejt një qyteti të largët. Kur kishte bërë disa kilometra pati ndjesinë e hidhët, se kishte harruar diçka. Hapi krahu, ndaloi makinën, mbështeti kokën mbi timon dhe zuri të mendohej. Iu kujtua pasaporta. U turbullua pak. E dinte se ajo ndodhej në xhepin e palltos së meshinit. Pa të nuk mund të vazhdonte udhën.

Mendoi të kthehej. Me siguri gruaja do ishte zgjuar tani, por kjo nuk përbënte problem, se ajo nuk dinte gjë as për ëndrrën e as për udhëtimin, kështu që tani me siguri mendonte se burri kishte shkuar në punë, si zakonisht.

Dita kishte zbardhur kur burri mbërriti. Ndaloj makinën para shtëpisë dhe ngjiti shkallët. Sapo hapi portën u ndesh me sytë e tromaksur të së shoqes, që nuk e priste ardhjen e beftë në shtëpi. Azizi deshi të fliste, por ndjeu një goditje të thatë pas koke, që e plandosi përtokë. Mbeti ashtu me vështrimin e fiksuar lart, me sy të pikëlluar, që dukej sikur kërkonin shkakun e kësaj poshtërsie, derisa pa fytyrën kërcënuese të tregtarit të luleve që shante ndyrë nëpër dhëmbë, me shufrën e grilës në dorë. Goditja kish qenë fatale.

Vështrimi iu errësua dhe nuk po lëvizte dot. Ndonëse trupi po i rrëshqiste në gjumin më të ëmbël, në kufirin e mbramë mes jetës e vdekjes, burri shpresoi të ishte sërish në ëndërr.

U përpoq të zgjohej, të ndreqte këtë ëndërr të llahtarshme, por nuk mundi dot. Po vdiste me ndjesinë e hidhur se kishte harruar diçka, por tanimë nuk kishte kohë të kthehej pas...



Jetoj në një dhomë kubike

Qazim Shehu

JETOJ NË NJË DHOMË KUBIKE...

...jetoj në një dhomë kubike
Si bilbili i Mjedës në një kafaz,
I ndiej nga larg rrymëzat nazike
Të buzëqeshjes tënde që më ngas.
Jetoj në një dhomë kubike
Ku qenësohet dhe hungërin një mendim për ty,
Dhe s' kam dëshirë ta zgjeroj këtë dhomë,
As t' i çaj muret ,as tavanin të shtyj,
Ajo më mjafton në kruspullimën time
Dhe më duket se aty hapësira më të gjera ndryj.
Në ardhhtë të më sjellë dikush ndonjë lajm
Ndonjë refleks të ikjes sate që u shua
Në hapësira të mëdha,
Këtë dhomë kam dëshirë ta ngushtoj se
Kaq sa është mua më shumë se ç' duhet
Më mba...
++++

ËNDËRR VICIOZE

Këtë qytet mund ta ëndërrosh vetëm kështu,
Ai me ngurtësimin e tij ka zhbërë çdo mundësi
Ndryshe për ta ëndërruar.
Pallatet si hunj dordolecësh
Dhe përrrenjtë e verdhë të rrugës,
Parqet e rralluara
Dhe sheshet e zvogëluara,
Dhe njerëzit, njolla surreale,
Na thonë se mundësi tjetër s' mund të ketë,
Ata që së pari e projektuan
Vafshin në dreq...

KËNGËT KRESHNIKE

Këngët e kreshnikëve u ndryne
Në kutiza celulari,
Lahuta kujt më në punë si hyn
Tha Martin Camaj i pari.
Të krijuara pas një beteje
Kur jehonin shpat më shpat
Dhe i freskonte një dragua reje
Orteqe të rrokullisura në monopat...
Vallë e dinin se jehona prej rrufeje
Do mbyllej në aparat?
Kur sa gjokse burrash shpërthyen
Sa zemra kur ngritën luftëtarin- ijk
Një kuti si nuk e thyen
Një gjëmim si nuk çuan
Në veshët kufje-pambuk...

Në zall të Kostenjës
Heshtja vjedh
Ndonjë hap të arratisur..

Lugina zhvirgërohet
Nga një rreze,
Mëngjesi shtron ngjyrat...

Emrin e gdhenda
Te një gur i zallit,
S' iu ngjita dot malit...

Retrospektivë poetike

Feride Pappleka

"Ne kemi lindur për artin, ne kemi lindur për kujtesën, ne kemi lindur për poezinë, kemi lindur ndoshta edhe për harresën".

J. L. Borges

JAM E TERA PRITJE

"Optimus Maximus"
(Epiteti i Jupiterit në Panteonin romak)

Jam e tëra pritje,
ndiej prarimin e një dielli mbi kokën time,
një diell që ka formën e pazhbëshme të një Zoti.
Shoh udhëtimet e gjata:
Në rrjedhat e lumenjve të zhdukur
për të cilët kemi nostalgji
si për dashuritë e humbura.
Mbi malet që i ka fundosur deti
me grahmat mitike nën ujë
mbështjellë me kurorat e argjendta të pemëve,
që na kujtojnë të vdekurit e pavdekshëm.
Në shtigjet e haruara,
të cilat ëndërrojnë ringjalljen që nga hartat e vjetra.
Nëpër kohëra të arta
të ndërprera prej katastrofash historike.

Në themelet e lirisë
për ta ribërë misionin e parë filozofik,
megjithë mjegullnajën e zymtë
që bie mbi dritën e mendimit.

HYJNESHAT

Ju çupëlina që ecni shpenguar,
Të patrazuara nga ligësitë e kësaj bote,
Jeni hyjnesha të vogla.
Sytë tuaj janë hëna të Jupiterit,
Gojët tuaja kanë formën
E trëndafil të Engjëll Sileziusit
Duart tuaja shndërrohen në dafinën ku fjeti
Nimfa e dashuruar prej Apollonit,
Këmbët tuaja si dy kambanëza
Mbushin me muzikë rrugët.
Por kjo botë mizore
Nuk do t'ia dijë se ju jeni të perëndishme.
Ajo s'mund t' i shohë kopshtet në flokët tuaj
As dymbëdhjetë bilbilat që e bëjnë aty folenë.
Ajo nuk e kupton se harmonia
Buron nga shpirti juaj
Ashtu si agimet, ndërrimi i stinëve, prarimi.
Te ju ngjizet dashuria dhe përjetësia
Qysh nga qyteti UR i Abrahamit
E gjer te qyteti Zeta
Që rri i zhytur në mjegullnajën kozmike.

"ALEA JACTA EST"

Caius Julius Caesar

Do të pi ujë në Lete*
Pastaj do të zgjedh të jem më e thjeshta
E më e panjohura e grave
Dhe do të nisem.
Kasandrën nuk do ta lë
Të më parashikojë fatin.
Detet do të shtrohen
Sirenat do të ngurosen
Magjistarja Circe do ta humbasë magjinë
Polifemin do ta zërë gjumi i vdekjes.
Më pret Itaka.

Nëntor 1989

*Lumë i harresës (mit.).

PARIS

Unë të kisha sjellë mundimshëm
Në ëndrrat e mia.
Në këtë qoshe të harruar të Ballkanit.
Ti ishe llahtarisht i bukur.
I tejdukshëm si kristal,
I hollë si një fije e re bari,
Të ndriste balli nga mendimet,
Në zemër të buronte mirësia e botës.
Herë-herë të merrja në duar si lodër
Dhe flisja me ty në gjuhën sanskrite,
Në Champs Elysées dëgjoja "Nocturnes"
Të Claude Debussy-së,
Jeanne d'Arc qëndronte ende mbi kalë
prapa portës Saint Honoré
me një pellg të kuq gjaku në supin e majtë.
Dhe Proust që nga "Père Lachaise" më thosh "Eja!"
Për t' i sjellë këtë ditë dhjetori
Një trëndafil të kuq mbi varr.
Tani jam këtu
Si Eva në Eden
Nga t'ia nis nuk e di.

Paris, dhjetor 1993

LUMI I HERAKLITIT

"Jeta rrjedh si uji" - Herakliti
"Edhe ne jemi fluid si uji" - Borges

Fushë e korrur,
fëmijë që luajnë
dhe bagëti që kullosin në kallamishtë
Gjithçka është larë me shkëlqimin
e diellit perëndues.
Shtëpitë duken si të përmytura
në dritë e ngrohtësi.
Ngjyra e dheut të kodrave
më kujton të kuqen e Onufrit.
Më tej malet e hirtë.
kthehen dalngadalë në argjend.
Këtë peizazh nuk do ta shoh më
Nesër diellin, kushedi, do ta kenë zënë retë.
Dhe shpirti im ...
Ah, shpirti im!

Ndoshta s'do ta ketë më këtë mrekullim.
Peshkopi, korrik 1994

BIE SHI

"Lërmëni të qaj në breg të detit"

Gongora

Bleva një dhuratë për tim bir
Një tren lodër,
Që i ngjan trenit që s'ia bleva dot dikur,
Një tren që erdh e u bë një mal me trishtim.
Ku është fëmijëria e tim biri?

Pekin, 6 shtator 1995

TI ISHE QIELLOR

Ti ishe qiellor,
M'u desh të bëhesha me flatra për të të mbërritur,
Koha pas meje rrëshqiste si trëndafil i rërës,
Ditët e mia i ngjanin Spirales me ëndrra
Që e turbulluan Gëten.
Duke ardhur drejt teje
Sy burrash të tjerë më kanë vështruar,
Sepse çdo grua është një Tokë e Premtuar,
Por mua të tërë më dukeshin Zota pa qiell.

10 janar 1995

20 VJEÇ

Orionit, tim biri

Kur je 20 vjeç,
Të gjitha rrugët
Duken të drejta e të arritshme.
Qielli është përherë i yjezuar.
Lulet nuk i bjerrin asnjëherë petalet
Me një balonë të blertë ngjason dielli
Apo mbase me një portokall të kuq
Dashuria vjen si zog që këndon
Gjumi hyn pa trokitur
Të gjitha fytyrat hijeshohen
Lojë fjalësh është trishtimi
E përkohshme transformohet në të përjetshme.
Dhimbja është një planet i panjohur
Një portë e hapur mirësie bëhet zemra
Dhe shpirti një ëndërr e bardhë
Realiteti mbetet gjithnjë një ide poetike.
Bota është shtëpia e të gjithëve
Kur je 20 vjeç ...

15 janar 1995

FAQE AUTOBIOGRAFIKE

Kush jam unë?!

Jam koha ime
E copëtuar në vite, muaj dhe javë,
Në ditë dhe net
Dhe në çaste tragjike
Si ai i orës 12. 25, më 22 Janar 1996
Kur vdiq im atë.
Jam syri i tij lutës
Atë të hënë të zymtë
Për të cilën thonë se ndrinte nga dielli,
Por nuk dua ta besoj.
Jam regëtima e tij e mbrame
Jam apokalipsi i tij.

Sot s'jam gjë tjetër.

Qielli nuk është vetëm për zogjtë

Alfred Çapaliku

NJERIU NGUJUAR ME STINËN

Njeriu ngujuar me stinën,
Nuk pa lulëzim të pranverës,
Veç zogjve u ndoq cicërimën,
Flatrimin si valle mes erës.

Në trumba përshkonin një linjë,
Nga reja te pema e gjelbër,
Rebelë shijonin lirinë,
Pa njohur distancën dy metër.

Njeriu ngujuar me stinën,
Përveç fletëdaljes e shtune,
Ushqeu zogj bore në dimër,
Nuk mbajti kurr herbariume.

QIELLI NUK ËSHTË VETËM PËR ZOGJTË

Në zig – zagun e jetë shpik aventura,
Po t'u shterën shanset, numëroji shpresat,
Po t'u thanë lulet, kujtoju aromat.

Etje po të kesh, pi në digat e reve,
Ankthe po të ndjesh, vallzo tej horizontit,
Po të erdh uria, shuaje me verë.

Po të lodhi ecja, vrapo si atlet,
Treni po t'u ndal, kape shpejt avionin,
Se qielli nuk është vetëm për zogjtë.

HARMONI

Një gocë baletin nis pas së ëmës,
Nëna me rrezet e dorës e mban,
Të dyja formojnë botën e femrës,
Ku paraleli takon meridian.

Vërtitet vajzuka reth zonjës chic,
Vetëm kështu në një kohë arrijnë,
Gruaja ruan portretin filmik
Dhe vashkë me bijën fiton harmoninë.

Lulet pranverës shpërthejnë më parë,
Në degët ku rrinë zogj këngëtarë.

NE TË DY SOLO DHE UOLLT UTMANI

Gjashtë orë më herët sipas rrjedhjes pa cak të kohës
Ti rrotullohesh në gjumë djathtas larg në Cleveland,
Si për t'iu afruar pak Shkodrës, çupa ime yll,
Ndërsa unë shtang studentët me vargjet e Uitmanit,
Të lira, kilometrike, dallgëzuese të shpirtit,
Me figura kozmike si kometa me bisht ndriçues.

Gjashtë orë më vonë sipas klepsidrës dhe kuarcit
Rrotullohem në këmbë majtas larg në auditor,
Si për t'iu afruar pak Amerikës, ku ti fle,
Ne s'u bëmë asnjëherë njerëz me hap metalik,
Lumturisht të njëjtën ëndërr kemi ngjyrëoqean,
Në saje të "Fijeve të barit" përherë të blerta.

Biletat e linjave ajrore ngjasojnë me ftesa
Feste për fluturimet nën diell, nën hënë të zemrave,
Nën retë e bardha si bekim për ty shfaqet Atdheu,
Ti tregon si stoli pasaportën me stemë shqiptare,
Nën qiejt blu si mirazh për mua del Bota e Lirë,
Unë dëshmoj si bagazh librin që s'mbyllet të Uolltit.

Tepria që mungon

Alban Tufa

QYTETI I KRYQËZUAR NË "T"

Krejt jashtë më nxjerr ky qytet,
si gruaja burrin që s'e do.
As unë s'bëj dot ta dua,
veç ta kundroj i përjashtuar
si një vajzë që vështirë ta njohësh
por të cilës i kushton poezi lirike
subjektivisht korrekte.
Ta dua dot nuk mundem
se referencat i kam të dobëta,
lidhjet janë tëhollur:
zhurma,
makina,
kafene,
urbanë,
dhe shtëpi të marra (sa më lirë) me qera,
tek i kujton lagjeve kur shkel rastësisht:
"këtë pallat e njoh"
"aty kam jetuar dy vjet"
"këtu kam kaluar aq kohë"
gjendje që më dëftojnë sa i panjohur jam.
Shtëpitë të cilat i morëm me qera,
duke lënë to, veç lekëve dhe veten.
Aty lamë çdo përpjekje për të ndërtuar shtëpinë tonë,
që kurrë se patëm.

Kur e mendoj kam më shumë njohuri për botën
se sa për këtë qytet të murrmë
ku mbijnë çdo çast pallate
distancash
buzë më buzë me fqinjët.
Njerëz që s'duan ta dinë për njeri,
të cilët i përafrojnë veç Ezani,
a Kamban,
me tingujt që treten pallateve
duke dorëzuar monopolin e qiellgërvishtjes.

E diela,
dita e krahasimit të vetes me veten që do.
Dita kur kupton sa i përjashtuar je nga qyteti,
larg të shkuarës, larg të tashmes, larg vedit,
duke u shembur, sa zë e rritet, njëfarë [identiteti]
i mbërthyer keqas në kllapa.

Përfundshkurt 2021

NE I VRASIM ATA QË DUAM

Ne i vrasim njerëzit që duam
duke i dashtun shumë,
i vrasim duke i lënë të presin,
i vrasim duke i dashur më pak,
i vrasim
sidoqoftë.

Ne i vrasim njerëzit duke iu dhënë vëmendje
duke iu premtuar fjalë, duke iu dhuruar sende.
I vrasim duke iu marrë kohën.
Po, po i vrasim,
çdo ditë nga pak.
I vrasim duke lënduar veten,
duke dashtun jetën,
duke puthur vdekjen.

Jo se duam,
por kështu u lidhën menteshat e kësaj bote.

TEPRIA QË MUNGON

Jam tash ndryshore e veteve që humba
kujtimeve që ngucin ngulmët si thumba

dhe pulsi i dhimbjes që veç më dëfton
timpanin e shpirtit tek rëndë sëmbon.

Jam shumë larg asaj vetes që deshta:
shumë te pranvera, pjestim jam te vjeshta,

zhbërje te vera, minus jam në dimër,
lypës i vetes, më dhashtë Zoti ymër,

i rënë jam në çark, dorëzuar jam te kushtet,
derdhja e kupës që kurrë s'po mbushet.

Jam, pra, tepria, që rëndomë na mungon,
zbrazëtia pingule që përmbush çdo hon,

harresa e vetes që gjendet pasazheve,
dyst i ndalesave, peng i mirazheve.

Jam çfarë nuk deshta, jam çfarë s'arrita
të bëhesha për ty, uji, fryma, drita.

Jam tash ndryshore e veteve që humba
kujtimeve që palosa ngulmët si trumba.

Jam vetja që vetes s'i dhimbsem aspak
për ty dhe për botën tretim nga pak.

Veç doja të thosha, ky jam pak a shumë:
ajër në tokë dhe fluskë në shkumë.

Tiranë, Nëntor 2020

ËNDRRAT TONA

Ëndrrat tona janë të veçanta,
të prekshme
janë tokësore,
ato nuk flasin për flladin
për ujin,
për gjethet,
për mrekullitë,
as për udhëtime në vende të largëta: Roma, Athina, o Stambolli.
Ëndrrat tona janë nëse mund të shprehem këshu, shumë
praktike,
ëndrra me këmbë në tokë.

Ëndrrat tona janë më shumë dëshira.
Dëshira pa ëndrra në fakt,
të gjitha të bëshme,
të gjitha të pa bëshme.
Nuk flasin për hënën,
as për qiellin,
aq më pak për udhëtime në vende relativisht të largëta: Tahiti,
Xhamajka a Majorjka.
Dëshirat tona janë të gjitha të zvogëlueshme.

Dëshirat tona janë nevoja, po ta mendosh,
të cilat nuk flasin për yjet,
e aq më pak për hënën.
Nevoja tona dikur dëshira janë të prekshme:
një punë,
ca lekë,
një shtëpi,
një makinë.
Nevojat tona janë të gjitha të ngjeshme.

Nevojat tona janë të domosdoshme:
një punë për bukë dhe ujë,
bukë dhe ujë për punë,
bukë dhe ujë - shkak e pasojë,
pra ëndrrat tona i përmbledh një gojë.

Ëndrra: punë
dëshira: punë
nevoja: punë
domosdoja: punë
e gjitha lipsur me përdhunë.

Tiranë, Nëntor 2020,

RRASA E TULTË

Ti do, e mendjen ta gërric një duhmë e athtë ambicieje-
tejpërtej tash iu shkon rrathëve metafizik të çështjeve.

Të duket e ëmbël rrasa e tultë, gatuar kutrum prej rasteve,
e tultë apat të gjet, e rrafshët sa s'ka, pamja në ngasjet e çasteve.

E ëmbël është nisja- mбетet veç aq: pikë e lënë pas shpine.
Tash kujt po i mbrumet Pritja e Fundme tutje tokës së përhimë?!

Për besë (!) ia beh papritun fundi, s'ka më ngasje të athtë
ambicieje,
tejpërtej iu shkon rrathëve fizik, të vdekjeve, të ngjizjeve.

Peshkopi, Korrik 2018

Bernard Quaritch Ltd Dyqani shekullor i antikuarëve:

Kemi pasur edhe vepra për Skënderbeun

Bisedoi Andreas Dushi



DONOVAN REES
Drejtori aktual i Bernard Quaritch Ltd

Bernard Quaritch Ltd është një kompani në Londër e cila, qysh prej vitit 1847 blen dhe shet libra të rrallë, dorëshkrime apo të tjera materiale të shkruara apo të shtypura, që i përkasin shekujve të shkuar. Biseda në vijim, realizuar me drejtorin aktual të Bernard Quaritch Ltd, z. Donovan Rees, nuk synon vetëm t'i paraqesë lexuesit diçka e cila nuk ekziston në Shqipëri, por edhe të tregojë se kushdo merret me librin është njëfarëloj misionari.

Ideja se librari është veç një shitës, bibliotekari veç një nëpunës, botuesi veç një biznesmen etj., duhet të ndryshojë. Faji për këtë perceptim nuk është i publikut në më të shumtën e rasteve, por i vetë njeriut që merret me librin. Ajo çka qysh shekullin e shkuar u tha nga filozofët e Shkollës së Frankfurtit se kultura po kthehet në argëtim i cili në të njëjtën kohë duhet edhe të prodhojë të ardhura, çdo ditë e më tepër konkretizohet në realitetin tonë. Vitrinat e dyqaneve mbushur me tituj që përçojnë drithërima dhimbjesh e tragjesh; bibliotekarë që i punojnë dhe sugjerojnë tituj të tillë; botues që i botojnë këto tituj dhe i promovojnë me madhësi, bazuar veç në ndikim tregtar që ata kanë: *më i shituri!*

Prandaj, kjo bisedë është e para e një cikli të çrregullt bisedash me të kushtuarit në tempullin e librit, jashtë atdheut tonë gjeografik, si trokitës në portën e ngushtë të derës së mësonjëtores që gjendet në atdheun tonë mendor.

A. D: Themeluesi juaj, Bernard Quaritch, ishte një nga bibliofilët më të njohur dhe njëherazi, edhe një koleksionues librash duke krijuar kështu një kompani për shitjen e librave të rrallë. Si vazhdoi misioni i tij pas vdekjes?

D. R: Pas vdekjes së Bernard Quaritch, në 1899, kompania u mbajt nga familja e tij për një 72 vjeçar tjetër, para se të shitej përfundimisht, por që në vitin 1971 ka vetëm dy pronarë - kushdo qëndron me Quaritch për një kohë tepër të gjatë! Ne i qëndrojmë besnikë shpirtit të kompanisë, ashtu sikurse u krijua nga Quaritch, me ndershmëri, saktësi dhe cilësi, gjëra të cilat janë thelbësore për atë që bëjmë, po ashtu edhe në një perspektivë ndërkombëtare. Për më tepër informacion rreth historisë sonë, mund të kërkonit në website-n e kompanisë.

A. D: Sa libra të rrallë zotëroni? Në çfarë gjuhe janë pjesa më e madhe e tyre?

D. R: Është e vështirë të jap një numër të saktë të librave që kemi, për shkak të materialit të parregjistruar të koleksionit, por mund të kemi rreth 8000 - 10000 libra stok. Nganjëherë, ndonjë librari e madhe vjen dhe e shton numrin në mënyrë të konsiderueshme. Librat i kemi në aq shumë gjuhë për të cilat ka edhe

treg të mirë, por gjuhët më të zakonshme janë Anglisht, Latinisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht dhe Rusisht; përveç tyre, ne mbajmë gjithashtu edhe materiale në gjuhën Kineze, Arabe, Gjermane etj..

A. D: Në çfarë mënyre i keni siguruar ato libra? Janë njerëzit ato të cilët jua japin, apo i gjurmoni në "mënyrat tuaja misterioze"?

D. R: Ne i sigurojmë materialet në dy mënyra: publikisht dhe privatisht, d.m.th. nga ankande dhe agjentë shitjesh, po ashtu nga individë privatë që zotërojnë materiale për të shitur. Shpesh, koleksionistët të cilët janë drejtuar tek ne për të krijuar libraritë e tyre gjatë shumë viteve, në fund janë rikthyer për ndihmë, që t'i shesin librat e tyre. Nëse një klient kërkon një libër të caktuar, ne mund ta ndihmojmë duke e lidhur me dikë për të cilin e dimë se ka kopje që duan t'i shesin.

A. D: A keni ndonjë libër Shqip ose libra për Shqipërinë apo Ballkanin?

D. R: Fatkeqësisht, nuk kemi shumë materiale nga Shqipëria ose Ballkani sepse klientët tanë nuk i kanë kërkuar, por për shembull, kemi një dorëshkrim të një fjalori Arabisht - Turqisht, të shkruar në

Margus (Požarevac në Serbinë e ditëve të sotme), një bibliografi librash të shekullit të nëntëmbëdhjetë në Dalmaci dhe Kroaci dhe një vepër të hershme të shtypur në Dubrovnik. Më herët kemi pasur një numër të konsiderueshëm librash udhëtimi për Adriatikon Lindor, dhe vepra për Skënderbeun.


A. D: Gjatë karantinës së Covid-19, si ia keni arritur të "mbijetoni"? Dhe gjithashtu, në vijim të kësaj pyetjeje, a ofroni blerje online dhe transport në mbarë botën?

D. R: Po, kemi vazhduar të operojmë edhe gjatë pandemisë, ndonëse për fat të keq dyqani ynë fizik aktualisht është i mbyllur për vizitorët; në një situatë normale, do të merrnim rregullisht pjesë në panairë librash ndërkombëtarë, por për fat të keq, gjithçka është bërë online për këtë vit. Në website, sikurse është edhe ABE, listojmë shumë produkte që janë stok (edhe pse jo të gjitha) dhe shpërndajmë rregullisht katalogje nëpërmjet e-mail, të cilët gjithsesi mund të shkarkohen nga website ynë.

Gjithashtu, ne publikojmë një gazetë të shkurtër me 20 - 25 risi në të gjitha fushat - ju [për ta marrë] mund të rregjistroheni në website-n tonë.

Sigurisht ne kryejmë dërgesa në të gjithë botën dhe pranojmë pagesa në GBP, USD dhe EUR, ndonëse në disa shtete mund të ketë detyrime doganore.

Përktheu nga anglishtja: Marinela Mundija



(G. G. MARQUEZ: *Dashuria në kohërat e kolerës*, Onufri, Tiranë, Përktheu Mira Meksi)

ZHVIRGJËRIMI I BESNIKËRISË

Nga Gentiana Softolli

1. Autori

Gabriel García Márquez (1927-2014) shkrimtar kolumbian, vitet e para të jetës së tij i kaloi në gjendje jo të mirë financiare, duke qenë shumë i lidhur me gjyshërit e tij, vdekja e tyre ndikoi rëndë në gjendjen e tij shpirtërore. Në moshën 20 - vjeçare filloi studimet për drejtësi në "Bogotá", por që nuk i përfundoi, sepse ishte i mahnitur nga letërsia dhe, kështu, braktisi studimet për t'u marrë me letërsi. Kur kishte shkruar romanin "Gjethurinat" nga përgjigja që kishte marrë ndër të tjera shkruhej *mund të merreni me çdo gjë përveç se me letërsi*. Gjatë jetës së tij bëri punë të ndryshme si: gazetar, redaktor e reporter në gazeta të ndryshme. U martua me Mercedes Barca, me të cilën pati dy fëmijë. Çmimin e parë e fitoi në një konkurs në vitin 1955 me tregimin "Dita pas së shtunës". Më 1967 realizoi kryeveprën e krijimtarisë së tij "Njëqind vjet vetmi", ndërsa më 1982 u vlerësua me çmimin Nobel për Letërsi. Është njëri ndër shkrimtarët më të përkthyer dhe njihet si rrëfimtari i vetmisë. Márquez shkroi edhe shumë vepra të cilat padyshim që përbëjnë një pjesë mjaft të rëndësishme të Letërsisë Botërore si: "Dashuria në kohërat e kolerës", "Vjeshta e patriarkut", "Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar", "Të jetosh për të treguar", "Kujtim kurvash të trishtat" etj.

2. Romani

Dashuria në kohërat e kolerës është njëra nga kryeveprat e Márquezit, ku trajtohet dashuria e pashpërblyer me pritje prej gjysmëshekulli. Duke mos u mjaftuar me kaq, autori na rrëfen edhe një mori peripecish me të cilat do të ndeshen kryepersonazhet brenda këtij romani. Me kryqëzimet e fateve të protagonistëve, dramacitetin dhe tensionin, autori arrin që ta shpie lexuesin brenda skenës ku po zhvillohet ngjarja, duke e bërë atë një lloj protagonist të heshtur, i cili e përcjell me kureshtje çdo hap të lojës, ndonëse ai vetë nuk është lojtar dhe me padurim e pret hapin e radhës. Rrëfimi fillon me shprehjen "Ishte e pashmangshme", edhe pse në fillim nuk është se na duket të ketë qenë e pashmangshme, mirëpo gjatë rrjedhës së ngjarjeve fillon të bëhet e pashmangshme shkëputja me romanin pa i dalë në fund leximit të tij.

3. Dashuri platonike


Narratori brenda këtij romani është i gjithëdijshëm, i cili me përshkrimin e detajuar na rrëfen për dashurinë platonike të Fermina Dzas dhe Florentino Arzias, martesën me Juvenal Urbinon,

doktorin më në zë të qytetit, aventurat e Florentinos me femra të ndryshme, pasurinë e paligjshme dhe kumarin e Lorenzo Dzas (babai i Ferminas) dhe shumë storje të ndryshme për personazhe dytësore të cilat na paraqiten si të ndërfutura në roman, mirëpo që plotësojnë dhe i japin ngjyrim artistik rrëfimit.

Në kuadër të këtij rrëfimi arrijmë të vërejmë se si autori edhe lexuesin në periudha kohore, duke dhënë detaje nga më të ndryshmet për personazhe dhe duke e plotësuar gjithnjë e më shumë mozaikun e ngjarjeve. Së këndejmi kuptojmë që, sa i përket strukturës rrëfimtare, ky roman është introspektiv dhe retrospektiv në të njëjtën kohë, duke hetuar kështu edhe përdorimet e analeksës dhe proleksës përkrah njëra-tjetrës.

4. Tradhti dhe besnikëri

Kodi tematik i këtij romani na ofrohet që në titull dhe nuk do shumë mend që të kuptohet se rrëfimi i Márquezit kësaj radhe flet për një dashuri në kohë pandemie. Fraza e cila pohon se "ku ka dashuri ka edhe tradhti" gjen zbatim në romanin e Márquezit ku rrëfëhet se herët apo vonë bashkëshortëve do iu duhet të përballen me tundimin për t'i qëndruar besnik martesës. Kur jemi te besnikëria ndër më interesantet na del ajo e Florentinos, i cili betohet se nuk do të martohet me asnjë femër përveç Fermina Dzas, po



që nuk rresht së bëri dashuri me femra të tjera derisa i del emri si një i përdalë që bën dashuri në zyrë të punës me çdo lloj femrash. Që nga "zhvirgjerimi" i tij që ndodh në një anije e deri pas pesëdhjetë vjetëve, ku do t'i shpall sërish dashurinë Ferminas, ai do të ketë mbushur rreth njëzet e pesë fletore me gjashtëqind e njëzet e dy regjistrime lidhjesh dashurie që dalin si emblemë e besnikërisë së tij.


5. Pesëdhjetë vjet, nëntë muaj e katër ditë

Fabula e këtij romani trajton kryqëzimet e fatit të tre personazheve kryesore. Kemi dashurinë e Ferminas me Florentinon, dashuri kjo e cila na del si një lloj fikcioni adoleshent ku Florentino krijon për Ferminan. Lidhja e tyre zhvillohet në saje të letrave dhe pusullave të dashurisë të shkruara me pasion nga protagonistët. Si pengesë për dashurinë e tyre është Lorenzo (babai i Ferminas), i cili nuk e miraton dashurinë e tyre dhe rrjedhimisht i vetmi opsion për ta ndaluar të bijën e tij kryeneçe është ta largojë nga aty, kështu edhe vepron. Fermina kalon sfida e aventura nga më të ndryshmet në udhëtim, formësohet goxha si personalitet duke i fituar tiparet tipike të një gruaje. Ajo kthehet sërish në qytet, por, jo për t'u bashkuar me Florentinon, por për t'u martuar me doktor Juvenal Urbinon. Martesa e tyre mund të mbështetej në lloj-lloj interesash, përveçse në dashuri, ata të dy bënin një jetë e cila lakmohej nga të gjithë por vetëm ata e ndjenin boshllëkun dhe mungesën e dashurisë që po e kryesonte në jetën e tyre. Gjithsesi, Fermina i qëndroi besnik bashkëshortit të saj deri në frymën e tij të fundit duke mos e tradhtuar asnjëherë dhe duke u kujdesur për çdo detaj brenda shtëpisë në të cilën ishte ndërë përherë si e huaj. Jeta e saj pëson një kthesë në momentin kur vdes i shoqi dhe në varrimin e tij shfaqet Florentino që t'i shprehë edhe një herë dashurinë e tij, kishte pritur plot pesëdhjetë vjet për ta ndërmarrë këtë vendim. Rrjedha e ngjarjeve shkon në atë anë sa ata pas pak kohësh bëhen miq goxha të mirë duke kaluar pasditet së bashku e pastaj edhe duke u bërë dashnorë, ndonëse me vonesë, por sërish thonë *më mirë vonë se kurrë*.

Përfundim

Përtej përjetimeve dhe përshkrimeve arrijmë të shohim se në jetë asgjë nuk është e sigurt paralelisht me atë se asgjë nuk është e pamundur. Dashuria është ajo që triumfon gjithmonë dhe me anë të penës së tij magjike Márquezit ka bërë që romani i tij "Dashuria në kohërat e kolerës" të cilësohet si një ndër romanet më të dashura për lexuesit dhe njëkohësisht duke iu dhuruar atyre një perlë nga ato të tij.

(Autorja është studente e vitit të dytë në Fakultetin e Filologjisë, dega e Gjuhës Shqipe)



TAKIMI ME BRODSKIN NË LENINGRAD

STONE PAVČEK

Takimi ynë në dimrin rus të vitit të largët 1963 edhe sot më duket i pabesueshëm si atëherë. Megjithëse nuk ishte aspak i rastësishëm. I pabesueshëm po ashtu edhe çmimi që ia akorduan akademikët suedezë, por që nuk ishte i rastësishëm. Ky takim me Brodskin apo, si i thërrisnin atëherë, Josif Aleksandroviç Brodski, më kujton një rast absurd me një fund të lumtur, kurse ai vetë – si vjershëtor që ia doli t'i mbetej besnik zgjedhjes së tij poetike.

Atë kohë nuk dija asgjë për të. Vitet e shkrirjes dhe periudha e shkurtër hrushoviane e demaskimit të kultit të individit nxori në orbitën e poezisë ruse Vosnjesenskin, Jevtushenkon, Rozhdestvenskin; ata mbushën plotësisht revistat, librat, mbrëmjet letrare, takimet poetike, ata u pranuan me bujë, me ngazëllim dhe entuziazëm shpërblyes, por jo më pak i sigurt ishte edhe marshimi i tyre meridianëve të gjerë të vendit dhe botës. Nën hijen e tyre mbeti poezia shumë më e thellë dhe serioze e brezit të vjetër, qofshin këta Martinov, Sllucki, Samojllov; madje zërat kryesorë të poezisë ruse të atij shekulli dëgjoheshin më shumë në korridoret sesa në polifoninë publike. Aq më tepër, vitet e para të gjashtëdhjeta, ishte koha kur Moska (sipas fjalëve të Ahmatovës) ishte e mbushur me kopje të vjershave të Osip Mandelshtamit, kur Ahmatova kishte mbaruar "Poemën pa hero", kur "u erdhi radha" vjershave të Marina Cvetajevës dhe e pranishme ishte ende ndjesia e humbjes së madhe, e shkaktuar nga vdekja e Nikollaj Zabolockit dhe Boris Pasternakut (vitet 1958 dhe 1960, përkatësisht). Të gjithë këta poetë, sipas një rregulli ende në fuqi të shoqërisë sovjetike, nuk mund t'i kërkoje në librari, kurse disa

edhe nëpër biblioteka. Mandelshtami doli vetëm në vitin 1973, përmbledhja jo e plotë pas vdekjes e Cvetajevës më 1961, lirikat e Pasternakut, Cvetajevës dhe Ahmatovës edhe sot lexuesi rus nuk i gjen plotësisht. (Në dyvëllimëshin e fundit të Ahmatovës, të shtypur nga "Inostrannaja literatura", mungojnë vargje nga cikli "Requiem", kurse nga Pasternaku nuk janë botuar të gjitha poezitë që janë përfshirë të romani "Doktor Zhivago".) Kujtoj atë kohë bisedash shpirtërore, pritshmërive të mëdha të inteligjencies dhe njerëzve të artit, kohën e fenomeneve shënjuese shumëpremtuese, si për shembull, Teatrin në Taganka të Ljubimovit, teatri "Bashkëkohësi" në Moskë në sheshin "Majakovski", i famshmi "Një ditë e Ivan Denisoviçit" të Sollzhenjicinit në revistën "Novij Mir", skulptori Ernst Josifoviç Njezvestnij dhe ekspozita e bujshme në Manezh, të cilën e shpërndau Hrushovi, duke i mbyllur dyert perestrojkës në kulturë atëbotë, duke sakrifikuar kulturën për hir të mbështetjes dhe forcimit të pozitave të tij në sferat e larta të politikës. Në këmbim erdhi amullia e periudhës brezhnjevine dhe një pritje e re e kohëve më të mira.

Atëherë, në agim të viteve gjashtëdhjetë, dukej që këto perspektiva ishin reale dhe po përgatitej një e ardhme e mrekullueshme. Hovi i ri i kulturës zyrtare, po ashtu dashuria e pakufishme për çdo gjë që kishte qenë fshehur, ndaluar, e pamundur, e cila prej ligësisë apo verbërisë ideologjike ishte shkëputur nga lirika ruse, arti rus, duke krijuar një atmosferë freskie, frymëmarrjeje të lehtë, i pajisën krijuesit me një forcë jetëdhënëse. Për fat të keq, sikur e përmenda, shumë iluzione qenë të destinuar të treteshin sa hap e mbyll



sytë. Veçse që atëherë ndiheshin në ajër paralajmërues të njëjloj shqetësimi, por cilët ishin ata, nëse je i huaj, nuk e kupton dot.

Përmes këtyre peripecive, shpresave, jetës së përditshme, u zhvillua edhe takimi im me Josif Brodskin. Miqtë e mi në Moskë ma sollën në vëmendje. Atëbotë po përgatisja antologjinë e poezisë ruse të shekullit XX dhe fillimisht dëshiroja të përfshija në të sa më shumë poetë, kryesisht bashkëkohorët. Në përfundim, ky libër doli krejt tjetër: në antologjinë "Zërat e kohës" janë gjithsej dhjetë emra të shquar të poezisë ruse të kohës sonë, nga Anneski deri te Zabolocki, një përmbledhje më përfaqësuese të lirikës ruse shpresoj ta botoj, mbase, në fund të këtij dhjetëvjeçari (*Tone Pavcek vdiq më 2011*). Në Moskë miqtë më organizuan një takim me Ana Ahmatovën. Nga ajo mbrëmje që kaluam tek ajo më kujtohen shumë emra shkrimtarësh e shumë fate tragjike dhe natyrisht, më kujtohen të rinjtë, të cilët mundën të bëheshin pasues të traditës së lavdishme poetike leningradase. Midis tyre, Aleksandër Kushner dhe Josif Brodski, më rekomanduan gjithashtu Gleba Gorboskin dhe Viktor Sosjurin. Që në atë kohë të gjithë kishin botuar përmbledhje... të gjithë, përveç Brodskit, i cili ishte më i riu ndër ta (ai kishte lindur më 1940).

Kështu, në fund të shkurtit 1963 u nisa nga Moska për në Leningrad. Udhëtimin dhe qëndrimin atje, si bursist i Republikës Sllovene, e organizonte Bashkimi i Shkrimtarëve Sovjetikë, kurse në Leningrad isha mysafir i Organizatës së Shkrimtarëve. Më pritën përzemësisht, të flas të vërtetën – me disa nga anëtarët e udhëheqjes isha njohur më parë – dhe gjithë gëzim më dolën përpara, më këshilluan se çfarë të shikoja, të vizitoja, u interesuan se çdëshira kisha. Isha i ri, moskokëçarës, ndaj pa e vrarë mendjen ia plasa:

-Dua të takohem me poetin Josif Brodski!

Veç kur filloi rrëmuja, shtangia nga habia, hatërmbetja, zunë të shikonin njëri-tjetrin dhe u kapa disa shikime therëse drejt meje; e ku është parë kjo, ne të pritëm me zemër, mirë e bukur, si një mysafir, kurse ti neve me këpucë kokës. Afërsisht kështu doli, derisa një nga pesëmbëdhjetë bashkëbiseduesit deklaroi se Brodski nuk është anëtar Lidhjes së Shkrimtarëve të degës së Leningradit. E çë pastaj, i them, kam dëgjuar që ai është një poet i mirë dhe do të doja të njihesha me të dhe ta përfshija në antologjinë e poezisë ruse që po përgatis. Veç kur ia nisën! Ngado dëgjoheshin pyetje dhe vërejtje: nga e njeh atë? Po kush ta ka rekomanduar? Pse do të takohesh pikërisht me të? Përveç kësaj, ai nuk është poet, deklaroi dikush prerazi, s'është veçse një përkthyes, dhe të gjithë sapo thoshin në kor, se as që e njihnin. E kuptova



se duhej të shpëtoja prej lakut të tyre, ku rashë krejt padashur, sepse për të tilla gjëra nuk mund të flitej në pritjet zyrtare me nëpunës të plotfuqishëm dhe fillova të përshëndetësja, duke premtuar se do të vija përsëri të nesërmen. Por nuk mbaroi me kaq. Ata digjeshin nga kureshtja se nga e njihja, prandaj më duhej që të veçoja fraza të përgjithshme për miqtë e mi, njëkohësisht duke demonstruar interes për poetët e rinj leningradas. Ia dola pak a shumë të tërhiqesha mbrapsht dhe të kthehesha pas pak kohe në hotel.

Këtu më priste edhe një surprizë tjetër. Ime shoqe më tha se kishte telefonuar Brodski dhe do të më merrte sërish. Mrekulli! Domethënë, dikush ia kishte bërë me dije që e kisha kërkuar dhe që kisha bujtur në këtë hotel. Bukur! Të presim se kur do të telefonojë përsëri. Dhe vërtet, pas njëfarë kohe ra përsëri telefoni.

Zëri në skajin e kundërt të linjës u vetëparaqit si Aleksandër Brodski, babai i Josif Brodskit dhe si kritik letrar që ishte, e dinte fare mirë se çfarë nuk është dhe çfarë është e përshtatshme për një libër dhe antologji. Me një fjalë, telefonuesi po më mbushte mendjen se, si njohës i mirë i lirikës ruse, ai e shihte më qartë që vargjet e birit të tij nuk i shkojnë asnjë përmbledhjeje të lirikës ruse, cilado qoftë, dhe m'u përgjërua që ta lija të qetë. Tingëlloj aq besueshëm dhe njëkohësisht, disi e çuditshme: për çfarë arsyeje specialisti, babai, duhet të vendosë shkopinj në rrota kur bëhet fjalë për botimin e vjershave të të birit?

Më vonë m'u qartësua gjithçka: fliste frika e tij, ai përbindësh që i dinte që më parë pasojat e botimit jashtë shtetit të qytetarit sovjetik.

Sidoqoftë, pa marrë parasysh asgjë, u njohëm me Josifin. Ashtu sikundër më kishte premtuar, më telefoni përsëri dhe u takuam te Muzeu Rus, jo larg hotelit tim dhe Nevskit.

Nga ky takim më kanë mbetur në mendje dy momente. Habia e tij kur i foli për ndërhyrjen e të atit. Babai nuk është kritik letrar, më shpjegoi i përmbajtur dhe ftohtë, thjesht ka frikë për mua. Dhe e dyta: Brodski më dha një dosje të rëndë me letra, të mbështjellë me letër dhe gazetë.

-Janë poezitë e tua?" - e pyeta.

-Jo vetëm, edhe të dy miqve të mi.

Pastaj nisi të fliste për vargjet e dy miqve të tij, për poezinë e Dmitri Bobishev dhe Evgenij Rejn. Të dy ishin më të rritur se ai, të dy kishin lindur në vitin 1936. Mbaj mend që Brodski tha se ishte turp që ata nuk i botonin.

Për vete pothuaj nuk foli fare.

I solla të pacenuara poezitë përmes kufirit dhe po atë vit Brodski kumboi në radion e Ljubljanës. Për më tepër, ishin përkthimet e para të poezisë së tij në Slloveni apo kudo tjetërkund në botë. Po atë vit Brodskin e inkriminuan si parazit, kurse poezitë e tij si "përzjerje e dekadentizmit, pesimizmit, modernizmit dhe nxirosjes së realitetit". Në shkurt 1964 ai u dënua me dëbim dhe pesë vjet punë korrektonjëse. Ndërkohë poezitë e tij filluan të qarkullonin kudo të përkthyer nëpër botë dhe në vitin 1965 doli në Nju-Jork përmbledhja e tij "Vjersha dhe poema". Pastaj, si ia zbutën dënimin, në vitet 1966 dhe 1967 ai botoi vjersha në almanakun leningradas "Dita e poezisë", kurse përmbledhja "Qëndrimi në shkretëtirë" u botua jashtë shtetit në vitin 1970. Pas dy vjetësh Brodski u detyrua të lërë Bashkimin Sovjetik.

Në ato fletë të zverdhura prej kohës, që më dha Brodski në dimrin e vitit 1963 në Leningrad, janë mbi njëzet poezi. Të daktilografuara, me korrigjime, të nënshkruara "Josif Brodski". Më vonë u botuan të gjitha në libra. Sa u përket vjershave të dy miqve të tij të asaj periudhe, në një almanak letrar samizdat "Metropol", i cili dilte në Moskë, unë zbulova Evgenij Rejnin. Kurse më vonë në librat e Brodskit gjeta edhe vjershat "e mia" të Brodskit. E pabesueshme, por ata fletë i kam ende unë. Megjithatë, nuk i përktheva krejt rastësisht ato vjersha.

Pas kaq vjetësh kam në duar përsëri fletë të vjetra letre dhe kujtoj poetin i cili, me magjinë e imagjinatës poetike dhe forcës gjithëpërkthuese të metaforës poetike, doli nga kufijtë e vlerësimit zero të qenies

së tij në Bashkimin Sovjetik në vitet gjashtëdhjetë; kujtoj poetin i cili, si i marrë, i dehur nga rimat, ndoqi fatin e tij dhe sipas ligjeve të pashkruara të rregullit të përjashtimit u bë më i famshëm se gjigantët që ai adhuronte dhe që i imitonte – Mandelstam, Cvetajeva, Ahmatova.

Po flas këtu kryesisht për periudhën e parë, më saktë, për pesë vitet e para të krijimtarisë së tij. Ai filloi të shkruajë vjersha në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, kurse më të fundit prej atyre që më dha në Leningrad datonin vitin 1963. Në krahasim me librin e tij të parë, i cili doli nga shtëpia botuese "Çehov" në Nju-Jork në vitin 1970, "Qëndrimi në shkretëtirë", ose me të dytin "Skaji i shekullit të mrekullueshëm" (1977, Miçigan), këto vjersha të hershme ende e kanë një lidhje më të ngushtë me botën reale, kurse do të shtoja që në një kuptim më përcaktues këto poezi janë të angazhuara. Këtu, para së gjithash, kam parasysh qëndrimin kritik ndaj shoqërisë, situatës, pafuqisë së individit, veçanërisht hebrenjve, në hapësirë dhe kohë, vjershat për anët e shëmtuara të jetës sovjetike dhe përsiatjet fyese për këtë vend të socializmit. Më vonë kanë shkruar, në veçanti, që Brodski është një poet të cilit nuk i interesojnë temat e përjetshme të qenies, kërkimet filozofiko-fetare, por edhe në atë periudhë të hershme ne shohim që për poetin nuk janë të huaja vuajtjet dhe dhimbjet dhe jo vetëm për të afërmit e tij në këtë tokë të vdekshme. Megjithatë, ai nuk e keqpërdor të angazhuarit në kuptimin e qerimit të llogarive, nuk gjen strehë te retorika apo antiretorika, sikundër e ka bërë shpesh poezia e socrealizmit; ai i qëndron larg edhe mendimit se plagët e botës janë të shërueshme, mjafton që poeti t'i tregojë ato; në të gjitha kohërat ai i mbetet besnik frymëzimit poetik,

pavarësisht tërheqjes së detyruar në përplasjet e ashpra me realitetin e jetës së përditshme.

Ndryshe nga poezia tjetër ruse, e lindur prej përjetimeve të fillimit të viteve gjashtëdhjetë, që i paguan asaj kohe një haraç më të madh, sesa Brodski, duke iu referuar edhe vargjeve "të mia" të Brodskit, që shënojnë kalimin në një etapë tjetër të krijimtarisë së tij. Dhe e bëj këtë me vetëdije të plotë, duke pasur në duar argumente: pjesa më e madhe e vjershave, veçanërisht cikli i gjerë që Brodski e quante "Kodrat", konsiderohet si një preambulë për përmbledhjen me të njëjtin titull që botoi në Nju-Jork. Ky cikël ngre të tjera tema: përjetësia, ligjet e universit, dhimbja që nuk kalon, kodrat – dhe së bashku me të këtu edhe jeta e përditshme e sendeve dhe e njerëzve. Cikli "Kodrat" mbart një karakter filozofik: vdekja është veçse fushë, kurse jeta: kodrat, lartësitë – dhe janë shkruar në mënyrën e Marina Cvetajevës, kompakte dhe e koncentruar, ndërkohë që vjershat e kapitullit së fundit të përmbledhjes "sime" janë shkruar me një stil më pak të lartë, me shumë përshkrime lëndore dhe përsëritje karakteristike nga rreshti në rreshtin e fjalës që rimon – në një ose disa poezi. E tillë është poezia për kalin e zi, "i cili kalorësin e kërkoi mes nesh", dhe cikli i lirikës dashurore, të vetmisë sflitëse midis gjërave që ka braktisur dashuria. Ja, të themi të vërtetën, kjo është e gjitha. Jo dhe aq pak. Dhe si fillim i shtegut poetik, është shumë, sepse ka nisur çerek shekulli më parë në Leningrad kur ishte veshur me dritën e jashtëzakonshme të shpërblimit në palcë të dimrit dhe tashmë po fillonte të akullonte shkrirjen kulturore po kaq e largët, si liria në kampet siberiane apo lumturia e njerëzimit.

Përktheu Bujar Hudhri



Maryse Condé

Portret Familjar

Përktheu nga origjinali Aristidh Shqevi

Nëse dikush do t'i kishte pyetur prindërit e mi se cili ishte mendimi i tyre për Luftën e Dytë Botërore, ata pa dyshim, do të përgjigjeshin se ajo ishte periudha më e errët që ata kishin njohur. Jo për atë që Franca u nda në dy pjesë, apo për shkak të kampeve të përqendrimit në Drancy dhe në Auschwitz, shfarosjes së gjashtë milion izraelitëve dhe të gjitha atyre krimeve kundër njerëzimit që po paguhen edhe sot, por sepse për shtatë vite të gjatë ata u privuan nga ajo që ishte më e rëndësishmja për ta: udhëtimet në Francë. Meqenëse babai ishte një ish punonjës shtetëror dhe mamaja punonte akoma si mësuese, atyre rregullisht iu jepej e drejta të merrnin pushime me pagesë, bashkë me fëmijët, nga vendlindja e tyre në Guadeloupe në *métropole*. Franca për ta nuk ishte kurrsesi qendra e pushtetit kolonial. Në të vërtetë, ajo ishte Mëmëdheu, ndërsa Paris-i, Qyteti i Dritës që ndriçonte jetën e tyre. Mamaja na mbushte kokën me përshkrimet e mrekullive të Carreau du Temple dhe të tregut Saint-Pierre, për të vazhduar më pas në formë mbishtese me Sainte-Chapelle-n dhe Versailles. Babai preferonte Louvre-n dhe sallën e vallëzimit Cigale, ku si beqar, kishte shkuar për të ardhur në formë. Kështu, nga mesi i vitit 1946, me një ngazëllim të plotë, ata nisën lundrimin me avulloren që do t'i bartte në Le Havre, ndalesa e parë në rrugën e kthimit drejt vendit të adoptuar.

Unë isha fëmija më e vogël. Një nga historitë mitike të familjes sime kishte të bënte me rrethanat e lindjes sime. Në moshën gjashtëdhjetë e tre vjeçare babai ishte akoma shumë i fortë. Mamaja sapo kishte festuar ditëlindjen e saj të dyzetë e tretë. Kur nuk i erdhën periodat, ajo mendoi se i ishin shfaqur shenjat e para të menopauzës, ndaj dhe nxitimthi u turr te mjeku gjinekolog, Dr. Mélas, i cili e kishte pasur paciente në të shtatë lindjet e fëmijëve të saj. Pasi e vizitoi, ai shpërtheu në të qeshura.

'Kisha aq shumë turp,' i thoshte mamaja shoqeve, 'saqë gjatë muajve të parë, shëtisja lart e poshtë si një grua e pamartuar dhe përpiquesha të mbulohesha.'

Pavarësisht se ajo më mbulonte me të puthura, tek thoshte se 'vogëlushja e vonuar' ishte bërë bastuni i saj në moshë të madhe, unë, sa herë që e dëgjoja këtë histori, kisha të njëjtën përshtypje: nuk kisha qenë e dëshiruar.

Sot, jam në gjendje që, në një farë mënyre, ta përfytyroj pamjen e pazakontë që ne formonim tek rrinim ulur jashtë kafeneve në Latin Quartier, në Parisin e zymtë të pas luftës: im atë, një ish Don Zhuan, goxha në formë për moshën që kishte, mamaja e mbuluar me stoli të tepuara të tipit kreol, tetë fëmijët e tyre, motrat, me sytë e ulur përtokë, të veshura si altarë, vëllezërit adoleshentë, njëri prej tyre tashmë student në shkollën mjekësore, dhe unë, një çapëne e vogël me një zhvillim të parakohshëm. Ata, *garçons de café*, me tabakatë të mbështetura në ijët e tyre, na silleshin rrotull gjithë admirim si bletë mjalti. Tek vendosnin mbi tavolinë porosinë *diablos menthe*, kurrë nuk harronin të na thonin: 'E dini çfarë, ju e flisni frëngjishten shkëlqyeshëm!'

Prindërit e mi e prisnin komplimentin pa buzëqeshje dhe pa lëvizjen e asnjë qime floku; ata, thjesht, tundnin kokën në shenjë aprovimi. Në momentin që *garçon-i* largohej, ata ktheheshin nga ne si të ishin dy dëshmitarë: 'Megjithatë, ju jeni aq francezë saç janë dhe dhe ata,' thoshte babai duke psherëtitur.

'Madje, diçka më shumë,' vazhdonte mamaja me furi duke shtuar më pas edhe shpjegimin, 'Ne jemi më të arsimuar. Sjellja jonë është më e mirë. Ne lexojmë më shumë. Disa prej tyre nuk kanë dalë asnjëherë nga Parisi, ndërsa ne, kemi vizituar Mont Saint-Michel,

Riviera-n dhe bregdetin Basque.'

Në këtë bisedë kishte diçka patetike, gjë që, edhe pse isha shumë e re, më trazonte. Prindërit ankoreshin për një padrejtësi të madhe. Pa kurrfarë arsye rolet përmbyseshin. Kamerierët me përparëse të bardha dhe uniforma të zeza që nxitonin t'i vinin duart mbi baksishet e konsideroni veten superiorë ndaj klientëve të tyre bujarë. Unë, për veten time, nuk arrija ta kuptoja përse njerëz të këtyllë, kaq krenarë dhe të kënaqur me veten, pjesë e Establishment-it në vendlindjen e tyre, garonin me disa *garçons de café* të cilët po iu shërbenin.


Një ditë vendosa t'i jap drejtim situatës. Sa herë që isha në mëdyshje, i drejtohesha për ndihmë vëllait tim Alexandre, i cili e kishte ri-quajtur veten Sandrino, 'për të tingëlluar më amerikan.' Si nxënësi më i mirë i klasës, me xhepat të mbushur me letra dashurie që i dërgoheshin nga mikeshat e tij, Sandrino ishte një dritë dielli në jetën time. Ai ishte një vëlla i dashur që të dilte në mbrojtje. Unë do të kisha pasur dëshirë që të kisha qenë më shumë se, thjesht, motra e vogël - e cila

harrohej sapo ai kalonte pranë fundit të një vajze, apo sapo fillonte një ndeshje futboll. A ishte ai në gjendje ta shpjegonte sjelljen e prindërve? Përse ata i kishin zili njerëzit, të cilët, sipas fjalëve të tyre, nuk ngriheshin dot në lartësinë e tyre?

Ne jetonim në një apartament në katin përdhës të një rruge të qetë në Arrondissement-in e shtatë. Jeta nuk ishte si në La Pointe të Guadeloupe-s, ku mbaheshim të mbyllur me kyç në shtëpi. Në Paris, prindërit na lejonin të dilnim lirshëm dhe madje të luanim me fëmijë të tjerë. Atëherë, habitesha me qëndrimin e tyre. Më vonë, kuptova se në Paris, prindërit tanë nuk kishin arsye të trembeshin se ne do të flisnim në gjuhën creole apo se do të na pëlqenin daullet *gwoka*, siç u pëlqenin rreckamanëve në la Pointe. Mbaj mend se ishte dita kur po luanim *mos-më-prek* me fëmijët flokëverdhë në katin e tretë, tek ndanim çaj frutash të thata, në një Paris të sflitur nga mangësia e ushqimeve. Errësira filloi ta shndërrojë qiellin në një sitë të mbushur me yje. Në çastin kur po bëheshim gati të ktheheshim në shtëpi, një nga motrat nxori kokën në dritare dhe thirri: 'Fëmijë, Babai dhe Mamaja thonë se ka ardhur ora që të ktheheni në shtëpi!'

Përpara se të më jepte përgjigje, Sandrino mbështeti kurrizin te porta e një automjeti. Një hije e errët ra mbi fytyrën e tij gazmore që ruante akoma faqet topolake të fëmijërisë. Zëri i tij u shndërrua në një zë serioz. 'As mos e vrit mendjen për këtë,' buçiti ai. 'Babai dhe Mamaja janë një çift individësh të tjetërsuar.'

Të tjetërsuar? Ç'kuptim kishin këto fjalë? Unë nuk guxoja ta pyesja. Nuk ishte hera e parë që Sandrino vinte në lojë prindërit. Me anën e një gjilpëre me kokë, mamaja kishte mbërthyer një fotografi, të prerë nga revista *Ebony*, sipër kokës së krevatit. Një familje afro-amerikane me tetë fëmijë, ashtu si familja jonë, kishte pozuar në një mënyrë të admirueshme. Ishin të gjithë mjekë, avokatë, inxhinierë, dhe arkitektë. Me



pak fjalë, ata ishin krenaria e prindërve. Kjo fotografi e bëri Sandrino-n të shkulumojë në përqeshje, i bindur se ai do të bëhej një shkrimtar i famshëm, pa e ditur aspak se do të largohej nga kjo jetë në pamundësi për ta përqafuar atë. Ai asnjëherë nuk m'i tregoi faqet e para të romanit të tij, por ngaherë m'i recitonte poemat, të cilat më vinin në mendime; sipas tij, ky ishte dhe roli që poezia duhet të luajë. Natën e kalova duke u përpëlitur në shtrat me rrezikun që motrën time Thérèse-n, e cila flinte mbi mua në krevatin e marinarit, ta zgjoja nga gjumi. Unë i adhuroj prindërit e mi, i thashë vetes. Ishte e vërtetë se flokët e thinjur dhe rrudhat e fytyrës nuk më pëlqenin aspak. Do të preferoja që prindërit e mi të ishin më të rinj. Që mamanë time ta ngatërronin me motrën time të madhe, siç ndodhte me mamanë e shoqes sime të ngushtë, Yvelise-s, sa herë që ajo e merrte me vete në katekizëm. Ishte gjithashtu e vërtetë se më kapte një ankth kur babai e ngarkonte bisedën me shprehje latine, të cilat siç zbulova më vonë, gjendeshin në fjalorin *Petit Larousse Illustré. Verba volant. Scripta manent. Carpe diem. Pater familias. Deus ex machina.* Vuaja jashtëzakonisht shumë kur shikoja mamanë që vishte, në mes të vapës, çorape tepër të bardha për lëkurën e saj të zezë. Dashurinë, të cilën prindërit e mi fshihnin në thellësi të zemrës së tyre, unë e njihja mirë, ashtu siç isha e vetëdijshme edhe për përpjekjet e tyre për të na përgatitur drejt asaj që ata besonin se ishte një jetë e mrekullueshme.

Në të njëjtën kohë, besimi im te vëllai ishte aq i madh sa gjykimin e tij nuk mund ta vija në dyshim. Duke u nisur nga mënyra e të shprehurit dhe toni i zërit të tij, unë nuhata se fjala misterioze të *tjetërsuar* dëftonte tipin e një lëngate të turpshme si gonorrhea, dhe ndoshta një sëmundje fatale si tifo e zorrëve që një vit më parë kishte rrëmbyer jetën e shumë njerëzve në La Pointe. Në mesnatë, pasi i mblodha të gjitha faktet së bashku, dola me një teori disi të turbullt. Një njeri i tjetërsuar është dikush që përpiket të jetë diçka që nuk mund të jetë, sepse nuk është i kënaqur me atë çka është. Në orën dy të mëngjesit, pikërisht kur po kapitja sytë, në një farë pështjellimi mendor, u betova se kurrë nuk do ta lejoja veten të bëhesha një person i tjetërsuar.

Për rrjedhojë, në mëngjes u zgjoja një vajzë e mitur që ishte shndërruar rrënjësisht. Nga një fëmijë model, u ktheva në një fëmijë që ta kthente fjalën dhe që grindej me fjalë. Meqë synimet e mia nuk ishin shumë të qarta, thjesht kundërshtoja gjithçka që prindërit ma sugjerorin: një mbremje në opera për të dëgjuar sinjalet e borive të *Aida* apo këmbanat të *Lakmé*; një vizitë në Orangerie për ta admiruar *Nymphéas*-in e Monet-it; ose thjesht një fustan, një palë këpucë, apo kordele për flokët e mi. Mamaja, virtyti i së cilës nuk ishte durimi, nuk i kursente shuplakat që shpërndante. Njëzetë herë në dite ajo ulërinte: 'O Zot i Madh! Ç'dreqin i ka hyrë në kokë kësaj vajze?'

Një fotografi e nxjerrë nga fundi i një vizite të veçantë në Francë, na tregon të gjithëve së bashku në Kopshtet e Luksemburgut. Të gjithë vëllezërit dhe motrat janë të vendosur në radhë. Babai, me mustaqe, ka veshur një pallto të madhe me jakë të gëzoftë. Mamaja, me dhëmbët e saj të bardhë si margaritarë, buzëqesh; sytë e saj si bajame kapsallitin nën kapelën e shndritshme prej lëkure të tipit fedora. Pranë këmbëve të saj qëndrojnë unë, e dobët dhe e shfytyruar nga pamja e dëshpëruar dhe nursëze, të cilën do ta kultivoja te vetja deri në fund të adoleshencës, deri sa dora e fatit, e cila i ndëshkon rëndë fëmijët mosmirënjohës, më bëri fëmijë jetim shumë herët, në moshën njëzetvjeçare.

Që atëherë, e kam pasur në dispozicion kohën e nevojshme për ta kuptuar fjalën të *tjetërsuar*, dhe sidomos për ta pyetur veten nëse Sandrino kishte të drejtë. A ishin prindërit e mi të tjetërsuar? Për të qenë të sigurt, ata kurrë nuk u mburrën me prejardhjen e tyre afrikane. Në lidhje me të, ata nuk dinin asgjë. Dhe ky është fakt! Gjatë vizitave të tyre në Francë, babait asnjëherë nuk i shkeli këmba në Rue des Écoles, ku kishte lindur revista *Présence Africaine*, një ide origjinale e Alioune Diop-it. Ashtu si edhe nëna, ai preferonte bindshëm kulturën perëndimore, ndaj dhe i ishte mirënjohës përgjithmonë Francës që ia kishte dhënë rastin të dyve për ta përfutur atë kulturë. Në të njëjtën kohë, asnjëri prej tyre nuk vuante asnjë grimë nga kompleksi i inferioritetit që mund të vinte për shkak të ngjyrës së tyre. Ata besonin se ishin njerëzit më mendjemprehtë dhe inteligjentë në botë, një dëshmi pozitive kjo e përparimit të arritur nga të zinjët.

A ishte ky kuptimi i 'tjetërsuar'?

Charles Baudelaire

Arti Romantik

Pas shumë vitesh, pjesa e vëmendjes që publiku i ka dhënë gjërave shpirtërore ishte veçanërisht zvogëluar; buxheti i tij i ndërkalljes shkonte dhe tkurrej çdo ditë. Vitet e fundit të Lui-Filipit panë shpërthimet e fundit të një shpirti gjithmonë të ndezur prej lojës së imagjinatës; por romancierët e rinj u gjendën përballë një shoqërie vjetërsisht të shumëpërdorur – akoma më keq të drobitur, - të budallalëpsur dhe makute, një shoqëri që kishte tmerr veç prej trillimit, dhe dashurisë veçse për zotërim.

Në kushte të ngjashme, një shpirt i ushqyer mirë, flakadan ndaj së bukurës, por i magjepsur nga një lojë-shpatash e fortë, shpesh herë gjykues i pasojave të së mirës dhe së keqes, do të thoshte: "Kush është mjeti më e sigurt t'i zbythi të gjitha këto shpirtra të plakura? Këto shpirtra nuk njohin në realitet atë çka dashurojnë; ato nuk mbartin një neveri pozitive veç pompozitetit; ndjenjës naive, të përvëlur, braktisja poetike i bën ato të skuqen dhe i lëndonë.

Qofshim pra të rëndomtë në zgjedhjen e subjektit, ndërsa zgjedhja e një subjekti tepër të madh është një fyerje tepër e madhe për lexuesin e shekullit të XIX. Njëherazi ngërthen të mbajtur mirë braktisjen tonë dhe fjalosjen në emër të çështjes tonë në veçanti. Ne do të ishim pasqyra duke rrëfyer ndjenjat dhe kuturisjet ku bashkësia e botës vendos zjarrminë e saj; ne do të ishim, sikurse shkolla dëfton, objektiv dhe të pavetishëm.

Gjithashtu, veshët tanë sikur të ishin rraskapitur në këto kohë të fundit nga dërdëllitja e shkollave foshnjake, sikurse kemi dëgjuar të flitet për një farë procesi letrar të quajtur *realizëm*, - fyes i neveritshëm flakur në surrat të të gjithë analistëve, fjalë të turbullta dhe të fushkëta që kanë kuptim veç për të rëndomtë, jo një metodë e re krijimi, por një përshkrim me imtësi plotësuese të dorës së dytë, - ne përfitojmë nga amullia e shpirtave dhe mosdija universale. Ne shtrojmë një stil gjith nerv, piktoresk, mendjehollë, të njimentë, mbi një kanavacë të rëndomtë. Ne kyçim ndjenjat më të ngrohta dhe më të zjarrta në kuturisjen më banale. Fjalët më madhështore, më vendimtare, të rrjedhura prej buzëve më të marrëzishme.

Cili është terreni i marrëzisë, ambienti më idiot, më prodhues në absurditet, më i bollshëm ndër torolakë që nuk lëshojnë udhë?

- Krahu.

Cilët janë aktorët më të padurueshëm?

- Njerëzit e vegjël që shqetësohen kah funksionet e vogla në të cilat ushtrojnë gabimisht idetë e tyre.

Cila është e dhëna më e dalë boje, më e kurvëruara, sedra e barbarisë më të rraskapitur?

- Një shkelës(e) kurore.

"Nuk kam nevojë, thotë poeti, që *heroina* ime të jetë një heroinë. Me kusht që ajo të jetë mjaftueshëm e bukur, të ketë nerv, dëshira sipërore, një frymëmarrje të pandalshme drejt një bote të epërme, ajo duhet të jetë tërheqëse. Rrethi i forcës, përveç kësaj, duhet të jetë fisnikërisht fisnik, dhe mëkatet tona do të jenë së paku të merituar, - krahasimisht jo i rëndomtë, - shques i dërdëllimave të mërziatshme të epokës që na ka paraprirë."

"Nuk kam nevojë të shqetësohem për stilin, vendosjet piktoreske, përshkrimet e ambientit; e zotëroj të gjithë këtë dhunti me një fuqi të tepruar; marshoj i mbështetur mbi analizën dhe logjikën, dhe do të mundesha gjithashtu që t'i bëja të gjitha subjektet të ishin pa dallim të mira apo të këqija, nga mënyra se si janë trajtuar, dhe ku më i rëndomtë mund të bëhet më i miri i të mirave."

Bash prej këtu, *Zonja Bovari*, - një kuturisje, një kuturisje e vërtetë, një bast, si të gjitha veprat e artit, - u krijua.

Autorit nuk i ngelet gjë tjetër, për ta kompletuar rrethin e forcave në tërësinë e vet, veçse ta rrjepi e ta zhveshi (sa të jetë e mundur) seksin e tij dhe të bëhet grua. Dhe kjo i ka rezultuar si një mrekulli; gjë e cila, pavarësisht zellit të tij të aktorit, nuk ka mundur më tej mos me i shtënë një gjak burrëror në vena krijesës së tij, dhe që zonja Bovari, për të pasur në 'të më tepër energji dhe ambicie, gjithashtu më tepër ëndërrim, zonja Bovari pra ka ngelur një burrë. Si Athina Pallas e armatosur, e dalë prej trurit të Zeusit, kjo androgjene e çuditëshme mbart të gjithë ngashnjimin e një shpirti burrëror në një trup epshndjellës femëror.

E përktheu nga frëngjishtja:
FLURANS ILIA



LE RADICI PROFONDE
DELLA CULTURA



ARBËRESHË

INTRODUCE E MODERA

ROBERTO LIBERA

DEMOETNOANTROPOLOGO

INTERVENGONO

MATTEO MANDALÀ

DOCENTE UNIVERSITÀ DI PALERMO

SPARTACO PUPO

DOCENTE UNIVERSITÀ DELLA CALABRIA

ROSA CARBONE

ESPERTA DI TURISMO
E VALORIZZAZIONE DEI BENI CULTURALI

**SABATO
13 MARZO 2021
ORE 19**

IN DIRETTA SULLA
PAGINA FACEBOOK
E SUL CANALE YOUTUBE
DI RADICI NEL MONDO

